

FGJH

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS



8 / 2023

Botohet për herë të parë në dhjetor 2019

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

E-mail: redaksia_fgjh@unitir.edu.al, www.fgjh.edu.al

©Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ISSN 2664-7346

BORDI EDITORIAL

Kryeredaktore

Dr. Viola ADHAMI, (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc.Dr. Mirela PAPA, (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc. Dr. Marsela LIKAJ, (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Korrektore letrare

Dr. Viola BITI, (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

BORDI SHKENCOR

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Saverina PASHO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Viktor RISTANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lorena DEDJA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Klodeta Dibra

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Brikena KADZADEJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Jonida BUSHI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Irena LAMA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Adriatik DERIAJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Xhemile ABDIU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Anastasi PRODANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Sofia DELIJORGJI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Daniela HASA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Daniela TAMO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lindita SEJDIU RUGOVA

(Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Freiderikos VALETOPOULOS

(Université de Poitiers, Francë)

Prof. Enrico LUSSO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Marco NOVARINO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Dr. Ahmet GÜNŞEN

(Fakulteti i Letërsisë, Universiteti Trakya, Turqi)

Prof. Dr. Giorgos KENTROTIS

(Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Ionian, Greqi)

Arti grafik: Fabjola Caushaj

Shtypi u realizua nga: Ani Print shpk

PËRMBAJTJA

5

Projekti: “Didaktika digjitale e
mësimdhënies/nxënies dhe kërkimit
shkencor në UT - (DiDiRes)”

Esmeralda Kromidha

Anida Kisi,

Daniela Hasa

Elona Toro,

Ogerta Koruti Stroka,

Migena Sejdini

17

Integrimi i mjeteve digjitale në
procesin
mësimor në kontekst universitar:
rasti i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

Anida Kisi

Elona Toro

Esmeralda Kromidha

28

Harmonizimi i mësimdhënies
dhe kërkimit shkencor në
FGJH-UT me standardet kombëtare
e ndërkombëtare

Daniela Hasa

Migena Sejdini

39

Aplikacione që përdoren nga
studiuesit e rinj për kërkim shkencor

Ogerta Koruti Stroka

51

Strategjitë e nxënies së leksikut të
greqishtes në shkollat dygjuhëshe
shqiptaro-greke

Sofia Delijorgji

Aida Zoto

Isida (Metaj) Foçi

Edlira Jorgaqi

63

Ndikimi i inteligjencës artificiale në
përkthim
Anna Maria Vasili

70

Kazuo Ishiguro dhe Japonia
Blerina Zaimi

80

Qasjet edukative dhe mbështetja psiko-
sociale për nxënësit me ADHD në mjediset
shkollore. Strategji dhe praktika efektive.
Edlira (Milla) Hani

89

Tezat feministe dhe socialiste në romanin
Jude the obscure: traktat politik apo thirrje
për humanizëm?!
Enkelejda Malaj

101

Eksplorimi i procesit konjitiv të formave
negative në shqip dhe anglisht (me
studentët e vitit të parë, master): studim
krahasues i strukturave pohore dhe
mohore.
Gentiana Bidollari

111

Vendi i historisë në suazën e studimeve të
interpretimit
Ilda Themeli

**PROJEKTI: “DIDAKTIKA DIGJITALE E
MËSIMDHËNIES/NXËNIES DHE KËRKIMIT
SHKENCOR NË UT - (DIDIRES)”**

PROJEKTI: “DIDAKTIKA DIGJITALE E MËSIMDHËNIES/NXËNIES DHE KËRKIMIT SHKENCOR NË UT - (DIDIRES)”

Drejtues i projektit: Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Bashkëpunëtorë shkencorë:
Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi, Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa
Prof. Asoc. Dr. Elona Toro, Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti Stroka,
Dr. Migena Sejдини.

PËRMBLEDHJE

Projekti i titulluar “Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/nxënies dhe Kërkimit shkencor në UT - (DiDiRes)” u propozua në përgjigje të thirrjes së Agjencisë për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion (AKKSHI) për Projektet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) 2023.

Ky projekt është një iniciativë e kërkimit shkencor që synon të ofrojë njohuri dhe rekomandime të zbatueshme për pedagogët, studentët e ciklit të dytë dhe doktorantët. Qëllimi përfundimtar është të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave akademike në studimet e ciklit të dytë dhe të doktoraturës, duke nxitur një mjedis ku teknologjia shërben si një katalizator për ekselencën akademike dhe inovacionin në kërkimin shkencor.

Fjalë çelës: Didaktikë digjitale, integrim teknologjik, kërkim, inovacion, arsimi i lartë.

ABSTRACT

The project titled “Digital Didactics of Teaching/Learning and Scientific Research at UT - (DiDiRes)” was proposed in response to the call by the Agency for Research, Technology and Innovation (AKKSHI) for National Research and Development Projects (PKKZH) 2023.

This project is a scientific research initiative aimed at providing applicable knowledge and recommendations for lecturers, second-cycle students, and doctoral candidates. The final goal is to contribute to the continuous improvement of academic practices in second cycle and doctoral studies, fostering an environment where technology serves as a catalyst for academic excellence and research innovation.

Keywords: Digital Didactics, Technological Integration, Research, Innovation, Higher Education

Konteksti i zhvillimit të projektit

Projekti me titull “Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)”, u propozua në përgjigje të thirrjes së Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI) për Projekte Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit (PKKZH) 2023.

Ky projekt është një kërkim shkencor që synon të ofrojë njohuri dhe rekomandime të zbatueshme për pedagogët, doktorantët dhe studentët e ciklit të dytë. Qëllimi kryesor është të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave akademike në studimet e ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë (doktoratës), duke nxitur një mjedis ku teknologjia shërben si një katalizator për përsosmërinë akademike dhe inovacionin kërkimor.

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë¹, Universiteti i Tiranës ka si qëllim zhvillimin dhe shpërndarjen e njohurive përmes mësimdhënies së gërshtuar me aktivitetin e kërkimit shkencor. Gjithashtu, pas një mbylljeje prej më shumë se 8 vitesh të programeve të doktoratës, në vitin 2022 Ministria e Arsimit dhe Sportit u dha universiteteve publike të drejtën për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë. Për rrjedhojë, në Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ndoqën studimet 42 studentë doktorantë.

Pedagogët që angazhohen në kërkim shkencor duhet të paraqesin një kërkim me standarde të larta, ndaj mbështetja e udhëheqësve është e domosdoshme për të siguruar një punim dhe studim profesional. Nga ana tjetër, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (UT) ka ngritur nivelin e infrastrukturës teknologjike në ndihmë të mësimin dhe kërkuesve shkencorë me laboratorë bashkëkohorë të Interpretimit dhe Përkthimit, Përkthim dhe Multimedia, Laboratorin e Fonetikës, Laboratorin e Kërkimit Shkencor dhe Integritin të Teknologjive në Mësimdhënie, Laboratorit Kërkimor në Didaktikën e Gjuhëve të Huaja, Përkthim, Letërsi dhe Linguistikë - DiPLing, Qendrën e trajnimeve dhe inovacionit pedagogjik si edhe Auditorin multifunksional. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në vitin 2022 ka qenë fitues me 2 projekte në përgjigje të thirrjes për Projekte të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Urdhër të Ministrit Nr. 360 datë 28.06.2022 “Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023” dhe si rezultat i impelmentimit të suksesshëm të këtyre projekteve u realizuan 4 (katër) laboratorë të mësimdhënies dhe të kërkimit, të realizuar me financimin këtyre dy projekteve.

Gjithashtu nëpërmjet fondeve për kërkim dhe ekselencë të Universitetit të Tiranës gjatë vitit 2022 në FGJH u investua në 4 hapësira të dedikuara për kërkimin shkencor dhe procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, për trajnime të vazhduara për mësuesit, përkthyesit, ndërmjetësit kulturorë dhe stafit të UT-së, që dëshirojnë të përditësojnë dijet e tyre në fushat përkatëse. Risi është edhe investimi në një Qendër Multifunksionale të Këshillit Studentor dhe Klubeve studentore të FGJH-së, një mjedis bashkëkohor tërësisht në funksion të veprimtarive akademike dhe socio-kulturore të studentëve.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (UT) vë theksin tek rëndësia e këtyre projekteve infrastrukturore në shërbim të zhvillimit të kapaciteteve të infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit duke mundësuar realizimin e hulumtimeve dhe punëve kërkimore me standarde të larta. Këto investime në infrastrukturë teknologjike do të kanë një impakt të drejtpërdrejtë në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit inovacionit pedagogjik në mësimdhënie, rjetëzimit të kërkuesve shkencorë vendas e të huaj duke realizuar takime, tryeza apo konferenca të përbashkëta.

Nga ana tjetër, zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe perspektivat arsimore që ajo paraqet nënvizojnë domosdoshmërinë për të rritur aftësitë brenda programeve të studimit

në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Fakulteti ynë ka hapur një programi të ri për vitin akademik 2022-2023 dhe ka fituar të drejtën për dhënien e diplomave të dyfishta, me anë të programit të përbashkët Master i Shkencave në “Trajtimi automatik i dokumenteve të shkruara” me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Francë, program që ndërthur njohuritë dhe aftësitë digjitale me ato gjuhësore. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja implementoi në periudhën 2022-2023 një projekt në partneritet me Universitetin e Zagrebit, Kroaci me titull: “Integrimi i teknologjisë digjitale në metodologjitë e mësimdhënies/të nxënies dhe sfidat e trajnimit të mësuesve” financuar nga Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF), ku ekipi i projektit bashkëpunoi për rritjen e kapaciteteve në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënien e gjuhës frënge për mësuesit e arsimit parauniversitar.

Problematika në fokus të projektit

Në kuadër të ndryshimit të vazhdueshëm të peizazhit të arsimit të lartë, përfshirja e teknologjisë është shfaqur si një kusht i rëndësishëm në formimin e rrugëtimit arsimor të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë (Master), në ciklin e tretë (doktoratë) si dhe në metodologjinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor nga pedagogët. Ky projekt kërkon të hulumtojë në sferën e shumanshme të rolit të teknologjisë në mësimdhënie/nxënie dhe të kërkimit shkencor brenda fushës së gjuhëve të huaja në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Duke ekzaminuar situatën aktuale dhe duke identifikuar sfidat, projekti synon të kontribuojë me zgjidhje novatore në dialogun e vazhdueshëm rreth përdorimit efektiv të teknologjisë në arsimin e lartë.

Problematikat kryesore në fokus të projektit janë:

1. Eksplorimi i ndikimit të teknologjisë në mësimdhënie/nxënie dhe kërkim shkencor, nga mbledhja dhe analiza e të dhënave deri tek mënyra se si mjetet digjitale mund të drejtojnë dhe përmirësojnë procesin e mësimit dhe të kërkimit.
2. Njohja e aftësive të pedagogëve për të përfshirë në mënyrë efektive teknologjinë në praktikatat e tyre të mësimdhënies në nivele të përparuara akademike, duke përfshirë këtu edhe mundësitë dhe strategjitë e zhvillimit profesional për të fuqizuar pedagogët me kompetencat digjitale të nevojshme për një arsim bashkëkohor.
3. Hulumtimi se si teknologjia mund të përdoret për të modernizuar metodologjitë e mësimdhënies, për të promovuar të nxëniet ndërveprues dhe për të përmbushur nevojat e ndryshme të studentëve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, duke pasur në qendër të mësimit studentin dhe duke i përdorur teknologjitë jo vetëm në auditor por edhe me praktikën në terren.

Nëpërmjet një shqyrtimi gjithëpërfshirës të këtyre aspekteve, projekti arriti të sigurojë njohuri të vlefshme me praktikatat më të mira dhe do të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive digjitale në mësimdhënie/nxënie të pedagogëve dhe të studentëve të ciklit të dytë e të tretë. Në thelb, projekti kryen një vëzhgim të dyfishtë – duke u thelluar në situatën aktuale të integritimit teknologjik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në ciklin e dytë dhe në ciklin e tretë – si dhe duke njohur dhe nxjerrë në pah njëkohësisht nevojat e zhvillimit profesional të pedagogëve.

Veçori strategjike të projektit

Kërkimi shkencor dhe ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë janë dy nga akset prioritare të Strategjisë Kombëtare të Arsimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë⁴. Në vijim të kësaj strategjie, Universiteti i Tiranës ka integruar në Strategjinë e tij të Zhvillimit 2018-2023⁵ një aks specifik për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin me synimin për të strukturuar dhe zhvilluar kërkimin në një kuadër kombëtar dhe ndërkombëtar.

Procesi mësimor dhe kërkimi shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (FGJH) udhëhiqen dhe zhvillohen nën frymën e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Puna kërkimore dhe veprimtaria krijuese janë pjesë integrale e misionit të një universiteti. Sipas përcaktimeve të këtij ligji, FGJH ka si qëllim zhvillimin dhe shpërndarjen e njohurive përmes mësimdhënies së ndërthurur me aktivitetin e kërkimit shkencor.

Për këtë arsye, të gjitha masat e ndërmarra nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja janë të mbështetura në një kuadër rregullator në nivel kombëtar, ndërkombëtar si dhe në rregullore dhe vendime të nxjerra në nivel fakulteti dhe departamenti, për të harmonizuar të gjithë veprimtarinë mësimore dhe kërkimore në fakultet me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare:

- *Strategjia për Arsimin 2021-2026* përcakton kuadrin e politikave shtetërore për arsimin në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë strategji sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe dokumente të tjera të politikave që ndërlidhen me zhvillimin e arsimit.
- *Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026* është strategjia ndërsektoriale e digjitalizimit të vendit. Synimi 4-ët i kësaj agjende është edukimi digjital dhe aftësitë digjitale, të cilat synojnë transformimin e të mësuarit dhe mësimdhënies.
- *Kuadri për kompetencat kyç për të mësuarit gjatë gjithë jetës* përfshin kompetencat digjitale si një komponent thelbësor.
- *Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025* është një strategji për instalimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës broadband në të gjitha sferat e jetës.
- *Education strategy Council of Europe 2024 · 2030*, e cila fokusohet në zhvillimin e tre dimensioneve në çdo nxënës: nxënësi “qytetar”, nxënësi “global ndërkulturor”, nxënësi “digjital”.
- *The Digital Education Action Plan (2021-2027)* Plani i Veprimit për Arsimin Digjital (2021-2027) është një nismë e politikave të Bashkimit Evropian (BE) që përcakton një vizion të përbashkët të arsimit digjital me cilësi të lartë, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm në Evropë dhe synon të mbështesë përshtatjen e sistemeve të edukimit dhe trajnimit të shteteve anëtare në epokën digjitale.

Ky kuadër strategjik dhe rregullator ofron bazën për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit të lartë në Shqipëri, duke theksuar rëndësinë e digjitalizimit dhe ndërkombëtarizimit në arritjen e cilësisë dhe ekselencës akademike.

Ky projekt është në harmoni me objektivin specifik C2 të përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim të Strategjisë Kombëtare të Arsimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, ku *nëpërmjet rritjes së veprimtarisë kërkimore-shkencore, synohet rritja e*

cilësisë së arsimit, duke krijuar mundësi që personeli akademik dhe studentët të fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.

Gjithashtu qëllimet e këtij projekti lidhen ngushtë dhe me objektivin specifik C7 sipas të cilit *shërbimet digjitale të Strategjisë Kombëtare të Arsimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, ku avancimi i infrastrukturës së TIK-ut dhe i shërbimeve digjitale për IAL-të publike synon të rrisë kompetencat digjitale të studentëve dhe pedagogëve.*

Ky projekt synon fuqizimin e grave duke iu përmbajtur fort parimeve të ERA - Barazia gjinore në Zonën Evropiane të Kërkimit si edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore⁶ pasi ndikon drejtpërdrejt në rritjen profesionale të grave dhe rrjedhimisht vepron në ndërtimin e barazisë gjinore në karrierë në të gjitha nivelet, pasi FGJH në përbërjen e tij ka një numër të madh femrash që punojnë si personel akademik e administrativ por edhe mes studentësh janë femrat që dominojnë.

Aktivitetet dhe produktet e këtij projekti synojnë objektivin e gjithëpërfshirjes në mësim dhe kërkim duke mundësuar tek çdo shtresë studentësh aksesin në burimet pedagogjike të mësimin dhe kërkimit.⁷

Ky projekt i përgjigjet edhe sfidave të mbrojtjes së mjedisit duke kufizuar shpërdorimin e burimeve natyrore si letër dhe energji si edhe duke i promovuar brezave edukimin me anë të përdorimit të teknologjisë është pro ekositemit⁸

Qëllimi dhe objektivat e projektit

Qëllimi kryesor i projektit «Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)» është të ekzaminojë në mënyrë gjithëpërfshirëse integrimin e teknologjisë në metodologjitë e mësimdhënies të përdorura në ciklin e dytë të studimeve dhe programet e ciklit të tretë. Ky projekt synon të nxisë kërkimet shkencore mbi integrimin e teknologjisë digjitale në metodologjitë e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe të zhvillojë aftësitë digjitale të personelit akademik të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Një tjetër qëllim i rëndësishëm është zhvillimi i kulturës së projektit dhe qasjes së zgjidhjes së problemeve të studiuesit të rinj dhe në mësimdhënie, duke përdorur teknologjitë.

Objektivat specifike të këtij projekti janë të shumfishta.

- Së pari, synohet krijimi i një panorame të përgjithshme mbi situatën aktuale të përdorimit të teknologjive në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor në Universitetin e Tiranës, përmes shembujve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, dhe propozojnë zgjidhje për përmirësimin dhe/ose përshtatjen e metodave të reja të mësimdhënies dhe të nxënies.
- Së dyti, evidentohen nevojat e personelit akademik dhe studentëve në përdorimin e teknologjisë.
- Objektivi i tretë është vlerësimi dhe përmirësimi i përdorimit të teknologjive si në kontekstet e mësimdhënies, ashtu edhe në ato kërkimore specifike për ciklin e dytë të studimeve dhe studentët doktorantë. Për të arritur këtë, janë organizuar diskutime në tavolina të rrumbullakëta me palët e interesuara për të kuptuar sfidat dhe mundësitë e paraqitura në këto nivele akademike dhe për të identifikuar strategjitë që mund të optimizojnë integrimin e teknologjisë, duke nxitur kështu një mjedis mësimor më dinamik dhe efektiv.

Metodologjia e projektit dhe veprimtaritë

Për realizimin e projektit “Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)”, metodologjia e kërkimit shkencor përfshin disa hapa të rëndësishëm. Fillimisht, u organizua një pyetësor me studentët e masterit, doktorantët dhe pedagogët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Ky pyetësor u hartua në platformën Office Forms dhe u shpërnda online. Nëpërmjet pyetësorit u siguruan të dhëna mbi nivelin e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si edhe nevojat e tyre për rritjen e kompetencave digjitale për kërkimin shkencor dhe mësimdhënien.

Më tej, grupi i punës organizoi një sërë aktivitetesh si tryeza të rrumbullakëta e seminare për të pasqyruar gjetjet e pyetësorit. Në këto aktivitete morën pjesë ekspertë të didaktikës së mësimdhënies, pedagogë, doktorantë, studentë dhe partnerë të tjerë dhe u paraqit një panoramë e aspektit rregullator, bazuar në rregulloret e programeve të studimit, strategjitë e zhvillimit dhe kërkimit shkencor në FGJH (UT), legjislacionet dhe vendimet përkatëse të institucioneve arsimore, etj.

Problemet dhe çështjet e identifikuara gjatë analizës së nevojave dhe gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit u trajtuan gjerësisht dhe posaçërisht në artikujt shkencorë të hartuar nga ekipi i projektit. Duke trajtuar ndërthurjen e teknologjisë, mësimdhënies dhe kërkimit në këto mjedise të përparuara akademike, ky projekt aspiron të jetë një burim i vlefshëm për institucionet që kërkojnë të përshtaten dhe të lulëzojnë në epokën digjitale të arsimit të lartë.

Aktivitetet e projektit

Projekti “Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)” përfshin një sërë aktivitetesh të strukturuar në dy faza kryesore: faza përgatitore dhe faza e zbatimit. Aktivitetet e organizuara kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve digjitale dhe përmirësimin e praktikave akademike në UT. Me përfundimin e aktiviteteve të mbetura, pritet që projekti të ketë një ndikim të qëndrueshëm në mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në universitete.

Faza përgatitore filloi me një takim koordinues të ekipit të projektit, mbajtur në Shtator 2023. Gjatë këtij takimi, u përcaktuan detyrat e qarta për çdo anëtar të grupit të punës dhe u vendosën afatet për realizimin e tyre. Ky takim shërbeu si bazë për strukturimin dhe organizimin e mëtejshëm të projektit.

Në vazhdim, u realizua evidentimi i nevojave të personelit akademik dhe studentëve në fushën e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në funksion të kërkimit shkencor. Për këtë qëllim, u hartua një pyetësor online, i cili iu drejtua studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë si dhe pedagogëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH). Pyetësori u krijua në platformën Office - Forms dhe u shpërnda elektronikisht nëpërmjet adresave të emailit në *unitir*.

Në Tetor 2023, u realizua hartimi dhe shpërndarja e një pyetësori specifik për studentët doktorantë të gjuhëve të huaja. Ky pyetësor kishte për qëllim të mblidhte të dhëna të detajuara mbi përvojat dhe sfidat e tyre në përdorimin e teknologjisë në kërkimin shkencor. Pas mbledhjes së të dhënave, në Nëntor 2023, u krye analiza e rezultateve të pyetësorëve. Kjo analizë krijoi një panoramë të përgjithshme mbi situatën aktuale të përdorimit të teknologjive në mësimdhënie/mësimnxënie dhe kërkimin shkencor në FGJH. Bazuar në rezultatet e kësaj analize, u hartua një raport që identifikoi problemet kryesore dhe rekomandimet për përmirësim.

Faza e dytë filloi me prezantimin e rezultateve të fazës së parë dhe organizimin e një tryeze të rrumbullakët në Dhjetor 2023. Në këtë tryezë morën pjesë personeli akademik i fakulteteve të UT-së, ekspertë të teknologjisë, inovacionit dhe mbrojtjes së të dhënave, studentë dhe ekspertët e metodave moderne të mësimdhënies/nxënies. Diskutimet u bazuan në nevojat e identifikuara nga pyetësorët dhe anketat, duke synuar rritjen e kapaciteteve digjitale të pjesëmarrësve.

Ky takim pati si qëllim evidentimin e aspekteve kryesore të projektit DiDiRes, kontekstin, pikësynimet, veprimtaritë, rezultatet e pritshme dhe një panoramë të përgjithshme mbi digjitalizimin në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe mbi përvojën e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Gjithashtu u parashtruan gjetjet dhe analiza e pyetësorëve mbi përdorimin e mjeteve digjitale në mësimdhënie/nxënie dhe në kërkimin shkencor në FGJH.

Vlerë e shtuar dhe me rëndësi të veçantë në këtë aktivitet ishte shkëmbimi i përvojave dhe diskutimet e të fuarve mbi temat: “Kërkimi shkencor në UT - sfida dhe risi” dhe “Kërkimi shkencor dhe TIK” duke nxitur një kuptim kolektiv të sfidave me të cilat përballlemi aktualisht dhe zgjidhjet inovative që mund të nxisin përparimin e mëtejshëm. Perspektivat e ndryshme dhe të përbashkëta jo vetëm që kanë zgjeruar horizontet tona, por gjithashtu na kanë frymëzuar të rikonceptojmë dhe të përsosim qasjet tona.

Në Shkurt 2024, u organizua një tryezë e rrumbullakët mbi metodologjitë inovatore të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Trajnimi në vijim përfshiu tema të ndryshme si krijimi i korpuseve studimore, analiza e të dhënave cilësore dhe sasiore, aksesimi i literaturës bashkëkohore akademike përmes bibliotekës digjitale dhe përdorimi i programeve kompjuterike për analizën gjuhësore.

Në kuadër të vizitës së anëtarëve të Universitetit Poitiers në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (FGJH), një partner i rëndësishëm në projektin tonë, në muajin prill 2024 u organizua një veprimtari shkencore me temën: “Dëshmi të zhvillimeve në kërkim shkencor në fakultetet respektive: metoda novatore të kërkimit dhe teknologjitë e reja”.

Tryeza e rrumbullakët e formatit ndërveprues përfshiu diskutime, prezantime të rasteve studimore dhe ndarjen e shembujve praktikë, duke krijuar një mjedis bashkëpunues dhe pasurues për të gjithë pjesëmarrësit. Anëtarët e grupit të punës së projektit paraqiten rezultatet dhe gjetjet nga hulumtimet e kryera. Përdorimi i njohurive dhe përvojës së kolegëve nga Universiteti i Poitiers ishte thelbësor për këtë aktivitet pasi u thelluan njohuritë tona mbi metodologjitë inovatore që mund të përmirësojnë kërkimin shkencor dhe mësimdhënien. Kjo tryezë nxiti një shkëmbim dinamik të ideve dhe praktikave më të mira, duke kontribuar kështu në përparimin e praktikave akademike dhe kërkimore në FGJH dhe më gjerë.

Aftësimi nëpërmjet trajnimit

Bazuar në gjetjet dhe rezultatet e pyetësorëve mbi përdorimin e teknologjisë inovatore në mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe në rekomandimet e nxjerra pas këtyre rezultateve, grupi i punës së projektit e pa të domosdoshme realizimin e disa trajnimeve mbi rritjen e aftësive në përdorimin e digjitalizimit në kërkim shkencor, pavarësisht se nuk ishin parashikuar në planin e punës së këtij projekti.

Për doktorantët dhe kërkuesit e rinj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja u zhvillua një trajnim me temën: “Zgjedhja e korpunit studimor: Kërkimi në mësimdhënien e gjuhëve të huaja”. Ky aktivitet u mbajt në Laboratorin DiPLing-FGJH dhe kishte për qëllim të mbështeste formimin shkencor të studiuesve të rinj.

Trajnimi me temën: «Mjetet teknologjike për orën e mësimit (Mentimeter, AnswerGarden, Wooclap, WordItOut, Polls)» kishte në qendër pedagogët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të cilët patën mundësinë të njihen me këto aplikacione, të hapin llogari dhe të ndërtojnë materiale për përdorim të ardhshëm gjatë orëve të mësimit, workshopeve, trajnimeve dhe konferencave.

Dita Studimore me temën: «Sistemet e përllogaritjes së të dhënave të disertacionit: Statistikat sasiore/cilësore» me pjesëmarrjen e pedagogëve dhe kandidatëve doktorantë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, u mbështet nga Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF) dhe shërbeu për përzgjedhjen e mënyrave të përpunimit të të dhënave statistikore të punimeve shkencore, duke garantuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Ky informacion ishte veçanërisht i rëndësishëm për të ndihmuar studentët doktorantë në hartimin e artikujve shkencorë dhe në procesin e paraqitjes dhe publikimit të tyre në revista shkencore.

Dita e dytë Studimore me temën «Si të shkruajmë një artikull në revistat shkencore me faktor impakti», aktivitet i mbështetur gjithashtu nga AUF, ofroi njohuri të detajuara për studentët doktorantë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja lidhur me kriteret e publikimit të artikujve shkencorë në revista me faktor impakti dhe rëndësinë ndërkombëtare që ato kanë në fushën e kërkimit. Aktiviteti përfshiu gjithashtu hapat që ndiqen për publikimin e një artikulli shkencor në këto revista, përmes eksperiencës së dy pedagogëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Ky aktivitet përfshiu gjithashtu mbështetjen institucionale për promovimin e integritetit të teknologjive në procesin e mësimdhënies/nxënies. Aktiviteti përfundimtar përfshinte gjithashtu mbështetjen për botimin e artikujve shkencorë nga doktorantët e FGJH-së në revista shkencore me faktor impakti.

Vlera e projektit dhe kontributi i tij

Projekti “Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)” ka ofruar një vështrim të thelluar mbi përdorimin dhe nevojat për teknologji në proceset e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Gjetjet kryesore të projektit përfshijnë identifikimin e një niveli të lartë të interesit dhe domosdoshmërisë për përmirësimin e kompetencave digjitale ndër pedagogët dhe studentët, si dhe një nevojë të theksuar për trajnime specifike dhe mbështetje teknike për të përballuar sfidat e reja të arsimit të lartë në epokën digjitale.

Kontributi i këtij projekti qëndron në potencialin e tij për të ndikuar ndjeshëm në peizazhin e arsimit të lartë duke adresuar sfidat kryesore dhe duke shfrytëzuar mundësitë që lidhen me integrimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe kërkim në kuadër të ciklit të dytë të studimeve dhe programeve të doktoratës. Duke kuptuar se si teknologjia ndikon në rezultatet e të nxënit, pedagogët mund të përshtatin qasjet e tyre për të përmbushur më mirë nevojat e ndryshme të studentëve të ciklit të dytë dhe të doktoraturës.

Këto njohuri do të shërbejnë si një udhëzues/guidë për të gjithë ata që kërkojnë të optimizojnë përdorimin e teknologjisë duke nxitur një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies e mësimnxënies.

Nga analiza e nevojave dhe rezultatet e pyetësorit, rekomandohet që Universiteti i Tiranës të investojë më shumë në zhvillimin e kurseve dhe trajnimeve për përdorimin efektiv të teknologjisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Gjithashtu, sugjerohet krijimi i një platforme mbështetëse për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira midis pedagogëve dhe studentëve, si dhe promovimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për të ndarë burimet dhe ekspertizën.

Sugjerime për kërkime të ardhshme:

Bazuar në rezultatet e këtij projekti, kërkimet e ardhshme mund të fokusohen në disa drejtime kryesore:

- **Zhvillimi i moduleve të posaçme për aftësitë digjitale** - Kërkimet mund të adresojnë krijimin dhe implementimin e moduleve të trajnimit për aftësi specifike digjitale, të cilat do të përmirësojnë më tej kapacitetet e pedagogëve dhe studentëve për kërkim shkencor dhe mësimdhënie të bazuar në teknologji.
- **Vlerësimi i ndikimit të teknologjisë në rezultatet akademike** - Studimet e ardhshme mund të eksplorojnë sesi përdorimi i teknologjisë ndikon në përmirësimin e rezultateve akademike të studentëve dhe efektivitetin e mësimdhënies.
- **Analiza e barrierave teknologjike** - Kërkime të tjera mund të identifikojnë dhe analizojnë pengesat teknologjike që hasin pedagogët dhe studentët, duke ofruar zgjidhje konkrete për kapërcimin e tyre.
- **Studimi i ndërveprimit ndërmjet teknologjisë dhe pedagogjisë** - Një fushë tjetër e rëndësishme kërkimi mund të jetë studimi i ndërveprimit mes metodave pedagogjike dhe përdorimit të teknologjisë, për të krijuar një qasje të integruar dhe efektive në mësimdhënie dhe kërkim.

BIBLIOGRAFIA

Axhenda Digjitale Shqiptare 2015-2020

https://ogp.gov.al/uploads/2018/12/Strategjia_Axhenda_Dixhitale_e_Shqiperise_2015-2020.pdf
EDUCATION STRATEGY COUNCIL OF EUROPE 2024·2030 <https://rm.coe.int/education-strategy-of-the-council-of-europe-2024-2030/1680aace0c4>

Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Përmbledhje-e-legjislacionit-për-arsimin-e-lartë-perditesuar-deri-me-11.01.2023-Pdf-2.pdf>

Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025 <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=5136&token=bb17dd458df4936e6587679fd86684c2a6b779c7>

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 <https://arsimiparauniversitar.gov.al/vendim-nr-621-date-22-10-2021-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-saj/>

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023

<https://unitir.edu.al/arkiva-strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-2018-2023/>

Strategjia e Kërkimit Shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja 2022-2024, miratuar me Vendim Dekanatit nr. 135 datë 20.12.2022 <https://fgjh.edu.al/strategjia-e-kerkimit-shkencor-ne-fakultetin-e-gjuheve-te-huaja/>

Strategjia e ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, miratuar me Vendimin e Dekanatit Nr. 150 datë 21.12.2021 <https://fgjh.edu.al/strategjia-e-nderkombetarizimit-fgjh-nenshkruar-21-12-2021/>

Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie, miratuar me Vendimin e Dekanatit Nr. 43 datë 19.07.2023 <https://fgjh.edu.al/strategjia-e-teknologjise-dhe-inovacionit-nemesimdhenie-e-nxenie-nenshkruar-21-12-2021/>

Strategjia e zhvillimi të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (2021–2024) miratuar me vendimin e Dekanatit Nr. 150 datë 21.12.2021. <https://fgjh.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-fgjh-2021-2024-nenshkruar-21-12-2021/>

The Digital Education Action Plan (2021-2027) <https://education.ec.europa.eu/focus-topics/digital-education/action-plan>

INTEGRIMI I MJETEVE DIGJITALE NË PROCESIN MËSIMOR NË KONTEKST UNIVERSITAR: RASTI I FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA

Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi

Departamenti i Gjuhës Frënge
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës
E-mail: anida.kisi@unitir.edu.al

Prof. Asoc. Dr. Elona Toro

Departamenti i Gjuhës Frënge
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës
E-mail: elona.toro@unitir.edu.al

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Departamenti i Gjuhës Frënge
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës
E-mail: esmeralda.kromidha@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky artikull ofron një analizë të thellë të realitetit dhe perspektivave lidhur me integrimin e TIK-ut në mësimdhënien e gjuhëve të huaja në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Përdorimi i mjeteve digjitale në klasë ngre shumë pikëpyetje, kryesisht në dy aspekte: dobinë dhe efektivitetin e tyre pedagogjik, si dhe aftësitë e nevojshme që duhet të zotërojnë mësuesit. Si përdoret TIK-u në mësimin e gjuhëve të huaja? Çfarë vështirësish hasen? Cilat janë nevojat teknike dhe pedagogjike? Cilat janë nevojat për trajnim? Këto pyetje janë në qendër të shqetësimeve tona. Rezultatet e një sondazhi të kryer mes mësuesve të gjuhëve të huaja do të na lejojnë të kuptojmë më mirë situatën dhe të reflektojmë mbi avantazhet dhe disavantazhet e integritit të TIK-ut në sistemin tonë arsimor.

Fjalë çelës : TIK, gjuhë e huaj, trajnim, mësues, aftësi.

ABSTRACT

This article provides an in-depth analysis of the reality and perspectives regarding the integration of ICT in foreign language teaching at the Faculty of Foreign Languages of the University of Tirana. The use of digital tools in the classroom raises many questions, mainly in two aspects: their usefulness and educational effectiveness, as well as the necessary skills that teachers must possess. How are ICTs used in FL? What difficulties are encountered? What are the technical and pedagogical needs? What are the training needs? These questions are at the heart of our concerns. The results of a survey conducted among foreign language teachers will allow us to better understand the situation and reflect on the advantages and disadvantages of integrating ICT in our educational system.

Keywords: ICT, foreign language, training, teacher, skills.

Hyrje

Gjatë njëzet viteve të fundit, sistemi universitar shqiptar ka pësuar transformime të rëndësishme që kanë ndikuar në organizimin e studimeve, përmbajtjen e programeve dhe shumëllojshmërinë e diplomave. Reforma e Bolonjës dhe zbatimi i saj hapi perspektiva të reja integrimi dhe lehtësoi hapjen e universiteteve shqiptare ndaj homologëve të tyre evropianë dhe botërorë. Këto ndryshime kanë sjellë përfitime të shumta në rritjen e cilësisë së arsimit dhe harmonizimin e tij me standardet ndërkombëtare.

Që nga viti 1966, Departamenti i Gjuhës Franceze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (FGJH) pranë Universitetit të Tiranës ka qenë struktura kryesore në vend për trajnimin e mësuesve të gjuhës franceze për sistemin arsimor. Që nga viti 2007, modulet e TIK janë integruar në trajnimin fillestar të mësuesve në nivelin master në Didaktikë, dhe përmbajtja e programeve është modifikuar me qëllim përditësimin dhe përmirësimin e mësimdhënien. Ky zhvillim ka sjellë një rritje të interesit të mësuesve për teknologjinë dhe ka favorizuar integrimin e saj në klasa.

Aktualisht vihen re zhvillime pozitive dhe të shpejta që favorizojnë integrimin e teknologjisë digjitale në mësimdhënie dhe të nxëniet. Përdorimi i njeteve digjitale në klasë ngre shumë pyetje, kryesisht në lidhje me dobinë dhe efikasitetin e tyre pedagogjik, si dhe aftësitë e nevojshme të pedagogëve. Ky artikull ofron një reflektim analitik mbi realitetin dhe perspektivat e integrit të TIK në mësimdhënie e gjuhëve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Përmes një sondazhi të kryer mes pedagogëve të fakultetit, do të analizohen perceptimet, përvojat dhe praktikatat e mësimdhënies, duke ofruar një pasqyrë të plotë të sfidave dhe mundësive të kësaj fushe.

TIK, formimi i pedagogëve të gjuhës dhe infrastruktura digjitale

Deri në vitin 2003, vit i shënuar me nënshkrimin dhe fillimin e zbatimit të reformës së Bolonjës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës (Komisioni për Arsimin Universitar dhe Kërkimin Shkencor, 2014:12), kurrikula universitare për formimin e mësuesve të gjuhës franceze nuk ka përfshirë asnjë modul formimi për TIK. Megjithatë, duhet theksuar se studentët tashmë kishin njohuri bazë dhe aftësi fillestare në informatikë, software-ët Office dhe navigim në internet, të fituara përmes 40 orëve të lëndëve “Shkenca Kompjuterike” gjatë vitit të parë të studimeve universitare. Kështu, të gjithë mësuesit e gjuhës të diplomuar para vitit 2007 nuk kanë zhvilluar aftësi specifike në përdorimin e teknologjive për mësimdhënie/mësimnxënie të gjuhëve të huaja gjatë formimit të tyre fillestar.

Me sistemin e Bolonjës, Departamentet në FGJH kanë krijuar një diplomë master shkencor në mësimdhënie e gjuhëve të huaja duke përfshirë një modul TIK nga viti i parë i diplomës Master. Ky modul ka një objektiv të dyfishtë: nga njëra anë, përvetësimi i aftësive teknike në TIK dhe, nga ana tjetër, integrimi arsimor i njeteve multimediale dhe burimeve online për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të mësuarit.

Përveç kësaj, kurse të shumta trajnimi të vazhdueshme, duke përfshirë disa në TIK, janë ofruar për të gjithë mësuesit e gjuhëve (niveli universitar dhe parauniversitar) falë mbështetjes së Agjencisë Universitare të Frankofonisë (AUF).

Në vitin 2006, AUF hapi një kampus digjital në frëngjisht (CNF) në Tiranë, i cili ofron aktivitete trajnimi dhe shpërndarjen e informacionit shkencor dhe teknik. Shumë kurse trajnimi profesional janë organizuar në partneritet me universitetet anëtare të AUF-së në Shqipëri (përfshirë Universitetin e Tiranës), që synojnë trajnimin e trajnerëve dhe profesionistëve në fushat e TIK-ut dhe aftësive të TIK-ut. Që nga krijimi i saj, CNF e Tiranës ka organizuar rreth pesëdhjetë kurse trajnimi për trajnerë dedikuar mësuesve nga universitetet anëtare në Shqipëri, mësuesve të shkollave të mesme, pedagogëve, si dhe mësuesve nga vende të tjera të rajonit, si Rumania, Bullgaria, Polonia dhe Turqia.

Duke patur parasysh se kompetenca digjitale është një nga shtatë aftësitë kyçe që ofron kurrikula shqiptare e sistemit parauniversitar, e cila e konsideron mësuesin si ndërtues të njohurive, trajner dhe krijues mjedisesh të ngjashme me realitetin (IZHA, 2015). : 19), çdo vit, Ministria e Arsimit dhe Sportit publikon një listë të prioriteteve, ndër të cilat rekomandohet fuqimisht integrimi i TIK-ut në mësimdhënie/mësimnxënie. Instituti për Zhvillimin e Arsimit rekomandon gjithashtu përdorimin e formave hibride të trajnimit (pjesërisht të mësuarit në klasë dhe pjesërisht në distancë) ose të të mësuarit tërësisht në distancë (IZHA, 2016: 7). Publikohen raporte vjetore për trajnimin e mësuesve në shërbim, duke ofruar një pasqyrë të qartë të situatës aktuale, problematikave të hasura dhe propozime nga institucionet vendimmarrëse për përmirësimin e situatës.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka ngritur nivelin e infrastrukturës teknologjike në ndihmë të mësimin dhe kërkuesve shkencorë me laboratorë bashkëkohorë të Interpretimit dhe Përkthimit, Përkthim dhe Multimedia, Laboratorin e Fonetikës, Laboratorin e Kërkimit Shkencor dhe Integritimit të Teknologjive në Mësimdhënie, Laboratorit Kërkimor në Didaktikën e Gjuhëve të Huaja, Përkthim, Letërsi dhe Lingjistikë - DiPLing, Qendrën e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik si edhe Auditorin Multifunksional.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në vitin 2022 ka qenë fitues me 2 projekte në Thirrjen për Projekte të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023 dhe si rezultat i impelmentimit të suksesshëm të këtyre projekteve u realizuan 4 (katër) laboratorë të mësimdhënies dhe të kërkimit, të financuara drejtpërdrejt nga këto dy projekteve.

Gjithashtu nëpërmjet fondeve për kërkim dhe ekselencë të Universitetit të Tiranës gjatë vitit 2022 në FGJH u investua në 4 hapësira të dedikuara për kërkimin shkencor dhe procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, për trajnime të vazhduara për mësuesit, përkthyesit, ndërmjetësit kulturor dhe stafit të UT-së, që dëshirojnë të përfitojnë dijet e tyre në fushat përkatëse.

Risi është edhe investimi në një Qendër Multifunksionale të Këshillit Studentor dhe Klubeve studentore të FGJH-së, një mjedis bashkëkohor tërësisht në funksion të veprimtarive akademike dhe socio-kulturore të studentëve.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja vë theksin tek rëndësia e këtyre projekteve infrastrukturore në shërbim të zhvillimit të kapaciteteve të infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit duke mundësuar realizimin e hulumtimeve dhe punëve kërkimore me standarde të larta. Nga ana tjetër, këto projekte kanë një impakt të drejtpërdrejtë në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, inovacionit pedagogjik në mësimdhënie, rrjetëzimit të kërkuesve shkencorë vendas e të huaj duke realizuar takime, tryeza apo konferenca të përbashkëta.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës ka bërë përparime të rëndësishme në ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore për të mbështetur mësimdhënien dhe kërkimin

shkencor, duke krijuar laboratorë të specializuar dhe hapësira për trajnime të vazhduara, si dhe duke realizuar projekte të suksesshme për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit. Këto investime janë të rëndësishme për rritjen e cilësisë së arsimit dhe kërkimit, si dhe për përmirësimin e kapaciteteve akademike dhe didaktike në Shqipëri.

Orientimet strategjike dhe standarde teorike mbi aftësitë digjitale të mësuesve

Përmirësimi dhe funksionimi i duhur i teknologjisë digjitale në procesin mësimor përbën një bosht madhor veprimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arritjen e objektivit të dytë strategjik: “Të nxënit cilësor dhe bashkëpunues”. Kjo nismë zhvillohet rreth tre komponentëve kryesorë: infrastrukturës, përbajtjes digjitale mësimore dhe aftësive të mësuesve (MASR, 2021).

Për sa i përket infrastrukturës, është thelbësore që institucionet të pajisen me mjetet e nevojshme të TI-së, si kompjuterët dhe tabelat digjitale dhe të garantohet një lidhje interneti me shpejtësi të lartë, e aksesueshme në zona të ndryshme të institucioneve arsimore, përtej sallave të informatikës. Aspekte të tjera të rëndësishme përfshijnë mbështetjen teknike, aksesin në portalet arsimore dhe krijimin e një kuadri legjislativ dhe infrastrukturor për komunikimin digjital institucional (blogimi, ndarja e skedarëve, rrjetet sociale, videokonferencat).

Për sa i përket përbajtjes mësimore digjitale, synohet krijimi i burimeve digjitale në gjuhën shqipe, në përputhje me kurrikulën kombëtare dhe Kornizën e Kompetencave të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për Mësuesit (UNESCO, 2012). Lundrimi i sigurt për studentët dhe ndërgjegjësimi për rreziqet që lidhen me internetin, si dhe hapat e nevojshëm për respektimin e të drejtës së autorit dhe pronës intelektuale, janë gjithashtu prioritetet.

Zhvillimi i aftësive të mësuesve përfshin promovimin e modeleve të suksesshme të të mësuarit duke përdorur përbajtjen digjitale, zbatimin e standardeve ndërkombëtare për vlerësimin e aftësive të mësuesve në TIK dhe për trajnimin e tyre, shkëmbimet ndërmjet shkollave dhe mësuesve dhe krijimin e rrjeteve lokale dhe kombëtare.

Në kuadër të digjitalizimit të procesit mësimor dhe përvojës së krijuar në mësimdhënie të zhvilluar me ndihmën e teknologjive gjatë pandemisë Covid 19, studentë dhe mësuesit e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH) të Universitetit të Tiranës, u përballën me sfida në drejtim të njohjes dhe përdorimit të mjeteve digjitale për qëllime akademike. Në këto kushte, mësuesit dhe studentët u nxitën të zhvillojnë risi pedagogjike në vend të të mësuarit tradicional në klasë, duke zhvilluar metoda më aktive bashkëpunuese.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka zhvilluar një sërë strategjish për zhvillimin e infrastrukturës digjitale të fakultetit (Strategjia e zhvillimit të Fakulteteve të Gjuhëve të Huaja 2021-2024, 2021:11) por edhe për zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Siç e theksuam edhe më lartë, sallat e ofruara nga fakulteti janë aktualisht të pajisura me tabela digjitale dhe me një lidhje interneti me shpejtësi të lartë. Një sërë kursesh trajnimi për përmirësimin e aftësive digjitale të ekipit mësimdhënës dhe studentëve u zbatuan në periudhën 2021-2024. (Strategjia e mësimdhënies në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, 2022: 9)

Në këtë kontekst, kemi vërejtur se është e nevojshme jo vetëm zotërimi i përdorimit të mjeteve digjitale, por edhe integrimi i tyre për të ndihmuar në mënyrë efektive si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në procesin e të nxënit. Teknologjitë e informacionit

dhe komunikimit duhen konsideruar si mjete thelbësore, jo vetëm për kërkimin e informacionit dhe për të bërë prezantime, por edhe për të kontribuar në ndërtimin e koncepteve, aftësive dhe qasjeve të mësimdhënies (IZHA, 2016: 8-11).

Shumë studiues pajtohen me mendimin se integrimi i TIK-ut në arsim ka transformuar metodat e mësimdhënies dhe të të nxëniet, dinamikën ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, si dhe marrëdhënien me dijen (Devauchelle, 2012). Këto transformime e ndërlikojnë rolin e mësuesve (Lessard dhe Tardif, 1999). Ndryshimi i konteksteve arsimore kërkon zhvillimin e aftësive të reja, veçanërisht teknologjike dhe transversale, thelbësore për integrimin e teknologjisë digjitale në klasë. *“Përtej këtij efekti pozitiv psikologjik, teknologjitë dixhitale, në përdorimet e tyre pedagogjike, janë mjete që nxisin nxënien, duke modifikuar thellësisht strategjitë e nxënësve për të nxënë dhe të mësuesve për mësimdhënien”* (Klein, 2013, f. 8).

Perrenoud¹ mbështet integrimin e teknologjive të reja në mësimdhënie për të demokratizuar arsimin, për të diferencuar pedagogjinë dhe për të reduktuar dështimin akademik. TIK-u e inkurajon rinovimin e përbajtjes dhe metodave të mësimdhënies dhe promovon qasje aktive, pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese. Kjo siguron një hapje të shkollës ndaj komunitetit, sjell një njohje më të mirë të diversitetit kulturor, zgjeron dialogun me prindërit dhe inkurajon pjesëmarrjen e tyre në jetën shkollore (Perrenoud, 1994).

Raby (2004) identifikon katër faza në procesin e integritit të TIK-ut:

- *Faza e ndërgjegjësimit*: mësuesi e përdor TIK-un pak ose aspak, por ai ka rreth vetes mësues që e përdorin.
- *Faza e përdorimit personal*: përfshin tri faza: motivimin, familjarizimin dhe eksplorim-përvetësimin.
- *Faza e përdorimit profesional*: përfshin motivimin dhe përvetësim-eksplorimin, me mësuesin që përdor TIK-un për të kërkuar informacion, komunikuar, shkëmbyer dhe prodhuar burime pedagogjike.
- *Faza e përdorimit pedagogjik*: ndahet në katër etapa: njohje, eksplorim, integrim dhe përvetësim. Kjo fazë karakterizohet nga përdorimi i shpeshtë dhe i rregullt i TIK-ut nga studentët në kontekste të të nxëniet aktiv dhe kuptimplotë, siç janë projektet, qasja bashkëpunuese dhe zgjidhja e problemeve (Raby, 2004, f. 55).
- *Faza e fundit, përdorimi shembullor*, ka të bëjë me mësuesit që mund të shërbejnë si model për kolegët e tyre.

Në Shqipëri, udhëzimet institucionale për integrimin e TIK-ut në mësimdhënie përputhen me parimet e “Kornizës së Kompetencës së TIK-ut të UNESCO-s për mësuesit”. “Përdorimi i teknologjive të reja në arsim nënkupton role të reja për mësuesit, pedagogji të reja, si dhe qasje të reja për trajnimin e mësuesve” (UNESCO, 2012: f. 14). Integrimi i suksesshëm i TIK-ut në klasë varet nga aftësia e mësuesve për të strukturuar në mënyrë novatore mjedisin mësimor, për të bashkuar teknologjitë me pedagogji të reja dhe për të krijuar klasa më aktive, duke stimuluar ndërveprimin bashkëpunues (UNESCO, 2012: f. 15). Kuadri thekson se zhvillimi profesional i mësuesve është thelbësor për përmirësimin e arsimit dhe duhet të fokusohet në disa ndryshime në mësimdhënie, duke ekspozuar aftësitë e nevojshme në të gjitha aspektet e veprimtarisë profesionale të mësuesve e pedagogëve.

¹ Ph. Perrenoud – profesor në Fkultetin e psikologjisë dhe shkencave të edukimit, Universiteti i Gjenevës.

Analiza e të dhënave të pyetësorit

Në kudër të projektit « Didaktika Digjital e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)» ne kryem një anketim të pedagogëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH) nëpërmjet një pyetësori me synimin për të vlerësuar aftësitë e tyre në përdorimin e mjeteve digjitale në auditor dhe jashtë tij, përfitimet që përdorimi i tyre sjell për studentët, si dhe sfidat e hasura gjatë integrimit të teknologjisë në procesin mësimor. Pyetësori përmbante 19 pyetje dhe mori 41 përgjigje, duke përdorur Google Forms si platformë për mbledhjen e të dhënave. Përgjigjet u gjeneruan në mënyrë automatike nga platforma Google Forms. Pyetjet ishin kryesisht me alternativa dhe vetëm një pyetje e hapur për komente.


Pyetjet synonin të tregonin:

- përdorimin e llojeve të mjeteve digjitale nga pedagogët në auditor dhe në shtëpi;
- llojet e veprimtarive mësimore të zhvilluara me këto mjete;
- të mirat dhe vështirësitë në përdorimin e tyre;
- perceptimin e pedagogëve mbi aftësinë e tyre digjitale;

Një nga pyetjet e para të pyetësorit kërkonte të vlerësonte aftësitë digjitale të pedagogëve në përgatitjen e veprimtarive mësimore. Përgjigjet treguan një zotërim shumë të mirë të nivelit të aftësive, me një pjesë të konsiderueshme të të anketuarve që ndjeheshin të sigurt në përdorimin e teknologjisë, ndërsa disa të tjerë shprehën nevojën për përmirësim të mëtejshëm.


A e ndjeni të nevojshme të përmirësoni aftësitë tuaja digjitale në përdorimin e mjeteve/burimeve të informacionit në kuadër të përgatitjes së veprimtarive mësimore ?

41 responses



Grafiku 1: A e ndjeni të nevojshme të përmirësoni aftësitë tuaja digjitale në përdorimin e mjeteve/burimeve të informacionit në kuadër të përgatitjes së veprimtarive mësimore?

Në auditor, mjetet më të përdorura nga pedagogët përfshijnë projektorët, programet e paraqitjes, dhe platformat online për diskutime. Jashtë auditorit, pedagogët përdornin shpesh burime të tilla si platforma të menaxhimit të mësimit dhe mjetet për krijimin e materialeve edukative.



Grafiku 2: Në auditor, cilat nga këto mjete përdorni për kryerjen e veprimtarive mësimore?

Ndarja e përgjigjeve tregon se mjete të prezantimit si PPT dhe video janë përdorur nga 65.9% e të anketuarve, ndërsa mjetet e bashkëpunimit online si Google Drive dhe Teams janë përdorur nga 41.5%. Mjete të vlerësimit online si Quizlet dhe Kahoot janë përdorur nga 19.5% e të anketuarve, dhe mjete të editimit dhe krijimit të materialeve si Canva nga 9.8%. Mjetet e mësimit në distancë si Zoom dhe Google Meet janë përdorur nga 85.4%, ndërsa mjetet e komunikimit sinkron për chat dhe mesazhe nga 58.5%, dhe për video thirrje nga 63.4%. Dokumentet dëgjimore-pamore janë përdorur nga 75.6%, pajisjet digjitale të prezantimit nga 92.7%, dhe mjetet e vlerësimit online si Forms nga 2.4%. Ky grafik ndihmon për të kuptuar frekuencën e përdorimit të mjeteve mes të anketuarve, duke treguar që pajisjet digjitale të prezantimit, mjetet e mësimit në distancë dhe dokumentet audio-vizive janë më të përdorurat. Kjo tregon një tendencë të qartë drejt teknologjisë digjitale dhe mësimit në distancë, duke reflektuar nevojat për fleksibilitet dhe ndërveprim në procesin mësimor.



Grafiku 3: Jashtë auditorit, cilat nga këto mjete përdorni ju për zhvillimin e veprimtarive mësimore?


Mjetet e mësimit në distancë si Zoom dhe Google Meet janë më të përdorurat me 85.4%, pasuar nga mjetet e komunikimit sinkron (chat, mesazhe) me 78%, dhe prezantimet (p.sh. PPT, video) me 53.7%. Mjetet e bashkëpunimit online (p.sh. Google Drive, Teams) përdoren nga 29.3% dhe mjetet e vlerësimit online (p.sh. quizlet, kahoot) nga 22%. Shikimi i materialeve audio-vizive dhe komunikimi sinkron për video thirrje

janë gjithashtu shumë të përdorura me përkatësisht 70.7% dhe 73.2%. Mjetet e editimit dhe krijimit të materialeve përdoren më pak, vetëm nga 14.6% e të anketuarve. Ky grafik pasqyron qartë varësinë e konsiderueshme të përdoruesve nga mjetet digjitale dhe teknologjia për mësimin dhe komunikimin jashtë auditorit, duke theksuar rëndësinë e fleksibilitetit dhe ndërveprimit në procesin mësimor bashkëkohor.

Një pyetje specifike synonte të tregonte se si pedagogët i kishin fituar aftësitë e tyre në përdorimin e mjeteve digjitale. Shumica dërrmuese e të anketuarve (87.8%) kanë mësuar nëpërmjet kërkimeve personale online, duke treguar rëndësinë e vetë-mësimit dhe qasjes në burimet e informacionit të disponueshme në internet. Gjithashtu, pjesëmarrja në kurse dhe trajnime (51.2% në klasë dhe online 41.5%) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e këtyre aftësive. Ndërkohë, vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve (26.8%) kanë mësuar nga kolegët, duke sugjeruar se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave mes mësuesve mund të jetë një hapësirë për mirësimi.

Nga rezultatet, është e qartë se shumica dërrmuese e pedagogëve përdorin mjete dhe burime informacioni çdo ditë për qëllime mësimdhënieje (56.1%), ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme i përdor ato një herë në javë (34.1%). Kjo tregon një varësi të lartë nga këto mjete për të mbështetur procesin mësimor në përditshmëri.

Sa shpesh i përdorni ju këto mjete/burime informacioni për qëllime mësimdhënieje:
41 responses




Grafiku 4: Sa shpesh i përdorni ju këto mjete/burime informacioni për qëllime mësimdhënieje?

Një tjetër pjesë e rëndësishme e pyetësorit shqyrtonte përfitimet e përdorimit të mjeteve digjitale për studentët. Përgjigjet sugjeruan se përdorimi i teknologjisë ndihmonte në përmirësimin e angazhimit dhe ndërveprimit me studentët, si dhe në lehtësimin e qasjes në burime të ndryshme mësimore.

Në lidhje me llojet e veprimtarive mësimore online, shumica e të anketuarve preferojnë të zhvillojnë shpjegimin e koncepteve (55%), ndjekur nga vlerësimi i njohurive përmes testeve online (34%), plotësimi i informacioneve nga burime online (37%), dhe bashkëpunimi online për punë në grup (30%). Nëse vijohet me analizën, përfitimet e përdorimit burimeve digjitale të informacionit në studimin në shtëpi përfshijnë mundësinë për të marrë informacion sipas preferencave personale (67%), përdorimin e burimeve të ndryshme të informacionit në përputhje me stilin e mësimit (39%), gjetjen e informacionit nga burime të ndryshme (34%), dhe ndjekjen e ritmit të vet të mësimit (30%).

Ndër strategjitë e të mësuarit aktiv, 71% e pedagogëve përdorin të mësuarin në bashkëpunim, 56% të mësuarit bazuar në problemzgjdhje ose projekt dhe të mësuarit

duke vepruar. Pedagogët vlerësojnë se studentët i përdorin aktualisht mjetet digjitale për t'u ushtruar, për të bashkëpunuar, për të marrë informacione dhe për të mësuar në mënyrë të pavarur.



Grafiku 5: Cilat strategji të të mësuarit aktiv përdorni në klasën tuaj?

Pyetjet përfunduese të pyetësorit trajtonin problemet dhe sfidat që pedagogët kishin hasur gjatë përdorimit të mjeteve digjitale. Sfidat e zakonshme përfshinin probleme teknike, mungesë të pajisjeve të mjaftueshme, dhe nevojën për trajnime të mëtejshme për të përdorur në mënyrë efektive teknologjinë në mësimdhënie. Megjithatë, disa probleme që kanë përmendur të anketuarit lidhen me vështirësitë e përdorimit të këtyre mjeteve nga celulari (29%), vështirësinë në zgjedhjen e burimeve të duhura të informacionit (23%), dhe mungesën e besimit në informacionin e gjetur online (23%). Në këtë kontekst, shfaqet nevoja për një përmirësim të aksesit dhe besueshmërisë së burimeve të disponueshme në internet për të përmirësuar përvojën e studimit në shtëpi.

Nga ana tjetër, pedagogët ndjejnë nevojën për të përmirësuar aftësitë e tyre digjitale në përdorimin e mjeteve digjitale në kuadër të veprimtarive mësimore dhe janë mëse të bindur për ndikimin pozitiv të tyre në përvojën e mësimdhënies. Shumica e pedagogëve theksuan nevojën për trajnim të vazhdueshëm në përdorimin e mjeteve digjitale për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe për të mbajtur hapin me ndryshimet e shpejta teknologjike.

Diskutime dhe Përfundime

Aftësitë, interesi dhe qasja pozitive për të integruar mjetet digjitale në mësimdhënie janë disa nga pikat më të forta të evidentuara në këtë studim. Ky entuziazëm dhe gatishmëria për të përdorur teknologjinë krijojnë një bazë të qëndrueshme për përmirësimin e procesit mësimor dhe rritjen e angazhimit të nxënësve.

Ndonëse aftësitë dhe interesi janë të larta, ka disa drejtime që kërkojnë përfundim dhe përmirësim të aftësive. Përshtatja optimale e mjeteve me objektivat dhe rezultatet e synuara të të nxënësve, e njohur si skenari pedagogjik, është thelbësore për të siguruar suksesin e teknologjisë në procesin mësimor. Gjithashtu, zhvillimi i aftësive digjitale të studentëve dhe pedagogëve duhet të vazhdojë të jetë një prioritet, për të siguruar përdorimin efektiv dhe të qëndrueshëm të mjeteve digjitale në mësimdhënie.

Pedagogët shprehin dëshirën për trajnime periodike, pasi përditësimi i njohurive është i nevojshëm për shkak të ndryshimeve të shpejta në mjetet digjitale. Integrimi i TIK në mësimdhënie është i pashmangshëm dhe aftësimi digjital është pjesë e formimit të përgjithshëm të pedagogëve dhe studentëve. Ky aftësim duhet të përditësohet dhe

përshtatet me nevojat specifike për të ndihmuar dhe mos penguar procesin mësimor.

Një tjetër shqetësim është ruajtja e qasjes të studentëve në llogaritë e tyre në Teams, që të vazhdojnë ta përdorin atë si pjesë të përditshmërisë. Është vënë re se shumë studentë nuk e përdorin më, ndoshta sepse edhe pedagogët nuk e përdorin më. Platforma mësimore digjitale Teams duhet shfrytëzuar për të ruajtur kontaktin me mësimdhënien në distancë dhe për të përmirësuar aftësitë ndërdisiplinore të studentëve. Mjetet digjitale janë ndihmuese, efikase dhe motivuese në procesin mësimor.

Institucioni duhet të organizojë më shumë trajnime për integrimin e mjeteve digjitale bashkëkohore në procesin mësimor. Një proces i suksesshëm arrihet kur studentët kanë të garantuara pajisjet, internetin dhe njohuri të mira për të realizuar studimin jo vetëm në auditorë por edhe jashtë tyre. Trajnimet e vazhduara janë të nevojshme për njohjen dhe përdorimin konkret të metodave të digjitalizuara në mësimdhënie.

Sidoqoftë, përdorimi i mjeteve digjitale nuk duhet të zëvendësojë çdo aspekt të mësimdhënies dhe nxënies. Librat dhe materialet tradicionale duhet të vazhdojnë të përdoren, pasi kanë rëndësinë e tyre. Mjetet digjitale janë të vlefshme për zhvillimin sa më të mirë të orës së mësimi dhe ndihmojnë procesin mësimor kur përdoren në mënyrë inteligjente.

BIBLIOGRAFIA

DEVAUCHELLE, B. (2012) *COMMENT LE NUMÉRIQUE TRANSFORME LES LIEUX DU SAVOIR*. LIMOGES, FYP ÉDITIONS.

GUICHON, N., (2012) *VERS L'INTÉGRATION DES TIC DANS L'ENSEIGNEMENT DES LANGUES*. PARIS, DIDIER.

HAXHIYMERI, E. & N. MITA, (2015) *RAPORT MBI ZHVILLIMIN PROFESIONAL DHE VLERËSIMIN E MËSUESVE NË SHQIPËRI*. TIRANA, KOALICIONI PËR ARSIMIN E FËMIJËVE NË SHQIPËRI - [EN LIGNE]. DISPONIBLË EN [HTTP://WWW.CRCA.AL/SITES/DEFAULT/FILES/PUBLICATIONS/RAPORT%20PER%20VLERESIMIN%20E%20MESUESVE.PDF](http://www.crca.al/sites/default/files/publications/RAPORT%20PER%20VLERESIMIN%20E%20MESUESVE.PDF) [DERNIER ACCÈS LE 15 FÉVRIER 2018]

Demaizière, F. & M. Grosbois. (2014) "Numérique et enseignement-apprentissage des langues en Lansad – Quand, comment, pourquoi ?». In *apprentissage des langues et systèmes d'information et de communication (Alsic)*. Vol.17 [ligne]. Disponible en <http://journals.openedition.org/alsic/2691> [Dernier accès le 15 février 2018] DOI : 10.4000/alsic.2691

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, (2015) *Të nxënit në situata, konstruktivizmi dhe teknologjia*. IZHA, MASH, - [En ligne]. Disponible en <http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2017/03/Udhezuesi-me-situata-te-te-nxenit-me-TIKun.pdf> [Dernier accès le 15 février 2018]

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, (2016) *Raporti Kombëtar për identifikimin e nevojave për trajnim të drejtuesve dhe mësuesve të shkollave në arsimin parauniversitar*. Tirana, IZHA - [En ligne]. Disponible en <http://online.fliphtml5.com/zovq/lisj/#p=9> [Dernier accès le 15 février 2018]

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, (2016) *Raporti mbi formimin fillestar të mësuesve në Institucionet e Arsimit të lartë Shqiptar*. Tirana, IZHA - [En ligne]. Disponible en :<http://izha.edu.al/neë/2017/03/21/raport-formimi-fillestar-i-mesuesve-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-shqiptar/> [Dernier accès le 15 février 2018]

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, (2017) *Raporti i arritjeve IZHA, shtator 2013- dhjetor 2016*. Tirana, IZHA - [En ligne]. Disponible en <http://izha.edu.al/neë/2017/03/30/raporti-i-arritjeve-izha/> [Dernier accès le 15 février 2018]

Karsenti, T., (2008) Intégration pédagogique des TIC : quelles sont les stratégies les plus efficaces? Communication présentée à praTIC, Genève - [En ligne]. Disponible en <http://tecfa.unige.ch/pratic/ressources/conferences.php> [Dernier accès le 15 février 2018]

Komisioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, (2014) *Raporti përfundimtar për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*. Tiranë, - [En ligne]. Disponible en : https://arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf [Dernier accès le 15 février 2018]

Lessard, C. & M. Tardif, (1999) *Le travail enseignant au quotidien : contribution à l'étude du travail dans les métiers et les professions d'interactions humaines*. Québec, Presses de l'Université Laval.

Mangenot, F., (2000) L'intégration des TICE dans une perspective systémique. in *Langues modernes*, Vol 3/2000, pp. 38-44.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise (2017) *Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë*. Tirana, MASH - [En ligne]. Disponible en : http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/parauniversitar/ZHPA/Udhezimi_per_Zhvillim_Profesional.pdf [Dernier accès le 15 février 2018]

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise (2014) *Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020*, Disponible en

<https://arsimi.gov.al/files/userfiles/apu/2016/STRATEGJIA-2014-2020.pdf> [Dernier accès le 15 février 2018]

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise, (2014) *Reforma e sistemit arsimor parauniversitar, raporti paraprak*. Tirana, MASH - [En ligne]. Disponible en

https://arsimi.gov.al/files/userfiles/parauniversitar/RAPORTI_Korrik.pdf [Dernier accès le 15 février 2018]

Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, (2014) *Draft Strategjia, Axhenda digjitale e Shqipërisë*. Tirana, MIAP - [En ligne]. Disponible en http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/14-11-11-03-51_2014-2020 [Dernier accès le 15 février 2018]

Raby, C., (2004) *Analyse du cheminement qui a mené des enseignants du primaire à développer une utilisation exemplaire des technologies de l'information et de la communication (TIC) en classe*, Thèse de doctorat, Université du Québec à Montréal, - [En ligne]. Disponible en <https://tel.archives-ouvertes.fr/edutice-00000750> [Dernier accès le 15 février 2018]

UNESCO, (2012) *TIC UNESCO: un référentiel de compétences pour les enseignants*. Paris, UNESCO - [En ligne]. Disponible en <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002169/216910f.pdf> [Dernier accès le 15 février 2018]

HARMONIZIMI I MËSIMDHËNIES DHE KËRKIMIT SHKENCOR NË FGJH-UT ME STANDARDET KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE

Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: daniela.hasa@unitir.edu.al

Dr. Migena Sejдини

Departamenti i Gjuhës Gjermane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: migena.sejdini@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky artikull paraqet rezultatet e kërkimeve dhe hulumtimeve të kryera në kuadër të projektit “Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)”. Projekti synon të promovojë përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në të gjitha nivelet e studimeve. Harmonizimi i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare është thelbësor për të garantuar cilësinë e lartë të arsimit në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (FGJH), duke kontribuar në formimin cilësor të studentëve. Ky punim është i bazuar në një analizë cilësore të të gjithë dokumentacionit të institucionit, kuadrit ligjor në nivel kombëtar, strategjive kombëtare dhe institucionale, dhe rregulloreve përkatëse të hartuara në zbatim. Gjithashtu, analizohen masat e marra për njohjen e stafit pedagogjik me praktikat më të mira ndërkombëtare, dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Qëllimi i analizës është të evidentojë situatën aktuale në FGJH dhe të japë rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit për ta afruar fakultetin tonë me standardet e institucioneve evropiane të arsimit të lartë.

Fjalët çelës: didaktika digjitale, kuadër ligjor, Infrastrukturë bashkëkohore, kërkim shkencor, mësimdhënie/nxënie, inovacion

ABSTRACT

This article presents the research results conducted in the context of the project “Digital Didactics of Teaching/Learning and Scientific Research at UT - (DiDiRes).” The project aims to promote technology integration to further improve the teaching and scientific research process at all levels of study provided by the Faculty of Foreign Languages, University of Tirana. Harmonising teaching and scientific research with national and international standards is essential for ensuring high-quality education at the Faculty of Foreign Languages so that students graduating are equipped with updated skills and knowledge. The research method used for this article is qualitatively based on desktop research of all the institution’s documentation, legal framework, national and institutional strategies, and relevant regulations in application. Further, it analyses the measures taken to introduce the best international practices to the academic staff and to equip them with the skills to use technology effectively in teaching and scientific research. The analysis aims to highlight the current context at the Faculty of Foreign Languages and provide recommendations for further development to align the Institution with the standards of European higher education institutions. **Keywords:** digital didactics, legal framework, modern infrastructure, scientific research, teaching/learning, innovation

Hyrje

Ky artikull është rezultat i kërkimeve dhe hulumtimeve të kryera në kuadër të projektit “*Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT - (DiDiRes)*”, i cili synon ndër të tjera, që përmes përfundimeve dhe rekomandimeve të japë ndihmesën e tij në nxitjen e përdorimit të teknologjisë për të përmirësuar më tej procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe kërkimit shkencor në të gjitha nivelet e studimit.

Harmonizimi i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare është sa nevojë aq edhe detyrim, pasi qëllimi i tij është sigurimi i një cilësie sa më të lartë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhëve të huaja si dhe dhënia e një kontributi sa më të gjerë në fushën shkencore. Për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja ky harmonizim buron edhe si detyrim nga misioni që ky fakultet i ka caktuar vetes: “të kontribuojë në formimin cilësor të studentëve, në përmbushjen personale të tyre, në krijimin e mirëkuptimit të ndërsjellë, të harmonisë shoqërore dhe ndjenjës së qytetarisë globale të shekullit XXI, të shërbejë si urë komunikimi për çështjet me interes kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke krijuar një hapje dhe ndjeshmëri ndaj kulturave të ndryshme ...”

Duke marrë në shqyrtim dhe duke analizuar një dokumentacion me diapazon të gjerë që zotëron institucioni, nisur nga kuadri ligjor dhe rregullator, strategjitë e hartuara në nivel kombëtar dhe në nivel institucioni, kurrikulat e ofruara, puna e bërë për njohjen e stafit pedagogjik me dokumentet e njësuara dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, situatën në lidhje me infrastrukturën moderne dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie/mësimnxënie dhe kërkim shkencor, përpjekjet e bëra për arrijten e ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, akreditimin e programeve studimore të ofruara nga institucioni, hapat e ndërmarrë lidhur me procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, mbështetjen e kërkimit shkencor në nivel institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të punës në institucion, mbështetjen dhe mundësitë që u ofrohet studentëve në aspektin e gjithëpërfshirjes dhe përgatitjes së tyre në fushën e kërkimit shkencor, është bërë e mundur evidentimi i hapave konkretë, që ka ndërmarrë Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Kështu, fakulteti ynë synon të jetë sa më pranë institucioneve evropiane të Arsimit të Lartë, duke u bërë më tërheqës dhe më konkurrent në vend. Qëllimi i shqyrtimit të këtyre dokumenteve, nuk është vetëm evidentimi i situatës aktuale në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, por edhe formulimi i rekomandimeve, të cilat do ta ndihmonin institucionin të zhvillohej më tej.

Panoramë e kuadrit ligjor dhe rregullator në nivel kombëtar

Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, mësimdhënia dhe puna kërkimore shkencore realizohen në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Neni 18 i këtij ligji, pika 5 e përcakton Universitetin si institucion të arsimit të lartë që “*ofron programe studimi në të gjitha ciklet, si dhe programe studimi me karakter profesional*”. Gjithashtu neni 93 i këtij ligji e ngarkon këtë institucion të arsimit të lartë edhe me kryerjen e veprimtarisë kërkimore shkencore duke synuar integrimin e kësaj veprimtarie në mësimdhënie si dhe që “*të kontribuojë në zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit*” (neni 93, pika 3).

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka hartuar një sërë dokumentesh, mes te cilave rregullore në nivel njësie baze dhe fakulteti, politika dhe strategji, ku një rol të rëndësishëm luajnë “*Strategjia e zhvillimit të fakultetit të Gjuhëve të Huaja (2021 – 2024)*”, (dhjetor 2021); “*Strategjia e ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja*” (dhjetor 2021); “*Strategjia dhe politikat e marketingut të Fakultetit të gjuhëve të Huaja*” (dhjetor 2021).

Gjithë dokumentacioni është përpiluar në frymën e strategjive dhe rregulloreve të hartuara në nivel kombëtar, të cilat nga ana e tyre në aspekte të caktuara mbështeten edhe në dokumente ndërkombëtare. Ndër të cilat do të donim të veçonim:

“*Draft Strategjia për Arsimin 2021-2026*” ku përcaktohet kuadri i politikave shtetërore për arsimin në Republikën e Shqipërisë, strategji sektoriale dhe ndërsektoriale si dhe një sërë dokumentesh që kanë të bëjnë me politikat e zhvillimit të arsimit në Shqipëri. Kjo strategji merr një rëndësi për FGJH-në, ndër të tjera edhe për faktin se ky institucion përgatit edhe mësueses të ardhshëm.

“*Agjenda digjitale e Shqipërisë 2022-2026*”, e cila fokusohet në përdorimin dhe zhvillimin e teknologjisë për të përmirësuar infrastrukturën digjitale me efekt të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e procesit mësimor në përputhje me standardet ndërkombëtare;

“*Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm*” e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, objektivi i katër i të cilit (mes 17 të tillave) synon të sigurojë një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të drejtë si dhe të nxisë mundësi për të mësuarin e vazhdueshëm për të gjithë. Veçanërisht pika 3 e këtij objektivi lidhet drejtpërdrejtë me përfshirjen e arsimit universitar në këtë agjendë.

“*Pakti për Universitetin*”, i cili synon të rrisë cilësinë dhe efikasitetin e universiteteve në Shqipëri, si në drejtëm të mësimdhënies dhe në fushën e kërkimit shkencor.

“*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020*” (SKZHI II), e cila si dokumenti themelor strategjik, ndërlihd agjendën e integritit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit. Ndër pesë objektivat e tij, që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, në shërbim të qëllimit të këtij hulumtimi do të veçonim rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe rritjen e kontributit të “Albanian excellence” në tregun e punës.

“*Agjenda digjitale e Shqipërisë 2022-2026*”, e cila lidhet me një nga temat më aktuale dhe të rëndësishme si në aspektin e mësimdhënies e mësimnxënies, ashtu edhe në atë të kërkimit shkencor dhe prek në mënyrë të drejtpërdrejtë punën e përditshme të stafit akademik, atij administrativ dhe studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, në veçanti objektivi katër “*Edukimi digjital dhe aftësitë digjitale: transformimi i të mësuarit dhe mësimdhënies*”

“*Plani kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale broadband 2020-2025*” është një strategji për instalimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës broadband në të gjitha sferat e jetës. Midis shtatë objektivave specifike kombëtare për broadband-in për periudhën 2020-2025, drejtpërdrejt me arsimin lidhet objektivi që parashikon se nga fundi i vitit 2025 100% e IAL-ve të jenë të lidhura me broadband me shpejtësi 1 Gbps, si edhe rrjeti Akademik Shqiptar të jetë pjesë e rrjetit evropian të High Performance Computer (HPC).

“*Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022*”, ku përcaktohen dhe objektivat kryesore, që kanë të bëjnë me konsolidimin e mëtejshëm të reformës së arsimit të lartë e kërkimit shkencor dhe harmonizimin e saj me parimet e Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor – ERA. Për realizimin e objektivave të saj strategjia siguron një bashkëpunim më të fortë dhe të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjës. Kjo strategji mbështet Kërkimin Shkencor për nxitjen e Inovacionit dhe zhvillimin e teknologjisë në bashkëpunim me sektorin e biznesit, ku janë përcaktuar indikatorë të përmbyshjes së këtij prioriteti strategjik, që lidhen me rritjen e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimit shkencor dhe biznesit.

Një rëndësi të veçantë për rolin dhe veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë në lëmin e kërkimit shkencor paraqet “*Qendra ndërinstitucionale e rrjetit akademik*

shqiptare”, e cila u ngrit me vendim të vitit 2018 si një institucion në shërbim dhe mbështetje të zhvillimit në aspektin e TIK dhe ndërlidhjes së veprimtarisë së kërkimit shkencor të institucioneve të arsimit të lartë dhe të palëve të treta, përmes zhvillimit dhe promovimit të projekteve.

Masat e marra nga FGJH në zbatim të kuadrit rregullator dhe për të adresuar sfidat me të cilat përballlet arsimit

Në zbatim të kuadrit rregullator dhe për të adresuar sfidat me të cilat përballlet arsimit Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka ndërmarrë një sërë masash të cilat kanë një qasje të gjerë dhe të strukturuar. Fillimisht, FGJH ka përforcuar politikat dhe rregulloret për të siguruar standarde të larta edukative, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të materialeve didaktike. Gjithashtu, janë ndërmarrë nisma për të trajnuar dhe mbështetur stafin akademik dhe mësuesit e gjuhëve të huaja nëpërmjet programeve të vazhdueshme të zhvillimit profesional. Për të adresuar sfidat e teknologjisë dhe aksesit në mësimdhënie online, FGJH ka investuar në infrastrukturë digjitale duke mundësuar kështu ngritjen e platforma të aksesueshme për të gjithë studentët. Në këtë mënyrë është krijuar një mjedis mësimor dhe kërkimor më i qëndrueshëm, i cili i përgjigjet nevojave të ndryshme të studentëve dhe sfidave të vazhdueshme të arsimit bashkëkohor duke ofruar një standard të lartë akademik dhe mbështet zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit akademik.

Për të siguruar sa më sipër në nivel fakulteti janë hartuar dhe miratuar një kuadër i plotë rregullator që përfshin strategji dhe rregullore të ndryshme si:

- Strategjia e Kërkimit Shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja 2022-2024
- Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie / Nxënie
- Strategjia e Ndërkombëtarizimit për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës
- Rregullore e brendshme e FGJH- së
- Rregullore Diplomimi e Programeve Studimore të Ciklit I - Bachelor
- Rregulloren për organizimin e programit të ciklit të tretë (doktoratës) në FGJH
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm të doktoraturave
- Rregullore e Konferencave Shkencore në FGJH

Po kështu, për të mbështetur këto masa, çdo departament brenda fakultetit ka hartuar strategjinë dhe rregulloret e veta specifike, përfshirë këtu rregulloret për programet e studimit Bachelor dhe Master. Në këtë mënyrë çdo departament funksionon në përputhje me politikat e përgjithshme të fakultetit dhe i përgjigjet nevojave të veçanta të fushës përkatëse të studimit.

Përveç këtyre strategjive dhe rregulloreve, gjatë viteve 2019-2023, FGJH ka nënshkruar 35 marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore në nivel qendror dhe vendor, si edhe me shoqata, kompani, qendra dhe agjenci udhëtimi, për të mbështetur procesin e mësimdhënies. Gjithashtu, janë nënshkruar dhe 18 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të huaja në fushën e kërkimit shkencor. Marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-institucional synojnë bashkëpunimin midis palëve në drejtim të shkëmbimit të përvojave dhe realizimin e projekteve kërkimore dhe aktiviteteve shkencore të përbashkëta si seminare, leksione, konferenca, etj. Ato kanë si qëllim forcimin e lidhjeve

ndërkombëtare e rajonale në fushën e kërkimit shkencor, përcaktimin e një agjende të përbashkët të kërkimit shkencor me atë të BE-së, shfrytëzimin e infrastrukturave të përbashkëta të kërkimit shkencor, forcimin e lidhjeve me strukturat e BE në fushën e kërkimit shkencor, aksesin e hapur në informacionin shkencor në harmoni me Parimet e Zonës Evropiane për Kërkimin Shkencor (ERA Communication Document).

Nga ana tjetër për të siguruar zbatimin me efikasitet të masave të parashikuara nga strategjitë, rregulloret apo marrëveshjet e bashkëpunimit, FGJH ka ngritur nivelin e infrastrukturës teknologjike në ndihmë të mësimit dhe kërkuesve shkencorë me laboratorë bashkëkohorë të Interpretimit dhe Përkthimit, Përkthim dhe Multimedia, Laboratorin e Fonetikës, Laboratorin e Kërkimit Shkencor dhe Integritit të Teknologjive në Mësimdhënie, Laboratorit Kërkimor në Didaktikën e Gjuhëve të Huaja, Përkthim, Letërsi dhe Lingjistikë - DiPLling, Qendrën e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik si edhe Auditorin Multifunksional. Ngritja dhe përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor është dhe një nga indikatorët e objektivave të përcaktuara nga Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit, 2017-2022.

Për një mësimdhënie sa më bashkëkohore janë vënë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve pajisjet teknologjike: si tabela interaktive, tavolina inteligjente, kompjuterë, tableta, monitorë e projektorë duke e lehtësuar e bërë sa më interesant procesin mësimor. Mjediset e Fakultetit, gjithashtu, ofrojnë mundësi të përshtatshme e të barabarta për t'i ardhur në ndihmë personelit që të kryejë detyrat sa më profesionalisht. Shërbimet online të FGJH-së janë lehtësuar përmes mbulimit me Internet në të gjithë infrastrukturën e institucionit.

Investimet në infrastrukturë janë pjesë e masave të parashikuara dhe të zbatuara në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, rikonstruksionit e mirëmbajtjes së laboratorëve e sallave. Fakulteti disponon, gjithsej, 5 salla leksionesh, 33 salla seminaresh, dy biblioteka, 2 laboratorë përkthimi, një laborator për kërkimin shkencor dhe një laborator fonetike. Laboratorët janë të pajisura me aparaturat e duhura dhe krijojnë kushte të përshtatshme për realizimin normal të mësimdhënies dhe arrihen e objektivave formues të programit të studimit.

Laboratorët e përkthimit janë të pajisura më të gjitha mjetet që përdoren për përkthim simultan.

Të gjitha sallat e leksioneve janë të pajisura me projektorë, tavolina inteligjente (me kompjuter të integruar), sistem audio. Për zhvillimin e orëve praktike të gjuhëve të huaja, disa salla janë të pajisura me projektorë. Së fundmi, ka përfunduar dhe puna për ngritjen e laboratorit për gjuhën e shenjave ku do të ofrohet për herë të parë një program studimi Bachelor në Përkthimin e Gjuhës së Shenjave Shqipe për përgatitjen e interpretëve të gjuhëve të shenjave si një nevojë urgjente për t'i ofruar shërbim dhe këtij grupi të marginalizuar.

Investimet në infrastrukturë mes të tjerave janë mbështetur nga projektet në të cilat FGJH ka rezultuar fitues, ku vetëm për vitin 2022 institucioni ka fituar 2 (dy) projekte në Thirrjen për Projekte të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, bazuar në Urdhër të Ministrisë Nr. 360 datë 28.06.2022 "Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023" dhe si rezultat i implementimit të suksesshëm të këtyre projekteve u realizuan 4 (katër) laboratorë të mësimdhënies dhe të kërkimit.

Gjithashtu nëpërmjet fondeve për kërkim dhe ekselencë të Universitetit të Tiranës gjatë vitit 2022 në FGJH u investua në 4 hapësira të dedikuara për kërkimin shkencor dhe procesin e mësimdhënies/mësimorë, për trajnime të vazhduara për mësuesit, përkthyesit, ndërmjetësit kulturor dhe stafin e UT-së dhe ata, që dëshirojnë të përditësojnë dijet e tyre në fushat përkatëse. Risi është edhe investimi në një Qendër Multifunksionale

të Këshillit Studentor dhe Klubeve studentore të FGJH-së, një mjedis bashkëkohor tërësisht në funksion të veprimtarive akademike dhe socio-kulturore të studentëve, ku mes të cilave është dhe klubi i ICT-së. Studentët dhe koordinatori i tyre kanë ndërtuar strategjinë, në mënyrë që në bashkëpunim me Këshillin Studentor të zhvillohen aktivitete në mbështetje të inovacionit.

Aktualisht FGJH po punon në implementimin e një projekti në partneritet me Universitetin e Zagrebit, Kroaci me titull: “Integrimi i teknologjisë digjitale në metodologjitë e mësimdhënies, të nxëniet dhe sfidat e trajnimit të mësuesve” financuar nga Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF), ku stafi akademik dhe strukturat e lidhura po punojnë për rritjen e kapaciteteve në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënien e gjuhës frënge për mësuesit e arsimit parauniversitar.

Në zbatim të nenit 79 të Ligjit për Arsimin e Lartë, ku përcaktohet se Institucionet e Arsimit të Lartë, që ofrojnë studime të ciklit të tretë (doktoratë), hartojnë projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi për këto studime. Ato aplikojnë për financim pranë AKKSHI-t apo institucioneve të tjera financuese.

Raportet për Veprimtarinë Mësimore dhe Kërkimore për Vitin Akademik 2021-2022, 2022-2023 të përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dëshmojnë një angazhim në rritje të stafit akademik në projektë ndërkombëtare dhe projekte kombëtare. Për më tepër, është vënë re një rritje e ndjeshme e prezantimit të projekteve të reja në nivel fakulteti, kjo për faktin se më 1 Shtator 2021 u bë ngritja e Degës së Projekteve në FGJH. Për vitin 2022-2023, sipas raportimeve të kësaj dege në nivel institucioni janë duke u realizuar 9 projekte të fituara dhe 3 projekte të cilat janë hartuar dhe po zbatohen në nivel departamenti, mes të cilave përfshihet edhe projekti “Didaktika Digjitale e Mësimdhënies/Nxënies dhe Kërkimit Shkencor në UT (DiDiRes)” me financim nga AKKSHI.

Projekte të tjera me financimet e tyre përkatëse janë të renditura më poshtë:

- Hartëzimi i kompetencave kyçe dhe rezultateve të të nxëniet në programet e mësuesisë, me fokus formimin e kompetencave profesionale të studentëve të mësuesisë të Universitetit të Tiranës (UT)
- Përdorimi i metodave inovative në ndihmë të kërkimit shkencor, për personelin akademik dhe studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës (UT)
- Studim dhe analizë mbi koherencën dhe standardet e pritshme të specialistëve gjuhësorë në fushën e turizmit në kontekstin shqiptar (UT)
- Ngritja e Infrastrukturës për Mbështetjen e Krijimit të Programit të Formimit Master në Përkthimin e Gjuhës së Shenjave (AKKSHI)
- “Krijimi i infrastrukturës didaktike-mësimore dhe laboratorike për çeljen e programit të studimit Bachelor në Përkthimin e Gjuhës së Shenjave Shqipe” (Ministria e Arsimit)
- Si ta bëjmë të flasë trashëgiminë tonë kulturore? Kreativiteti dhe ndërmjetësimi në njohjen e trashëgimisë kulturore (AUF)
- Master double degree in natural language processing: aligned with national interests and demands in human capacity development (AADF/READ)
- “Pedagogjia e trajtimit automatik të gjuhëve (PeTAG)” në thirrjen e Universitetit të Tiranës - Kërkim, Ekselencë, Inovacion 2021, FGJH. Si rezultat i këtij projekti është bërë e mundur hapja e një programi të ri për vitin akademik 2022-2023

dhe është fituar e drejta për dhënien e diplomave të dyfishta, me anë të programit të përbashkët Master i Shkencave në “Trajtimi automatik i dokumenteve të shkruara” me Universitetin Paris Nord, Francë. Nëpërmjet këtij programi u bë i mundur anëtarësimi i UT-së në konsorciumin Aleanca e Universiteteve Evropiane, i cili në fund të vitit 2027 pritet të kemi të diplomuarit e parë, përfshirë edhe studentët e FGJH-së.

- “Pedagogjia e trajtimit automatik të gjuhëve (PeTAG)” - programi të ri për vitin akademik 2022-2023 dhe ka fituar të drejtën për dhënien e diplomave të dyfishta, me anë të programit të përbashkët Master i Shkencave në “Trajtimi automatik i dokumenteve të shkruara” me Universitetin Paris Nord, Francë.
- “Integrimi i teknologjisë digjitale në metodologjitë e mësimdhënies/të nxënies dhe sfidat e trajnimit të mësuesve”
- Përmirësimi i kërkimit shkencor me kërkuesit e rinj të Departamentit të Gjuhës Angleze (FGJH)
- Rëndësia e WEB Semantic në ndërtimin e korpuseve dhe në përkthimin e teksteve të specialitetit (FGJH)
- Integrimi i mjeteve digjitale në pedagogjinë e klasës së përmbysur (FGJH)
- Interpretimi/përkthimi në realitetin virtual. Zhvillimi i aplikacioneve të përkthimit online si dhe trajnimi i stafit dhe studentëve me teknologjinë e re (FGJH)
- “Integrimi ndërdisiplinor i kërkimit shkencor në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja- rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore” (FGJH)
- “Krijimi i korpuseve të krahasueshme në fushën e legjislacionit ekonomik dhe juridik” (FGJH)

FGJH vë theksin tek rëndësia e këtyre projekteve infrastrukturore në shërbim të zhvillimit të kapaciteteve të infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit duke mundur realizimin e hulumtimeve dhe punëve kërkimore me standarde të larta, impaktit të drejtpërdrejtë që do të sjellin këto investime teknologjike në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, inovacionit pedagogjik në mësimdhënie, rritjes të kërkuesve shkencorë vendas e të huaj duke realizuar takime, tryeza apo konferenca të përbashkëta.

Më tej, procesi i mësimdhënies në FGJH përshtatet dhe është në përmirësim të vazhdueshëm, jo vetëm për të përmbushur objektivat e vendosura në strategjinë e institucionit, por edhe dhe për ta arritur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Një vëmendje e veçantë i kushtohet në këtë drejtim programeve studimore dhe kurikulave, të cilat rishikohen dhe rifreskohen në bazë të nevojave të tregut.

Në mësimdhënie/nxënie elementi i digjitalizimit gjen zbatim tek Programet e studimit të ciklit të dytë: “Master i Shkencave” në “Mësuesi e gjuhës së huaj për arsimin e mesëm të lartë - ka të përfshirë lëndën “TIK në mësimin e gjuhës së huaj” e cila vjen edhe si përgjigje ndaj komenteve të pasqyruara në Draft Strategjinë për Arsimin ku thuhet se “Programet arsimore për mësuesit nuk mbulojnë mjaftueshëm tema të rëndësishme, si: ... përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor; mes një sërë tematikash të vlerësuara si të nevojshme, janë përfshirë dhe aktivitete për ofrimin e *trajnimit për mësuesit e TIK-ut; përdorimi i platformave të mësimin online*“. (Draft Strategjia për Arsimin, 2021-2026: fq.41) Programet arsimore për mësuesit nuk mbulojnë mjaftueshëm tema të rëndësishme, si: gjithëpërfshirja e nxënësve, përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor dhe puna me fëmijët me nevoja të veçanta dhe ata nga grupe vulnerabël (Draft Strategjia për Arsimin

2021-2026: fq.41)

Rrjedhimisht, FGJH ka organizuar module trajnimi dhe shpërndarje të materialeve online në rrjetet profesionale të mësuesve, të cilat kanë qenë në qendër të punës së ASCAL. Mes një sërë tematikash të vlerësuara si të nevojshme, janë përfshirë dhe aktivitete për ofrimin e *trajnitimit për mësuesit e TIK-ut; përdorimi i platformave të mësimin online*. Kjo thekson edhe njëherë rëndësinë që i kushtohet aftësisë digjitale dhe trajnimit të mësuesve për përdorimin e platformave që kanë si qëllim përdorimin e përmbajtjeve digjitale në kuadër të kurrikulës bazuar në kompetenca, për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie - nxënies.

Përdorimi i metodologjive efektive mësimore, që inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve, diskutimet e thella dhe zhvillimi i aftësive kritike dhe analitike, janë elementët përbërës të një metodologjie mësimore bashkëkohore dhe në nivelin e institucioneve evropiane më të zhvilluara. Një rëndësi të veçantë merr ndërlidhja dhe integrimi i veprimtarisë kërkimore në mësimdhënie me qëllim që studentët të përfshihen në projekte dhe hulumtime me rëndësi praktike dhe shkencore. Më 12 Maj 2022 u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare Studentore me temë “*Të Nxënit në Shekullin XXI - Problematikat dhe Perspektivat*” ku studentët morën pjesë me kërkimet dhe kumtesat e tyre duke mbajtur një konferencë të vërtetë kërkimore shkencore. Aktivitete të tilla janë mundësi shumë të mira për të promovuar kulturën e kërkimit shkencor dhe për të inkurajuar studentët që të zhvillojnë aftësitë e tyre kërkimore dhe analitike si dhe zhvillojnë gjithashtu kompetencat e tyre në aspektin e shumëgjuhësisë dhe kulturalitetit.

Përfundime

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGJH) ka bërë përparime të rëndësishme në përputhje me Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022-2026, duke kontribuar në zhvillimin e një kulture digjitale të të mësuarit dhe kërkimit shkencor. Nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës teknologjike dhe trajnimit të stafit akademik, fakulteti synon të përmbush objektivat kryesore të këtij dokumenti, por jo vetëm.

Menaxhimi dhe përmirësimi i mësimdhënies, si dhe promovimi i të mësuarit nëpërmjet platformave të mësimdhënies sinkronike dhe asinkronike, riaftësimi i stafit mësimor me kompetenca digjitale, dhe zhvillimi i shkencave humane të digitalizuara janë pjesë thelbësore e strategjisë së fakultetit. Kjo përfshin ofrimin e platformave të sigurta dhe të lehta për t'u aksesuar, krijimin e hapësirave inovative të të mësuarit, dhe angazhimin e studentëve në procese të përbashkëta të të mësuarit.

Në aspektin e kërkimit shkencor, Fakulteti synon të përshpejtojë rezultatet e kërkimit dhe të zgjerojë impaktin e tyre duke lehtësuar shpërndarjen e kërkimeve akademike, si dhe duke nxitur kërkimin shkencor bashkëpunues. Përfitimi i granteve nëpërmjet projekteve dhe zhvillimi i kuadrit rregullator mbeten prioritetet për të mbështetur kërkimin shkencor dhe mësimdhënien bashkëkohore. Për të arritur këtë FGJH angazhohet paprerë në trajnimin e stafit akademik për përdorimin efektiv të teknologjisë në mësimdhënie dhe për promovimin e një kulture digjitale të të mësuarit në të gjitha programet dhe ciklet e studimit.

Në përfundim, FGJH synon të vazhdojë përmirësimin e kapaciteteve të saj institucionale dhe teknologjike për të mbështetur një mësimdhënie dhe kërkim shkencor më të përparuar dhe për të përmbushur nevojat e ndryshme të studentëve dhe stafit akademik, duke e bërë institucionin më tërheqës dhe konkurrues në vend.

Rekomandime

Për të vazhduar përparimin dhe arritjet e suksesshme, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGJH) duhet të përqendrohet në zhvillimin e një edukimi digjital dhe të vazhdojë të transformojë procesin e mësimdhënies dhe të edukimit. Kjo përfshin krijimin e një kulture digjitale të të mësuarit, zhvillimin e aftësive digjitale në të gjithë nivelet, dhe pajisjen e stafit mësimor me aftësi të reja për përdorimin e teknologjive inovative në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Detyrat dhe objektivat kryesore

- Zhvillimi i njeve dhe platformave të arsimit sinkronik dhe asinkronik: Përmirësimi i teknologjisë për të mundësuar mësimdhënien digjitale (e-learning).
- Ndërgjegjësimi dhe fuqizimi i pedagogëve me kompetenca digjitale: Trajnimi i vazhdueshëm i stafit akademik për të përfshirë në mënyrë efektive teknologjinë në praktikën e tyre të mësimdhënies.
- Zhvillimi i shkencave humane të digjitalizuara dhe përdorimi i inteligjencës artificiale (AI): Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve rreth përdorimit të IA dhe teknologjive të tjera moderne.
- Zhvillimi dhe përditësimi i infrastrukturës: Përmirësimi i kapaciteteve fizike institucionale dhe rregullatorëve për lehtësimin e mësimit hibrid dhe online për nivelet Bachelor/Master dhe kurset e zhvillimit profesional.

Kërkimi shkencor

- Fuqizimi i grupeve kërkimore: sigurimi i aksesit në baza të dhënash në *cloud* të mbështetura në politikat dhe sigurinë e universiteteve.
- Kërkimi shkencor bashkëpunues: Lehtësimi i shpërndarjes së kërkimeve shkencore ndërmjet institucioneve për të zgjeruar impaktin dhe për të rritur shikueshmërinë e institucionit me qëllim thithjen e granteve.
- Përfitimi i granteve të mëtejshme: Aplikimi për grante të kërkimit shkencor për të mbështetur punën kërkimore dhe zhvillimin e aftësive digjitale.
- Përmirësimi i referimeve dhe botimeve: Rritja e numrit të referimeve dhe botimeve në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

Mësimi Digjital (e-learning)

- Përvojat e studentëve: nxitja e studentëve që të krijojnë, ndajnë dhe bashkëpunojnë duke përdorur mjete dhe metoda inovative.
- Transformimi i mësimdhënies: Ofrimi i kurrikulave të personalizuara bazuar në aftësitë dhe interesat e studentëve.
- Promovimi i mësimit hibrid dhe online: Zgjerimi i mësimit hibrid dhe online për nivelet Bachelor dhe kurset e zhvillimit profesional.

BIBLIOGRAFIA

Draft Strategjia për Arsimin 2021-2026

<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>

European Commission, Directorate-General for Education, Youth, Sport and Culture, (2019). Key competences for lifelong learning, Publications Office. <https://data.europa.eu/doi/10.2766/569540>
ERA Communication Document: Assessment of Progress in achieving ERA, Annex 7, ERA Intervention Logic MS/AC

https://euraxess.ec.europa.eu/sites/default/files/policy_library/era-communication_en.pdf

Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Përmbledhje-e-legjislacionit-për-arsimin-e-lartë-perditesuar-deri-me-11.01.2023-Pdf-2.pdf>

Draft Pakti për Universitetin

<https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2019/01/PAKTI-PËR-UNIVERSITETIN.pdf>

VKM nr. 434, datë 3.6.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=5136&token=bb17dd458df4936e6587679fd86684c2a6b779c7>

Strategjia e Kërkimit Shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja 2022-2024, miratuar me Vendim Dekanatit nr. 135 datë 20.12.2022

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI I) dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030 (SKZHI II)

https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf

Strategjia e ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, miratuar me Vendimin e Dekanatit Nr. 150 datë 21.12.2021

Strategjia e Teknologjise dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie, miratuar me Vendimin e Dekanatit Nr. 43 datë 19.07.2023

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (SZHAPU) <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/STRATEGJIA-2014-2020.pdf>

Strategjia e zhvillimi te Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (2021-2024) miratuar me vendimin e Dekanatit Nr. 150 datë 21.12.2021.

Rregullore e brendshme e FGJH miratuar me Vendimin e Dekanatit Nr. 150 datë 21.12.2021
Rregullore Diplomimi e Programeve Studimore të Ciklit I - Bachelor miratuar me Vendimin e Dekanatit Nr. 32 datë 18.03.2022

Rregulloren për organizimin e programit të studimit të doktoratës në FGJH miratuar më 08.07.2022

Rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përhershëm të doktoraturave miratuar me Vendimin e Dekanatit nr. 135, datë 20.12.2022

Rregullore e Konferencave Shkencore në FGJH miratuar me Vendimin e Dekanatit nr. 33, datë 07.06.2023

Raporti për Veprimtarinë Mësimore dhe Kërkimore për Vitin Akademik 2021-2022, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Raporti për Veprimtarinë Mësimore dhe Kërkimore për Vitin Akademik 2022-2023, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Strategjia dhe politikat e marketingut të Fakultetit të gjuhëve të Huaja (dhjetor 2021)

Statuti i Universitetit të Tiranës

Rregullore e Universitetit të Tiranës, miratuar me Vendimin Nr. 20, datë 27.07.2022 të Senatit Akademik

Urdhër i Ministrit Nr. 360 datë 28.06.2022 “Për shpalljen e thirrjes për financimin e IAL-ve publike, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023”

Vendim Nr. 370, datë 1.6.2022 Për Miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale “Agjenda Digjitale E

Shqipërisë” dhe të Planit të Veprimit 2022-2026 <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/vendim-2022-06-01-370-Agjenda-Digjitale-e-Shqiperise-22-26-dhe-plani-i-veprimit.pdf>

Vendim Nr. 710, datë 1.12.2017 PER MIRATIMIN e Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit, 2017-2022 https://arsimi.gov.al/wpcontent/uploads/2019/07/Vendim-i-KM_710_01.12.2017_Strategjia-e-Kerkimit-Shkencor.pdf

Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022 https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/Vendim-i-KM_710_01.12.2017_Strategjia-e-Kerkimit-Shkencor.pdf

Vendimit nr. 75, datë 12.2.2018 për “Miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” https://akfal.gov.al/media/filer_public/20/8f/208f0bbd-a375-47b2-a990-f880d13474ac/vendim-2018-02-12-75.pdf

Vendim Nr. 88, datë 14.2.2018 Për “krijimin e qendrës ndërinstitucionale të rrjetit akademik Shqiptar (RASH)” https://www.rash.al/media/filer_public/93/ab/93ab6c81-dcb7-456b-abe1-9e7bc186e256/vkm_nr_88_date_1422018_-_krijimi_rash.pdf

APLIKACIONE QË PËRDOREN NGA STUDIUESIT E RINJ PËR KËRKIM SHKENCOR

Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti Stroka

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail:ogerta.koruti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Teknologjia luan një rol të rëndësishëm në aftësitë e studentëve dhe profesorëve për të kryer kërkime, në mjedisin akademik që zhvillohet me ritme të shpejta. Është përgjegjësia e tyre të kryejnë studime të thelluara në mënyrë që të zgjerojnë njohuritë në lëndët e tyre. Zhvillimet e fundit të teknologjisë kanë ndryshuar plotësisht mjedisin e kërkimit dhe u kanë ofruar studiuesve mundësi të padëgjua më parë për të përmirësuar aftësitë e tyre kërkimore. Ata mund të menaxhojnë në mënyrë efikase kompleksitetin e kërkimit me ndihmën e teknologjisë, e cila u ofron burime thelbësore si platformat e bashkëpunimit dhe mjetet e avancuara të analizës së të dhënave. Ky artikull shqyrton përparësitë e shumta të përfshirjes së teknologjisë në metodat e kërkimit dhe përshkruan disa platforma dhe mjete që mund të përdoren për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e kërkimit. Studiuesit mund të lehtësojnë inovacionin dhe përsosmërinë akademike duke thjeshtuar mbledhjen, analizën, bashkëpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave duke përdorur plotësisht inovacionet teknologjike.

Fjalët çelës: Kërkim shkencor, aplikacione Google Scholar, ResearchGate, COBISS+ JSTOR Ulibrar, Corpus Presenter, AntConc, Wordsmith Tools, LancsBox, Sketch Engine

ABSTRACT

In the fast-paced academic environment of today, technology is crucial for students' and professors' abilities to conduct research. It is their responsibility to carry out in-depth study in order to broaden their knowledge in their subjects. Recent technology developments have completely changed the research environment and provided researchers with previously unheard-of chances to improve their research skills. They can efficiently manage the complexity of research with the help of technology, which offers them essential resources such as collaboration platforms and advanced data analysis tools. This article examines the many advantages of incorporating technology into research methods and outlines several platforms and tools that may be used to improve the effectiveness and efficiency of research. Researchers can facilitate innovation and academic excellence by simplifying data gathering, analysis, cooperation, and dissemination through making full use of technology innovations.

Keywords: Scientific research, applications, Google Scholar, ResearchGate, COBISS+ JSTOR Ulibrar, Corpus Presenter, AntConc, Wordsmith Tools, LancsBox, Sketch Engine

Hyrje

Ritmi i zhvillimit teknologjik shkakton ndryshim të vazhdueshëm të praktikave kërkimore dhe shpesh e riorienton vetë kërkimin. Shtimit i njohurive të nanoteknologjisë për studiuesit ofron mundësi krejt të reja për përdorimin e teknologjisë për të nxitur imagjinatën dhe talentin e tyre për projekte kërkimore. Në ditët e sotme, kërkuesit mund të shijojnë teknologjitë më të mira që ofrojnë shumë, nga kërkimi të analiza dhe bashkëpunimi, si dhe publikimi.

Cilësia e kërkimit të tyre përcaktohet kryesisht nga aftësia për t'u përballur me kompleksitetin e procesit të kërkimit, dhe kjo pavarësisht nga lloji i kërkimit që ata po kryejnë, nëse është një studim empirik, një rishikim i literaturës apo një kërkim teorik. Nocioni thelbësor i efikasitetit është ai që i siguron avantazhin teknologjisë. Teknologjia është një mjet i rëndësishëm që u mundëson studiuesve të përdorin informacionin dhe të dhënat e tyre kërkimore në një mënyrë të shpejtë, të saktë dhe të besueshme.


Teknologjia jo vetëm që lehtëson rrjetëzimin dhe bashkëpunimin (në mënyrë që studentët në distancë të mund të mbajnë lidhje me studiuesit, tutorët, ekspertët dhe shokët), por gjithashtu promovon aftësinë e tyre për të mbajtur kontakte me kolegët dhe studentët e tjerë në distancë. Spt promovohen të gjitha shërbimet e rrjeteve sociale, njediset e kërkimit virtual dhe platformat bashkëpunuese në internet që mundësojnë diskutimin multidisiplinar, shkëmbimin intelektual dhe një kulturë kërkimore dhe inovative të përpjekjeve bashkëpunuese. Studentët në nivelin master mund të zgjerojnë njohuritë e tyre duke studiuar në komunitete të hapura akademike që tejkalojnë institucionet e arsimit të lartë. Ata mund të bashkëpunojnë në iniciativat kërkimore; angazhohen në marrëdhënie profesionale nëpërmjet kanaleve digjitale siç janë mediat sociale dhe faqet e internetit të rrjeteve; zhvillojnë partneritete me individë me të njëjtin mendim përmes punëve në grup.

Në dritën e këtyre konsideratave, ky artikull synon të hetojë përparësitë e përdorimit të zhvillimeve të teknologjisë për kërkime, me theks në fuqizimin e studiuesve të rinj. Ne do të shqyrtojmë në detaje platformat, mjetet dhe qasjet e ndryshme, duke ofruar një përmbledhje se si studiuesit e rinj mund të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të bashkëpunuar me të tjerët, për të menaxhuar çdo aspekt të procesit të kërkimit dhe për të vepruar si ekip. Megjithatë, studiuesit e rinj do të jenë në gjendje të përfitojnë nga metodat e drejtuara nga teknologjia për kërkime ose udhëzime në mënyrë që të maksimizojnë avantazhet e inovacionit, zhvillimit të njohurive, zgjidhjes së problemeve sociale duke ndikuar në fushat në të cilat ata kryejnë studimet.

Aplikacione për kërkime online

Le të shikojmë disa shembuj të detajuar për aplikacione që ndihmojnë studiuesit e rinj për kërkimin online:

Google Scholar:



Google Scholar¹ është një motor kërkimi i specializuar për të lexuar/shkarkuar artikuj shkencorë, raporte teknike, libra dhe artikuj gazetash akademike. Krijuar nga Google, ky motor kërkimi ofron burime shkencore nga shumë fusha akademike për të cilat kërkuesit e rinj shfaqin interes. Disa nga karakteristikat kryesore të Google Scholar janë:

Kërkimi i burimeve shkencore: Google Scholar ofron një mjet kërkimi të specializuar për të gjetur artikuj shkencorë, studime, libra dhe dokumente të tjera të lidhura me fushat shkencore që lexuesit shfaqin interes.


Përdorimi i kërkimit të avancuar: Përveç kërkimit bazik, Google Scholar ofron edhe opsione për kërkim të avancuar, duke lejuar përdoruesit të përdorin filtra dhe kritere të ndryshme për të kufizuar rezultatet sipas kërkesave që ata kanë, p.sh., duke kërkuar me emrin e autorit, vitin e botimit apo titullin e artikullit.

Njoftimet dhe citimet: Përdoruesit mund të njoftohen kur publikohen artikuj të rinj në fushat e tyre të interesit si dhe të shohin citimet e tyre.

Harta e citimeve: Google Scholar ofron një mjet të quajtur “Harta e citimeve”, që lejon përdoruesit të shohin lidhjet e burimeve të cituara dhe të identifikojnë studimet dhe artikujt që kanë ndikuar punën e tyre.

Integrimi me universitetet dhe bibliotekat: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, UT, ka ofruar trajnime të vazhdueshme për përdorimin e Google Scholar dhe në të gjitha laboratorët e tij studentë dhe stafi akademik mund të logojë lehtësisht dhe të kryejë kërkime sipas fushave të tyre të interesit. Vlen për t’u përmendur se përdoruesit mund të krijojnë profilin e tyre duke qenë përdorues të Gmail, të ruajnë artikuj dhe të ndjekin autorët apo fusha specifike që ata janë të interesuar. Artikujt apo çdo lloj materiali mund të shkarkohet si PDF ose ju mundësohet lidhja me burimin origjinal të tij.

ResearchGate:



¹ <https://scholar.google.com>

ResearchGate² është një platformë online e dedikuar hulumtimit shkencor dhe bashkëpunimit akademik, e cila ofrohet falas. Kjo platformë ofron një mjedis ku kërkuesit shkencor, studentët, dhe profesionistët e shumtë të fushave të ndryshme shkencore mund të ndajnë dhe të eksplorojnë rezultatet e tyre të hulumtimit, të lidhen me kolegë, dhe të krijojnë rrjete të reja bashkëpunimi. Disa nga karakteristikat kryesore të ResearchGate janë:

Publikimi dhe shpërndarja e artikujve shkencorë:

Kërkuesit shkencorë mund të publikojnë dhe të ndajnë artikujt e tyre shkencorë në platformën e ResearchGate. Kjo lejon përdoruesit të ndajnë punën e tyre me komunitetin shkencor të ResearchGate dhe të jenë në kontakt me kolegët e tyre për të diskutuar rezultatet e kërkimeve të tyre.

Profili i përdoruesit:

Çdo përdorues ka një profil personal në ResearchGate, ku mund të përshkruajë shkurtimisht interesat e tij shkencore, të listojë punën dhe artikujt e tij të publikuar, dhe të lidhet me kolegët në fushën e tij të studimit.

Qendra e pyetjeve dhe diskutimeve:

Platforma ofron një qendër pyetjesh dhe diskutimesh, ku përdoruesit mund të shprehin pyetje, të diskutojnë për temat e rëndësishme të hulumtimit dhe të marrin përgjigje nga kolegët dhe ekspertët në fushën e tyre.

Ndjekja e autorëve dhe artikujve:

Përdoruesit mund të ndjekin autorët dhe artikujt për të cilët kanë interes. Kështu, ata kanë mundësi të jenë të informuar për artikujt më të rinj dhe për publikimet e reja në fushat e tyre të interesit.

Statistikat dhe mjete analize:

Platforma ofron statistika dhe mjete analize për të ndihmuar përdoruesit të monitorojnë impaktin dhe efikasitetin e punës së tyre, duke përfshirë numrin e shikimeve, shkarkimeve, dhe referimeve për artikujt e tyre.

Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi profesional:

ResearchGate lejon përdoruesit të lidhen dhe të bashkëpunojnë me kolegët e tyre në fushat e tyre të interesit, duke u lejuar të krijojnë rrjete të reja profesionale dhe të gjejnë mundësi bashkëpunimi për projektet e tyre të hulumtimit. Pra, është një mundësi e mirë bashkëpunimi me kolegë nga e gjithë bota.

Aksesimi i literaturës bashkëkohore

Teknologjia ka pasur një ndikim të thellë në aksesimin e literaturës bashkëkohore për studentët, përfshirë edhe ata në nivelin e doktoraturës. Disa shembuj të detajuar të këtij ndikimi përfshijnë:

² <https://www.researchgate.net>

Motorët e kërkimit dhe bazat e të dhënave shkencore:

Google Scholar: Siç është përmendur më herët, ky motor kërkimi specializohet në artikujt shkencorë dhe literaturën akademike. Nëpërmjet tij, studentët mund të gjejnë dhe të qasen në një gamë të gjerë materialeve të botuara nga burime të ndryshme akademike.

PubMed, Scopus, Web of Science, etj.: Këto bazë të dhënash ofrojnë qasje në literaturën shkencore, duke përfshirë artikuj, raporte, dhe studime të tjera, të cilat janë të rëndësishme për studentët doktorant për të zhvilluar dhe mbështetur punën e tyre kërkimore.

Platformat për menaxhimin e literaturës:

Mendeley, Zotero, EndNote, etj.: Këto aplikacione dhe platforma ofrojnë mjete për të organizuar, shënuar, dhe referuar materiale akademike. Përmes tyre, studentët mund të mbajnë biblioteka të tyre personale të artikujve dhe të qasen në to nga kudo, duke e bërë procesin e studimit më të lehtë dhe më të organizuar.

Librat dhe materiale audio-vizuale online:

Librat Elektronik: Platformat si Kindle, Google Books, dhe librat elektronikë nëpërmjet bibliotekave universitare ofrojnë akses të shpejtë dhe të lehtë në një gamë të gjerë librash akademikë dhe tekste në çdo fushë të dijes.

Rrjetet Sociale dhe komunitetet akademike online:

ResearchGate, Academia.edu, etj.: Këto platforma ofrojnë një mjedis virtual për studentët për të ndarë punën e tyre, me qëllim që të komunikojnë me kolegët dhe ekspertët në fushën e tyre dhe të jenë të informuar për zhvillimet më të fundit në fushën e tyre të studimit.

Shërbimet e bibliotekave universitare online:

Qasja në burimet e bibliotekës: universitetet ofrojnë mundësi të ndryshme për studentët dhe stafin akademik për gjetjen e literaturës bashkëkohore si revista shkencore, libra të zhanreve të ndryshme edhe online pa patur nevojë të jenë fizikisht në ndërtesat e institucionit.

Bibliotekat virtuale

Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me RASH, AADF apo me partnerë të tjerë, i jep mundësi studentëve dhe stafit akademik të tij të kenë mundësi të kërkojnë libra në biblioteka virtuale.

Studentët e FGJH-së kanë mundësi të aksesojnë këto biblioteka virtuale:

Biblioteka digjitale FGJH

Biblioteka digjitale ofron një gamë të larmishme librash, ku përfshihen të gjitha fushat e studimeve të tre cikleve të studimit që ofrohen në FGJH.

Për të aksesuar këtë bibliotekë klikoni në <https://biblioteka.fgjh.edu.al/> dhe më pas hapni një llogari që ju mundëson dhe shkarkimin e librave.

Ulibrary:

Për të aksesuar këte shërbim, duhet të aksesoni linkun : <https://ulibrary.rash.al/>

Faqja kryesore e shërbimit përmban krahas një videoje informuese, dhe hapat kryesore që duhet të ndiqni.

Për më shumë informacion sesi hapet një llogari apo si shkarkohet një libër mund të klikoni në <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/11/Manual-përdorimi-ulibrary.pdf>

Biblioteka digjitale JSTOR

Biblioteka digjitale JSTOR ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina. Kjo bibliotekë digjitale u krijua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të konvertojnë punimet e shtypura në format digjital, të cilat do të ruhen për brezat e ardhshëm.

Falë marrëveshjes së finalizuar, biblioteka digjitale JSTOR do t'i japë mundësi stafit akademik dhe studentëve të hulumtojnë në shumë fusha studimore si ajo e biznesit, teknologjisë, ekologjisë, botanikës, shkencave natyrore dhe atyre sociale, drejtësisë, historisë, trashëgimisë kulturore, gjuhëve të huaja etj.

Për më shumë informacion klikoni në adresën: <https://www.jstor.org/>

Për të hyrë në JSTOR nga jashtë rrjetit të UT duhet të :

Instaloni Mozilla Firefox

Hapni me Mozilla Firefox adresën

<https://unitiredu.sharepoint.com/sites/BibliotekaOnline>

Hyni në llogarinë tuaj Office 365 të krijuar nga UT

Klikoni linkun e JSTOR <https://www.jstor.org/>

COBISS++

COBISS+ u mundëson bibliotekave dhe përdoruesve qasje online në këto baza të të dhënave:

bazën e përbashkët bibliografike të të dhënave/katalogun COBIB - katalogu i përbashkët i bibliotekave

bazat lokale të të dhënave - katalogët e bibliotekave në sistemin COBISS

bazat e tjera të të dhënave në sistemin COBISS - bazat e specializuara të të dhënave, të cilat janë pjesë e sistemit COBISS

burimet e tjera të informacionit - bazat e specializuara të huaja dhe vendore

COBISS+ është krijuar për të gjithë përdoruesit: kërkuesit shkencorë, nxënësit, stu-

dentët, prindërit, profesorët, pensionistët. Për të gjithë ata, që kërkojnë informacione dhe materiale (edhe ato elektronike), të cilat janë në dispozicion në bibliotekat e Shqipërisë.

Për të aksesuar bibliotekën COOBIS klikoni në: <https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search>

Ndërtimi i korpuseve gjuhësore

Ndërtimi i korpuseve gjuhësore është një proces i rëndësishëm për hulumtimin në fushën e shkencave kompjuterike të gjuhës (NLP) dhe të kërkimit të informacionit. Këto korpuse përdoren për të trajtuar dhe për të zhvilluar modele të inteligjencës artificiale, për të kuptuar më mirë gjuhën njerëzore dhe për të përmirësuar performancën e aplikacioneve të ndryshme gjuhësore. Disa nga aplikacionet që përdoren për ndërtimin e korpuseve gjuhësore janë:

Parallel Corpora Collection Tools:

Corpora Tools është një grup mjeteve dhe softuerësh që përdoren për të ndërtuar, menaxhuar, dhe analizuar korpuset gjuhësore. Këto mjete ofrojnë një gamë të gjerë të funksioneve për të trajtuar dhe për të shqyrtuar të dhënat gjuhësore në mënyra të ndryshme. Disa shembuj janë:

AntConc³:

AntConc është një softuer që ofrohet falas për analizën e korpuseve gjuhësore. I mundëson përdoruesit të kryejnë analiza të thella të tekstit duke përdorur mjetet për frekuencën e fjalëve, hapësira frekuence, kolokacionet, dhe shumë të tjera.

Shembull: Përdorimi i AntConc për të identifikuar kolokacionet e fjalës “computer” në një korpus të dhënë të tekstit.

Corpus Presenter⁴:

Corpus Presenter është një softuer i specializuar për prezantimin e të dhënave të korpuseve gjuhësore. Ai mundëson ndërtimin e grafikëve, tabelave, dhe vizualizimeve të tjera për të paraqitur rezultatet e analizave të korpuseve.

Shembull: Përdorimi i Corpus Presenter për të krijuar një grafik të frekuencës së përdorimit të fjalëve të ndryshme në një korpus të dhënë.

Wordsmith Tools⁵:

Wordsmith Tools janë mjete që përdoren për analizën e tekstit dhe korpuseve. Përfshin mjetet për analizën e frekuencës së fjalëve, për gjetjen e kolokacioneve, për analizën e strukturës së fjalëve, dhe shumë më tepër.

Shembull: Përdorimi i Wordsmith Tools për të identifikuar kolokacionet e fjalës “environment” në një korpus të marrë nga tekstet e letrarë të përzgjedhur.

³ <https://www.laurenceanthony.net/software/antconc/>

⁴ [http://www.raymondhickey.com/index_\(CP\).html](http://www.raymondhickey.com/index_(CP).html)

⁵ <https://www.lexically.net/wordsmith/>

LancsBox⁶:

LancsBox është një tjetër softuer që përdoret për analizën e tekstit dhe korpusit. Përmban mjetet për analizën e frekuencës së fjalëve, për kolokacionet, për analizën morfologjike, dhe shumë më tepër.

Shembull: Përdorimi i LancsBox për të studiuar përdorimin e parafjalëve në një korpus të dhënë tekstesh.

Language Processing Tools:

Sketch Engine⁷ është një platformë e specializuar në analizën e korpusit gjuhësor dhe në ofrimin e mjeteve për studimin dhe analizimin e gjuhës. Kjo platformë jep mundësinë e përdorimit në shumë gjuhë, të cilat mund të përdoren për analiza të thella gjuhësore dhe hulumtime shkencore në fushën e gjuhësisë kompjuterike, linguistikës e në çdo fushë tjetër të interesit të studiuesve. Karakteristikat kryesore të Sketch Engine janë:

Krijimi dhe menaxhimi i korpusit: Përdoruesit mund të krijojnë dhe të menaxhojnë korpuset e tyre gjuhësore nëpërmjet importimit të tekstit nga burime të ndryshme ose përdorimit të korpuseve të gatshme të disponueshme në platformë.

Analiza e shpeshësisë së përdorimit të fjalëve: Platforma ofron mjetet për të analizuar shpeshësinë e përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve në korpus, duke përfshirë ndërtime të ndryshme si lista të fjalëve që përdoren më shpesh apo edhe shprehjeve më të përdorura që mund të jenë në fokus të kërkimeve të ndryshme shkencore.

Analiza e Strukturës së Fjalëve: Përdoruesit mund të kryejnë analiza të strukturës së fjalëve dhe morfologjisë nëpërmjet mjeteve të specializuara të disponueshme në platformë.

Identifikimi i kolokacioneve: Sketch Engine ofron mjetet për të identifikuar dhe për të analizuar kolokacionet, të cilat janë kombinime të rëndësishme të fjalëve që shfaqen në tekste dhe që kanë një kuptim të veçantë.

Studimi i përdorimit të fjalëve dhe stileve të gjuhës: Përmes analizave të thella, përdoruesit mund të studiojnë përdorimin e fjalëve dhe stileve të gjuhës në kontekste të ndryshme, duke përfshirë stile të gjuhës së shkruar dhe asaj të folur.

Këto janë vetëm disa nga aplikacionet që përdoren për ndërtimin e korpuseve gjuhësore për kërkuesit e rinj të gjuhëve të huaja. Përdorimi i tyre mund t'i ndihmojë ata në shkarkimin, organizimin, analizën dhe interpretimin e të dhënave të gjuhës së huaj për qëllime hulumtuese dhe akademike.

Përfundime

Ky artikull synoi të vinte në pah dhe të ilustronte ndikimin e teknologjisë në përgjithësi në skenën kërkimore dhe studiuesit e së nesërme. Ne analizuam disa përfitime që teknologjia u jep kërkuesve shkencorë.

⁶ <https://lancsbox.lancs.ac.uk>

⁷ <https://www.sketchengine.eu>

Teknologjia e çon procesin e kërkimit në një linjë të re përmes zbulimit të mekanizmave të sigurimit të të dhënave alternative, duke u larguar nga fazat e zakonshme të kërkimit.

Megjithatë, teknologjia, nga ana tjetër, mundëson bashkëpunimin dhe ndarjen e ideve, duke i lejuar studiuesit të shkëmbejnë ide me kolegët, mentorët dhe ekspertët, duke thyer kështu barrierat gjeografike. Platformat e bashkëpunimit në internet, softueri për rrjetet sociale dhe mjedisi i kërkimit virtual përmirësojnë ndërveprimet midis fushave të ndryshme të specializimit, si dhe thjeshtojnë shkëmbimin e njohurive dhe ndërtojnë bashkëpunime në kërkime.

Teknologjia mund t'i fuqizojë kërkuesit shkencorë të kontribuojnë ndjeshëm në fushën e tyre të studimit duke i bërë studimet e tyre më të detajuara pasi teknologjia i pasuron dhe përmirëson të dhënat. Të mësuarit e ndërmjetësuar nga teknologjia është çelësi për të krijuar qasje krejt të reja për studimin, të cilat mund të thejnë kufijtë e vjetër të krijimit të njohurive, të modelojnë ide novatore për inovacion dhe të formojnë të ardhmen e kërkimit përmes lidhjes globale dhe teknologjisë digjitale.

SITOGRAFIA

<https://scholar.google.com>

<https://www.researchgate.net>

<https://ulibrary.rash.al/>

<https://biblioteka.fgjh.edu.al/>

<https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/11/Manual-përdorimi-ulibrary.pdf>

<https://www.jstor.org/>

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search>

<https://unitiredu.sharepoint.com/sites/BibliotekaOnline>

<https://www.laurenceanthony.net/software/antconc/>

[http://www.raymondhickey.com/index_\(CP\).html](http://www.raymondhickey.com/index_(CP).html)

<https://www.lexically.net/wordsmith/>

<https://lancsbox.lancs.ac.uk>

<https://www.sketchengine.eu>

ARTIKUJ

STRATEGJITË E NXËNIES SË LEKSIKUT TË GREQISHTES NË SHKOLLAT DYGJUHËSHE SHQIPTARO-GREKE

Prof. As. Dr. Sofia Delijorgji

Departamenti i Gjuhës Greke
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: sofia.delijorgji@unitir.edu.al

MSc Aida Zoto

Departamenti i Gjuhës Greke
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: aida.zoto@unitir.edu.al

Dr. Isida (Metaj) Foçi

Departamenti i Gjuhës Greke
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: isida.metaj@unitir.edu.al

Dr. Edlira Jorgaqi

Departamenti i Gjuhës Greke
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: edlira.jorgaqi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky punim paraqet gjetjet e një projekti kërkimor që ka për qëllim identifikimin dhe analizën e strategjive të përdorura nga nxënësit në arsimin e mesëm të lartë gjatë mësimin të leksikut të gjuhës greke në shkollat dygjuhëshe shqiptaro-greke në Shqipëri. Synimi kryesor është të identifikohen dhe analizohen këto strategji për të përmirësuar procesin e mësimdhënies në mjediset dygjuhëshe. Studimi bazohet në teoritë e strategjive të ndryshme të mësimin të gjuhës (kujtesës, kognitive, metakognitive, të përcaktimit dhe ato sociale) të cilat janë esenciale për mësimin efektiv të një gjuhe të re. Këto korniza ofrojnë një kuptim gjithëpërfshirës të mekanizmave që përdorin studentët për të përvetësuar fjalorin në një kontekst dygjuhësh.

Studimi ndjek një qasje me metoda të përziera. Në fazën e parë, u identifikuan dhe kategorizuan

50 studentë me prejardhje të ndryshme, duke përfshirë minoritetin grek në Shqipëri dhe familjet shqiptare dygjuhëshe dhe njëgjuhëshe, të ndarë në nivelet fillestar, të mesëm dhe të përparuar në gjuhën greke. Janë zhvilluar dy pyetësorë: një për të vlerësuar nivelet e gjuhës dhe një tjetër për të identifikuar strategjitë e të mësuarit të fjalorit.

Rezultatet sugjerojnë përdorimin e strategjive të ndryshme midis studentëve, të ndikuar nga aftësia e tyre gjuhësore dhe prejardhja familjare. Këto gjetje janë brenda kornizës teorike, duke theksuar qasjet kryesore për përvetësimin e fjalorit.

Artikulli ofron një kontribut të rëndësishëm në fushën e mësimin të gjuhës greke në kontekstin shqiptaro-grek dhe shërben si platformë për hulumtuesit dhe praktikantët që janë të angazhuar me zhvillimin dhe hartimin e metodave efektive për mësimin e gjuhës greke.

Fjalë kyç: Strategji të nxënies së leksikut, shkolla dygjuhëshe shqiptaro-greke, gjuhë e dytë

ABSTRACT

This paper presents the findings of a research project that aims to identify and analyze the strategies used by students in higher secondary education during the learning of the Greek language lexicon in Albanian-Greek bilingual schools in Albania. The main aim is to identify and analyze these strategies to improve the teaching process in bilingual environments.

The study is based on theories of different language learning strategies (memory, cognitive, metacognitive, definition and social) which are essential for effective learning of a new language. These frameworks provide a comprehensive understanding of the mechanisms students use to acquire vocabulary in a bilingual context.

The study follows a mixed methods approach. In the first phase, 50 students from different backgrounds were identified and categorized, including the Greek minority in Albania and bilingual and monolingual Albanian families, divided into beginner, intermediate and advanced levels in the Greek language. Two questionnaires were developed: one to assess language levels and another to identify vocabulary learning strategies.

The results suggest the use of different strategies among students, influenced by their language ability and family background. These findings are within the theoretical framework, highlighting key approaches for vocabulary acquisition.

The article provides an important contribution to the field of Greek language learning in the Albanian-Greek context and serves as a platform for researchers and practitioners who are engaged in the development and design of effective methods for Greek language learning.

Keywords: vocabulary learning strategies, Albanian-Greek bilingual school, second language

KORNIZA TEORIKE

Mësimi i një gjuhë të dytë ose të huaj është padyshim një nga çështjet më sfiduese me të cilën do të përballen shumica e njerëzve gjatë gjithë jetës së tyre. Sfidat që vijnë me zotërimin e një gjuhe të re shtrihen nga përparësitë e zhvillimit personal dhe profesional deri te një ndjenjë e identitetit të përshtatshëm dhe të integruar¹. Në një botë gjithnjë e më globale, ku komunikimi ndërkulturor dhe ndërgjuhësor është jetik, aftësia për të mësuar dhe përmbushur nevojat komunikuese në gjuhë të huaja është e nevojshme². Shumë argumentojnë se të mësuarit dhe të përvetësuarit të fjalorit të një GJ2/GJH është ndoshta aspekti më sfidues për t'u aftësuar në gjuhën e synuar³. Leksiku është një thes i pashtershëm njohurish që mundëson kuptimin e teksteve dhe ndërtimin e komunikimit në një gjuhë të huaj. Ndërveprimi i përditshëm dhe praktika e përsëritjes ndihmojnë në përmirësimin gradual të aftësive gjuhësore. Mësimi i leksikut në një gjuhë të dytë është themelor për të përdorur gjuhën dhe për të kuptuar e shprehur mendime dhe ide⁴. Ndërsa gramatika dhe sintaksa ofrojnë strukturën themelore të një gjuhe, fjalori mundëson shprehjen e ndjeshme të nuancave dhe detajeve të një mesazhi⁵. Nëpërmjet fjalorit, nxënësit fitojnë aftësinë për të komunikuar më ndjeshëm dhe për të shprehur ndjesitë e tyre me një spektër të gjerë emocional dhe kulturor. Në thelb, mësimi i një gjuhe të dytë ose të huaj është një udhëtim kognitiv dhe emocional i ndryshëm për secilin individ. Ndikimi i mësimin të fjalorit, ndërveprimi ndërkulturor dhe zhvillimi i aftësive komunikuese janë pjesë integrale e këtij procesi të pasur dhe të ndikueshëm⁶. Duke përshtatur ndërthurjen e këtyre elementeve, nxënësit përgatiten për të komunikuar me siguri dhe kompetencë në një mjedis gjithnjë e më shumë të diversifikuar dhe ndërkulturor⁷.

Zotërimi i fjalorit të ri luan një rol të rëndësishëm në procesin e përvetësimit të gjuhës pasi fjalori është shtylla kryesore e një gjuhe, dhe pa një zotërim të përshtatshëm të fjalëve, është e vështirë të komunikohet me sukses⁸. Ky aspekt është i veçantërisht i rëndësishëm

¹ Ellis, R. (2003). *Task-based Language Learning and Teaching*. Oxford: Oxford University Press.

² Σκούρτου, Ε. (2002). *Διγλωσσία και Διδασκαλία Δεύτερης Γλώσσας*. Πάτρα: Ελληνικό Ανοικτό Πανεπιστήμιο, Υλικά για τη θεματική Ενότητα: Διαπολιτισμική Εκπαίδευσης, Τόμος Ι.

³ Nation, I.S.P. (2001). *Learning vocabulary in another language*. Cambridge: Cambridge University Press

⁴ Schmitt, N. and McCarthy, M. (eds) (1997). *Vocabulary: Description, Acquisition and Pedagogy*. Cambridge: Cambridge University Press

⁵ Ματθαίουδάκη, Μ., Κίτσου Ι., & Τζιμώκας, Δ. (2011). Η χρήση της ρηματικής όψης στη νέα ελληνική ως δεύτερη/ξένη γλώσσα: πορίσματα εμπειρικής έρευνας από τις εξετάσεις πιστοποίησης ελληνομάθειας. Στο *Μελέτες για την ελληνική γλώσσα 30* (σσ. 317-328). Θεσσαλονίκη: Ινστιτούτο Νεοελληνικών Σπουδών. Ίδρυμα Μανόλη Τριανταφυλλίδη.

⁶ Ζάγκα, Ε. (2005). *Μάθηση και Διδασκαλία μιας Δεύτερης Γλώσσας: Από τα μοντέλα διδασκαλίας της γλώσσας «με βάση το περιεχόμενο» σε προσεγγίσεις με «έμφαση στο περιεχόμενο» με χρήση στρατηγικών*. *Επιστήμες Αγωγής*, Θεματικό τεύχος, 69-77. Πανεπιστήμιο Κρήτης: ΠΤΔΕ.

⁷ Σπυριδούλα Βαρλοκόστα, Λήδα Τριανταφυλλίδου. 2005. Η ελληνική ως δεύτερη γλώσσα: Καθορισμός επιπέδων γλωσσομάθειας του προφορικού λόγου αλλοδαπών μαθητών. Εθνικό και Καποδιστριακό Πανεπιστήμιο Αθηνών (ΕΚΠΑ). <https://www.openbook.gr/i-elliniki-ws-deyteri-glwssa-kathorismos-epipedwn-glwssomatheias-tou-proforikou-logou-allodapwn-mathitwn>

⁸ Richards, Jack & Schmidt, Richard. (2013). *Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*. 10.4324/9781315833835.

për personat që janë duke mësuar gjuhën në një kontekst të ndërthurur dygjuhësh siç është rasti i kombinimit të gjuhëve shqip-greqisht. Për individët, në këtë kontekst, fjalori është më shumë se thjesht një mjet për të shprehur mendimet; është një tregues i identitetit të tyre të ndërthurur dhe të pasuruar nga dy kultura dhe gjuhë⁹. Mësimi i fjalorit në këtë rast është një sfidë e ndjeshme që përmban jo vetëm zotërimin e fjalëve të reja, por edhe ndërtimin e një mjete të fuqishëm të komunikimit që reflekton përvojën dhe identitetin e tyre.

METODOLOGJIA

Projekti

Projekti, i financuar nga buxheti për kërkim shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, synon të hulumtojë dhe përmirësojë strategjitë e nxënies së leksikut të gjuhës greke në arsimin e mesëm të lartë në shkollat dygjuhëshe shqiptaro-greke¹⁰. Kjo përpjekje synon të kontribuojë në zhvillimin e praktikave mësimore duke identifikuar dhe analizuar teknikat dhe strategjitë e përdorura nga vetë nxënësit gjatë përvetësimit të fjalorit të gjuhës greke.

Synimi kryesor i projektit është identifikimi, analiza, vlerësimi dhe krahasimi i strategjive të përdorura nga nxënësit gjatë përvetësimit të fjalorit leksikut të gjuhës greke. Kërkimi përfshin metodologjinë dhe analizën e strategjive të përdorura nga nxënësit për të vlerësuar efektivitetin e këtyre strategjive në përvetësimin e fjalorit grek.

Rezultatet e arritura do të ofrojnë një panoramë të plotë mbi strategjitë e përdorura nga nxënësit në përvetësimin e fjalorit të gjuhës greke dhe do të jenë bazë për rekomandime konkrete për përmirësimin e procesit mësimor në shkollat dygjuhëshe shqiptaro-greke. Produkti kryesor i projektit do të jetë një Manual/Udhëzues, që do të shërbejë si mjet udhëzues e bashkëpunues për përmirësimin e aftësive të arsimitarëve dhe përmirësimin e praktikave mësimore në mësimdhënien e gjuhës greke në shkollat dygjuhëshe.

Studimi

Studimi synon të identifikojë marrëdhënien midis llojeve të strategjive të përdorura nga nxënësit e nivelit fillestar, mesatar dhe të përparuar të gjuhës greke për të përvetësuar fjalorin grek, dhe kohës së shpenzuar nga ata për të përvetësuar këtë fjalor. Pyetjet kërkimore do të ndihmojnë në identifikimin e strategjive (në varësi të niveleve gjuhësore). Këto rezultate do të kontribuojnë në njohjen e nevojave të veçanta të këtyre grupmoshave, duke ofruar një kontribut të rëndësishëm në hartimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e procesit mësimor në shkollat dygjuhëshe shqiptaro-greke.

⁹ Χατζηδάκη, Α. (2005). Μοντέλα Διγλωσσικής συμπεριφοράς σε οικογένειες αλβανών μαθητών: Δεδομένα από εμπειρική έρευνα. *Επιστήμες Αγωγής*, Θεματικό τεύχος, 79-102. Πανεπιστήμιο Κρήτης: ΠΤΔΕ.

¹⁰ STRATEGJITË E NXËNIES SË LEKSIKUT TË GREQISHTES NË SHKOLLAT DYGJUHËSHE SHQIPTARO-GREKE <https://fgjh.edu.al/grupi-mesimor-kerkimor-gjuhesi-perkthim-i-gjuhes-greke/>

Identifikimi dhe ndërveprimi me institucionin arsimor

Identifikimi dhe ndërveprimi me institucionin arsimor ka qenë një fazë kritike në realizimin e këtij projekti. *SHKOLLA PROTAGONISTËT*, pjesë e *FONDACIONIT FRYMË DASHURIE*, vendi i këtij hulumtimi është përzgjedhur me kujdes për shkak të disa faktorëve që e bëjnë atë një subjekt të rëndësishëm për studimin e strategjive të nxënies së leksikut të gjuhës greke në arsimin e mesëm të lartë në shkollat dygjuhëshe shqiptaro-greke¹¹. Para se të nisim projektin, u zhvillua një fazë identifikimi, ku u njohëm me shkollën dygjuhëshe në zonën e interesuar dhe vlerësua potencialin e saj për të kontribuar në hulumtimin tonë. Ndërveprimi me Drejtorin e shkollës ishte kritik për të siguruar mbështetjen e tij dhe lejen për të zhvilluar studimin në ambientet e shkollës. Gjatë këtij procesi, u prezantua qëllimi i projektit, metodologjia e përdorur, dhe përfitimet që do të kishte institucioni nga pjesëmarrja në këtë hulumtim. Zgjedhja e kësaj shkolle ka qenë e bazuar edhe në faktin se ajo përfaqëson një model të shkëlqyer të shkollave dygjuhëshe shqiptaro-greke dhe ka një ekuilibër të mirë mes nxënësve të komunitetit grek dhe shqiptar. Përveç kësaj, shkolla ka shfaqur një ndjeshmëri të lartë ndaj nevojave të nxënësve të tyre në mësimin e gjuhës greke, duke e bërë kështu të përshtatshme për këtë hulumtim.

Nxënësit pjesëmarrës në studim

Për identifikimin e nxënësve pjesëmarrës në studim, u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme një grup prej 50 nxënësish nga kjo shkollë dygjuhëshe shqiptaro-greke në Tiranë. Ky grup përfshiu 5 paralele me nga 10 nxënës secila. Për të siguruar një përfaqësim të përshtatshëm, nxënësit do të ishin pjesë e kategorive të ndryshme, duke përfshirë nxënës të minoritetit grek në Shqipëri, ata nga familjet shqiptare dygjuhëshe, dhe ata që janë pjesë e familjeve njëgjuhëshe, por e kanë mësuar gjuhën greke përmes mësimave në këtë shkollë. Për të ndarë grupet, fillimisht u përdor kriteri i përcaktimit të nivelit gjuhësor, duke bërë dallimin midis nxënësve fillestarë, të mesëm dhe të përparuar në gjuhën greke. Ky proces i përzgjedhjes dhe identifikimit të nxënësve siguroi një përfaqësim të gjerë dhe objektiv për hulumtimin tonë.

Instrumentet e përdorura

Pyetësorët janë hartuar me kujdes dhe profesionalizëm, duke marrë parasysh modelet të certifikimit të Qendrës së Gjuhës Greke dhe Pyetësorin e Schmitts (1997). Modelet e përdorura për secilin pyetësor janë përshtatur në përputhje me qëllimin specifik të studimit, duke siguruar saktësi dhe standarde të larta në vlerësimin e njohjes së gjuhës greke dhe strategjive të të mësuarit të fjalorit nga pjesëmarrësit.

¹¹ Shkolla Protagonistët <https://www.protagonistschool.org/>

- a) Për hartimin e pyetësorit *PYETËSOR MBI MADHËSINË E FJALORIT*, janë marrë në konsideratë materialet e Qendrës së Gjuhës Greke¹², institucion zyrtar i autorizuar nga Ministria e Arsimit, Kërkimit dhe Çështjeve Fetare në Greqi për të kryer provimet për certifikimin e gjuhës greke. Për siguri dhe saktësi kemi përdorur një test diagnostik të përshtatur sipas niveleve të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët¹³ për nivelet gjuhësore (A1, A2, B1, B2, C1, C2) të kësaj Qendre, duke përfshirë veçanërisht pjesën e pyetjeve që lidhet drejtpërsëdrejti me leksikon dhe duke i përshtatur pyetjet sipas qëllimit specifik të studimit tonë. Ky proces ka siguruar që pyetësorët tanë të përmbushin standardet e kërkuara dhe të jenë në përputhje me nivelet e përcaktuara nga Qendra e Gjuhës Greke për vlerësimin e njohjes së gjuhës greke nga kandidatët në nivelin e tyre të fjalorit.
- b) Hartimi i pyetësorit *PYETËSORI I STRATEGJIVE TË TË MËSUARIT TË FJALORIT*, është realizuar duke u bazuar në Pyetësorin e Schmitts (1997)¹⁴, i cili është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe. Ky pyetësor është ndarë në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë, janë përfshirë pyetje që synojnë të identifikojnë disa informacione demografike të pjesëmarrësve, përfshirë gjininë, moshën, dhe klasën, ndërsa, pjesa e dytë e pyetësorit përmban 39 pyetje të ndara në pesë kategori të ndryshme: 1) strategji të kujtesës (memory strategies), 2) strategji kognitive (cognitive strategies), 3) strategji metakognitive (metacognitive strategies), 4) strategji të përcaktimit (determination strategies), dhe 5) strategji sociale (social strategies). Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të shprehin shkallën

¹² Το Κέντρο Ελληνικής Γλώσσας. Πιστοποίηση Ελληνομάθειας <https://www.greek-language.gr/certification/>

¹³ Përshkrimi i niveleve A1, A2, B1, B2, C1, C2 sipas shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (Common European Framework of Reference for Languages) - MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË - INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT. UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR GJUHËN E HUAJ. IZHA 2018 <http://www.izha.edu.al/>

¹⁴ Pyetësori i Schmitts (1997) - Schmitt, N. & McCarthy, M. (1998). Vocabulary: Description, Acquisition and Pedagogy (Cambridge Language Teaching Library) 1st Edition. New York: Cambridge University Press. ISBN-10 – 0521585511 fq. 207, është përkthyer dhe përshtatur në shqip. Pyetësori përmban 39 pyetje të cilat janë të klasifikuara në pesë kategori: 1) strategji të kujtesës (memory strategies), 2) strategji kognitive (cognitive strategies), 3) strategji metakognitive (metacognitive strategies), 4) strategji të përcaktimit (determination strategies) dhe 5) strategji sociale (social strategies). 1) Strategjitë e kujtesës: realizohen përmes fotografive/imazheve; fjalët e reja mund të lidhen me fjalë që nxënësi njih p.sh., sinonime; përmes grupimit të fjalëve të reja; përmes formave ortografike ose fonologjike e fjalës. 2) Strategjitë kognitive: realizohen përmes përsëritjes dhe përdorimit të mjeteve mekanike për të studiuar fjalorin, si dhe përmes përsëritjes me shkrim dhe me gojë, duke shkruar ose thënë vazhdimisht fjalën e re. 3) Strategjitë metakognitive: përdoren nga nxënësit për të kontrolluar dhe vlerësuar se sa ata kanë ariut të mësojnë, duke pasur një pasqyrë të përgjithshme të procesit mësimor. 4) Strategjitë e përcaktimit: nëse nxënësit nuk dinë një fjalë, ata duhet të zbulojnë kuptimin e saj duke hamendësuar nga njohuritë e tyre strukturore të gjuhës, duke hamendësuar nga Gjuha 1 përkatëse, duke hamendësuar nga konteksti, duke përdorur materiale referimi ose duke pyetur dikë tjetër. 5) Strategjitë sociale: një mënyrë për të zbuluar kuptimin e fjalës së re është duke pyetur dikë që e njih gjuhën. 2. Shpesh mund t'u kërkohej mësuesve të japin ndihmë në mënyra të ndryshme: duke dhënë përkthim në Gjuhën 1, duke dhënë një sinonim, duke dhënë një përkufizim ose parafrazim ose duke përdorur fjalën në një fjali.

e dakordësisë së tyre për secilën pohim nëpërmjet shkallës së vlerësimit Likert, duke filluar nga 0 (kurrë), 1 (ndonjëherë), 2 (shpesh), 3 (zakonisht) dhe 4 (gjithmonë). Kjo metodologji e vlerësimit do të mundësojë një analizë të hollësishme të përzgjedhjes së përdorimit të strategjive të të mësuarit të fjalorit nga pjesëmarrësit, duke ndihmuar në identifikimin e modeleve dhe preferencave të tyre në përdorimin e këtyre strategjive.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Interpretimi i rezultateve

- ✓ Sipas rezultateve të *PYETËSORIT MBI MADHËSINË E FJALORIT*, nxënësit pjesëmarrës shfaqën ndryshime në nivelin e njohurisë së gjuhës greke bazuar në moshë dhe gjini. Konkretisht: përfaqësimi i niveleve gjuhësore në bazë të përqindjes së përgjigjeve pozitive është: në nivelin A1, përqindja e përgjigjeve pozitive është 88%, në nivelin A2, kjo përqindje bie në 76%, në nivelin B1, vetëm 52% e përgjigjeve janë pozitive, ndërsa në nivelin B2, kjo përqindje bie në 20%, në nivelin C1, vetëm 1% e përgjigjeve janë pozitive, ndërsa në nivelin C2, nuk ka asnjë përgjigje pozitive.
- ✓ Sipas rezultateve të *PYETËSORIT TË STRATEGJIVE TË TË MËSUARIT TË FJALORIT*, në pjesën e parë, mbi disa informacione demografike të pjesëmarrësve (gjinia, mosha, klasa), kemi këto të dhëna: femrat përfaqësojnë 66% (33) të totalit të pjesëmarrësve, ndërsa meshkujt përfaqësojnë 34% (17); mosha mbizotëruese është 17 vjeç, ndërsa klasa me pjesëmarrje më të madhe është klasa XI (52%).

Në pjesën e dytë të pyetësorit, analiza e përqindjeve të përgjigjeve në secilën prej strategjive dhe renditja e pyetjeve nga më e preferuara tek më pak e preferuara është një informacion i rëndësishëm për mësuesit dhe kurrikulat mësimore për të përshtatur më mirë mësimin sipas nevojave dhe nevojave të nxënësve për të arritur një mësim më efektiv dhe të suksesshëm. Konkretisht, duke i renditur pyetjet nga ajo që ka marrë më shumë përgjigje të nivelit 4 (gjithmonë) e deri tek ajo që ka më pak përgjigje të nivelit 0 (kurrë), kemi këto rezultate:

- ✓ në *strategjitë e përcaktimit*, Pyetja 8 (Kontrollo për kuptimin e fjalës së re në fund të tekstit (tek lista e fjalëve të reja) merr 16 përgjigje (32%), ndërsa Pyetja 7 (Përdor një fjalor njëgjuhësh (greqisht - greqisht)) ka marrë 3 përgjigje (6%).
- ✓ në *strategjitë sociale*, Pyetja 9 (Pyet mësuesin/mësuesen se si përkthehet fjala e re në gjuhën shqipe) merr 41 përgjigje (82%), ndërsa Pyetja 12 (Pyet shokët/shoqet e klasës për kuptimin e fjalës) ka marrë 15 përgjigje (30%).
- ✓ në *strategjitë e kujtesës*, Pyetja 14 (Imagjino kuptimin e fjalës përmes imazheve) 31 përgjigje (62%), ndërsa Pyetja 27 (Mëso fjalën e re nëpërmjet veprimit fizik (lëvizjeve)) ka 10 përgjigje (20%).
- ✓ në *strategjitë kognitive*, Pyetja 28 (Përsërit shpesh fjalën e re me gojë) shfaq 35 përgjigje (76%), ndërsa Pyetja 34 (3 përgjigje (7%).

- ✓ në *strategjitë metakognitive*, Pyetjet 36 (Përdor medien në gjuhën greke (këngë, filma, lajme, etj.)) dhe 39 (Vazhdon të studiosh fjalën me kalimin e kohës) shfaqin një numër të njëjtë përgjigjesh, pra, 12 përgjigje (24%), ndërsa Pyetja 37 (Testo veten përmes testeve të fjalorit (teste fizike ose online) ka 5 përgjigje (10%).

Bazuar në analizën e pyetësorit të strategjive të të mësuarit të fjalorit, duket se nxënësit parapëlqejnë strategjitë sociale dhe të kujtesës. Strategjitë sociale, si pyetja për t'iu drejtuar mësuesit për përkthimin e fjalës së re në gjuhën shqipe, kanë marrë një përqindje të lartë të përgjigjeve pozitive, 82%. Në anën tjetër, strategjitë e përcaktimit dhe disa nga strategjitë kognitive shfaqin një preferencë më të ulët. Për shembull, përdorimi i fjalorit njëgjuhësh është përzgjedhur rrallë, me vetëm 6% të përgjigjeve pozitive. Kjo mund të shpjegohet nga fakti që strategjitë sociale dhe të kujtesës mund të ofrojnë një ndjesi më të afërt dhe më bashkëpunuese, ndërsa strategjitë e përcaktimit mund të paraqiten si më pak efektive apo më të vështira për t'u përdorur në praktikë.

Tabela 1

Tabela përshkruan strategji të ndryshme që përdorin nxënësit kur ndeshen me fjalorin e ri të greqishtes, të kategorizuara sipas shpeshësisë së përdorimit: 4 (gjithmonë), 3 (zakonisht), 2 (shpesh), 1 (nganjëherë) dhe 0 (kurrë). Strategjitë ndahen në lloje të ndryshme, si strategjitë e përcaktimit (SP), strategjitë sociale (SS), strategjitë e kujtesës (SKu), strategjitë kognitive (SKo) dhe strategjitë metakognitive (SM). Për shembull, strategjia “Pyet mësuesin se si përkthehet në shqip fjala e re” (SS 9) përdoret gjithmonë nga 41 nxënës, ndërsa “Përdor një fjalor njëgjuhësh” (SP 7) nuk përdoret kurrë nga 32 nxënës. Këto të dhëna janë tregues për metodat e preferuara në mësimin e fjalorit nga nxënësit në mjedise dygjuhëshe.

Lloji i strategjisë	Strategjite e të mësuarit fjalorit të gjuhës	Shpeshësia				
		4 (gjithmonë)	3 (zakonisht)	2 (shpesh)	1 (ndonjëherë)	0 (kurrë)
SP	1. Identifikon se cilës pjesë së ligjëratës i takon (etiketim i pjesëve të ligjëratës)	5	14	8	9	14
SP	2. Identifikon ndajshtesat (parashtesat ose prapashtesat) apo rrënjën e saj	9	3	15	7	16
SP	3. Kontrollon nëse ka një fjalë me kuptim të njëjtë ose të përafërt me të në gjuhën shqipe	13	15	10	5	7
SP	4. Kërkon nëse mund ta identifikosh fjalën e re përmes një imazhi	8	15	10	10	7
SP	5. Nxjerr kuptimin e fjalës së re nga konteksti (d.m.th., nga një fjalë apo një grup fjalësh apo një tekst)	12	14	10	8	6
SP	6. Përdor një fjalor dygjuhësh (greqisht - shqip)	10	10	8	7	15

SP	7.	Përdor një fjalor njëgjuhësh (greqisht - greqisht)	3	5	7	3	32
SP	8.	Kontrollon për kuptimin e fjalës së re në fund të tekstit (tek lista e fjalëve të reja)	16	12	5	6	11
SS	9.	Pyet mësuesin/mësuesen se si përkethehet fjala e re në gjuhën shqipe	41	2	1	0	1
SS	10.	Pyet mësuesin/mësuesen për perifrrazimin, sinonimin ose antonimin e fjalës së re	28	15	11	4	2
SS	11.	Kërkon nga mësuesi/mësuesja të thotë një fjali duke përdorur fjalën e re	35	4	8	6	3
SS	12.	Pyet shokët/shoqet e klasës për kuptimin e fjalës	15	4	13	11	7
SS	13.	Mundohesh të ndërveprosh me folës amtarë të gjuhës	18	8	5	15	14
SKu	14.	Imagjinon kuptimin e fjalës përmes imazheve	31	8	3	4	4
SKu	15.	Lidh fjalën e re me një eksperiencë personale	16	6	10	10	8
SKu	16.	Lidh fjalën e re me sinonimet ose me antonimet e saj	16	4	13	10	7
SKu	17.	Grupon fjalët e reja së bashku për t'i studiuar ato	24	6	11	6	3
SKu	18.	Krijon fjali me fjalët e reja	28	12	7	1	2
SKu	19.	Grupon fjalët e reja së bashku dhe krijon një histori	16	6	10	6	12
SKu	20.	Gërmëzon fjalën e re	25	7	7	5	6
SKu	21.	Studion tingullin e fjalës së re	20	5	10	8	7
SKu	22.	Thua fjalën e re me zë të lartë kur e mëson atë	22	4	7	8	9
SKu	23.	Kujton ndajshesat (parashtesat ose prapashtesat) dhe rrënjën e fjalës së re	16	6	9	9	10
SKu	24.	Kujton pjesën e ligjëratës ku bën pjesa fjala e re (etiketim i pjesëve të ligjëratës)	11	6	12	6	15
SKu	25.	Perifrazon kuptimin e fjalës	24	5	8	8	5
SKu	26.	Mëson fjalën e re përmes idiomave apo proverbave	16	7	10	6	11
SKu	27.	Mëson fjalën e re nëpërmjet veprimit fizik (lëvizjeve)	10	5	11	13	11
SKo	28.	Përsërit shpesh fjalën e re me gojë	35	4	3	5	3
SKo	29.	Përsërit shpesh fjalën e re me shkrim	19	11	7	7	6
SKo	30.	Krijon një listë të fjalëve të reja	22	5	10	9	4
SKo	31.	Mban shënime në klasë për fjalët e reja	23	4	6	5	8

SKo	32. Përdor seksionin e fjalorit në librin tuaj shkollor (nëse ka)	4	3	9	12	22
SKo	33. Dëgjon fjalët e reja në audio (p.sh., dëgjon mësimin e ri në audio)	5	7	7	9	22
SKo	34. Vendos etiketa në gjuhën greke në objektet fizike	3	1	10	11	24
SKo	35. Mban një fletore fjalori	21	5	8	5	11
SM	36. Përdor medie në gjuhën greke (këngë, filma, lajme, etj.)	12	8	14	11	5
SM	37. Teston veten përmes testeve të fjalorit (teste fizike ose on-line)	5	5	11	14	15
SM	38. Anashkalon fjalën e re kur nuk e kupton atë	7	8	10	11	14
SM	39. Vazhdon të studiosh fjalën me kalimin e kohës	12	10	11	9	8

PËRFUNDIME

Sugjerime dhe Rekomandime

Për të përmirësuar procesin e mësimin të fjalëve të reja në gjuhën greke, rekomandohen më shumë ndërveprim në klasë. Të organizosh aktivitete ndërveprimi dhe aktivitete në grup ku nxënësit mund të pyesin dhe ndihmojnë njëri-tjetrin ose mësuesin për fjalët e reja, për shembull, lojëra fjalori, shprehje, fjalëformimi, memorizimi, përcaktimi, e vërtetë e gabuar, hamendësimi dhe drejtshkrimi. Këto aktivitete mund të jenë të dobishme ku nxënësit konkurrojnë ose bashkëpunojnë në çifte ose grupe të vogla për të diskutuar dhe pyetur njëri-tjetrin për fjalët e reja që kanë mësuar.

Përdorimi i teknikave vizuale dhe veprimeve fizike rekomandohet për të ndihmuar në memorizimin e fjalorit të ri. Për shembull, përdorni kartolina me figura për çdo fjalë të re, duke treguar një fotografi të një «καρέκλα» (karrige) krahas fjalës për t'i ndihmuar nxënësit të lidhin vizualisht fjalën me kuptimin e saj.

Mediat greke si këngët, filmat dhe lajmet duhet të përdoren si pjesë e kurrikulës për të ofruar kontekst dhe përdorim praktik të fjalorit. Nxënësit mund të ndahen në grupe për të parë një film grek ose për të dëgjuar një këngë greke dhe më pas të diskutojnë për fjalorin e ri që kanë hasur, duke siguruar kështu kontekst dhe përdorim praktik të fjalëve.

Zbatoni teste periodike të fjalorit, si fizike ashtu edhe online, për t'i ndihmuar nxënësit të vetëvlerësohen dhe të përforcojnë të mësuarit e tyre me kalimin e kohës. Për shembull, kryeni teste/kuize javore, me shkrim dhe me gojë, mbi fjalorin e mësuar së fundmi ose planifikoni një test/kuiz online duke përdorur platforma si Quizlet ose Kahoot.

Inkurajoni nxënësit të përdorin fjalorë dygjuhësh, greqisht-shqip-greqisht, për të kuptuar fjalët e reja në kontekstin e gjuhës amtare. Sillni disa fjalorë greqisht-shqip në klasë dhe përfshini ushtrime që kërkojnë nga nxënësit të kërkojnë dhe të përkthejnë fjalë të reja. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë fjalorin e ri brenda kontekstit të gjuhës amtare ose caktoni ushtrime që kërkojnë nga nxënësit të gjejnë dhe të shkruajnë kuptimet e fjalëve të

reja si në greqisht ashtu edhe në shqip.

Mësoni fjalët e reja në kontekst dhe jo të veçura duke përdorur fjali, tregime dhe shembuj praktikë. Krijoni fjali ose tregime të shkurtra duke përdorur fjalor të ri, p.sh., përdorni fjalën “σπίτι” (shtëpi) në fjali të ndryshme “Το σπίτι μου είναι μεγάλο” (Shtëpia ime është e madhe) për të treguar se si përdoren fjalët në situata të jetës reale. Gjithashtu, nxënësit të tregojnë në orën e mësimi duke përdorur fjalë të reja fjalori për të ndërtuar dhe ndarë historitë e tyre.

Përshtatni metodat e mësimdhënies bazuar në strategjitë e parapëlqyera nga grupe të ndryshme nxënësish. Për nxënësit fillestarë, përdorni më shumë aktivitete vizuale dhe fizike si vizatimi ose interpretimi i fjalëve, ndërsa për nxënësit e përparuar, përqendrohuni në aktivitetet e bazuara në diskutime dhe përdorimin më të thellë të kontekstit.

Përfshini mjete ndërvepruese të tilla si aplikacione për mësimin e gjuhës, teste/kuize në internet dhe lojëra edukative. Përdorni aplikacione si Duolingo ose Quizlet që ofrojnë mënyra interaktive dhe tërheqëse për të praktikuar fjalorin dhe vendosni sfida javore për nxënësit që të kryejnë ushtrime specifike të bazuara në aplikacione.

Jepni komente (feedback) të rregullta për përparimin e nxënësve dhe ofroni mbështetje shtesë aty ku është e nevojshme. Programoni takime javore individuale për të diskutuar përparimin e secilit nxënësi, për të adresuar sfidat dhe për të ofruar udhëzime të personalizuar.

Në fund, integroni elemente kulturore të komuniteteve greke dhe shqiptare në procesin mësimor për të siguruar kohezion. Festoni festat greke dhe shqiptare në klasë dhe kërkoni nxënësve të hulumtojnë dhe të prezantojnë mbi traditat kulturore duke përdorur fjalorin përkatës që kanë mësuar. Kjo i ndihmon ata të shohin përdorimin praktik të aftësive të tyre dygjuhëshe në jetën e përditshme dhe organizoni ditë shkëmbimi kulturor ku nxënësit mund të paraqesin zakonet, festat dhe traditat greke dhe shqiptare duke përdorur fjalorin e ri që kanë përvetësuar.

BIBLIOGRAFIA

- Common European Framework of Reference for Languages) - **MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË - INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT. UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR GJUHËN E HUAJ. IZHA 2018** <http://www.izha.edu.al/>
- Ellis, R. (2003). *Task-based Language Learning and Teaching*. Oxford: Oxford University Press.
- Ha, L. T. K., Le, T. V., Phan, L. T., Nguyen, L. T. B., & Dam, A. T. V. (2024). Perspectives of Vietnamese Students and Teachers Regarding the Preservation of Languages of Ethnic Minorities. *Revista De Gestão Social E Ambiental*, 18(9), e5862. <https://doi.org/10.24857/rgsa.v18n9-026>
- Richards, Jack & Schmidt, Richard. (2013). *Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*. 10.4324/9781315833835.
- Schmitt, N. & McCarthy, M. (1998). *Vocabulary: Description, Acquisition and Pedagogy* (Cambridge Language Teaching Library) 1st Edition. New York: Cambridge University Press. ISBN-10 - 0521585511
- Schmitt, N. and McCarthy, M. (eds) (1997). *Vocabulary: Description, Acquisition and Pedagogy*. Cambridge: Cambridge University Press.
- STRATEGJITË E NXËNIES SË LEKSIKUT TË GREQISHTES NË SHKOLLAT DYGJUHËSHE SHQIPTARO-GREKE** <https://fgjh.edu.al/grupi-mesimor-kerkimor-gjuhesiperkthim-i-gjuhes-greke/>
- Ζάγκα, Ε. (2005). Μάθηση και Διδασκαλία μιας Δεύτερης Γλώσσας: Από τα μοντέλα διδασκαλίας της γλώσσας «με βάση το περιεχόμενο» σε προσεγγίσεις με «έμφαση στο περιεχόμενο» με χρήση στρατηγικών. *Επιστήμες Αγωγής. Θεματικό τεύχος*, 69-77. Πανεπιστήμιο Κρήτης: ΠΤΔΕ.
- Ματθαίουδάκη, Μ., Κίτσου Ι., & Τζιμώκας, Δ. (2011). Η χρήση της ρηματικής όψης στη νέα ελληνική ως δεύτερη/ξένη γλώσσα: πορίσματα εμπειρικής έρευνας από τις εξετάσεις πιστοποίησης ελληνομάθειας. Στο *Μελέτες για την ελληνική γλώσσα 30* (σσ. 317-328). Θεσσαλονίκη: Ινστιτούτο Νεοελληνικών Σπουδών. Ίδρυμα Μανόλη Τριανταφυλλίδη.
- Σκούρτου, Ε. (2002). *Διγλωσσία και Διδασκαλία Δεύτερης Γλώσσας*. Πάτρα: Ελληνικό Ανοικτό Πανεπιστήμιο, Υλικά για τη θεματική Ενότητα: Διαπολιτισμική Εκπαίδευσης, Τόμος Ι. Το Κέντρο Ελληνικής Γλώσσας. Πιστοποίηση Ελληνομάθειας <https://www.greek-language.gr/certification/>
- Χατζηδάκη, Α. (2005). Μοντέλα Διγλωσσικής συμπεριφοράς σε οικογένειες αλβανών μαθητών: Δεδομένα από εμπειρική έρευνα. *Επιστήμες Αγωγής. Θεματικό τεύχος*, 79-102. Πανεπιστήμιο Κρήτης: ΠΤΔΕ.
- Le, S. Q., Le, D. T., Bui, D. T. T., & Tran, B. X. (2024). A Ability to advise and support students in educational activities of primary school teachers. *Journal of Law and Sustainable Development*, 12(1), e2258. <https://doi.org/10.55908/sdgs.v12i1.2258>

NDIKIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË PËRKTHIM

MSc Anna Maria Vasili

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: anna.maria@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Përparimi i shpejtë i inteligjencës artificiale ka transformuar thellësisht industri të ndryshme dhe fusha e përkthimit nuk bën përjashtim. Integrimi i inteligjencës artificiale në fushën e përkthimit është një temë sa ngazëllyese, aq edhe shqetësuese brenda industrisë. Ndërsa teknologjia e përkthimit të inteligjencës artificiale vazhdon të përparojë, diskutimet rreth zëvendësimit të mundshëm të përkthyesve dhe interpretëve janë bërë gjithnjë e më të përhapura në diskutimet akademike. Ky artikull ofron një përmbledhje të gjendjes aktuale të teknologjisë së përkthimit duke analizuar ndihmën që mund të ofrojë dhe kufizimet e saj, si dhe ndikimin e mundshëm që mund të ketë në industrinë e përkthimit, sa i përket dhe perspektivës së karrierës profesionale të njerëzve. Edhe pse përkthimi automatik i mundësuar nga inteligjenca artificiale ka bërë përparime të rëndësishme, artikulli argumenton se nuk ka gjasa që të zëvendësojë plotësisht përkthyesit dhe interpretët në të ardhmen e afërt. Tashmë, industria e përkthimit shihet përballë sfidave dhe mundësive sa i përket integritit të teknologjisë së inteligjencës artificiale, e cila përfundimisht mund të çojë në një marrëdhënie simbiotike midis përkthyesve dhe përkthimit automatik.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale, përkthimi njerëzor, përkthimi automatik, ndihmë, kufizime

ABSTRACT

The rapid advancements of artificial intelligence has profoundly transformed various industries, and the field of translation makes no exception. The integration of artificial intelligence into the field of translation has been a topic of both excitement and concern within the industry. As artificial intelligence translation technology continues to evolve, discussions around the potential replacement of human translators and interpreters have become increasingly prevalent in academic discourse. This paper provides an overview of the current state of speech translation technology, analyzing its merits and limitations, and the potential impact it might have on the translation industry, particularly on the career prospects of humans. While machine translation powered by artificial intelligence has made significant strides, the paper argues that it is unlikely to completely replace human translators and interpreters in the foreseeable future. The translation industry is seen as facing both challenges and opportunities with the integration of artificial intelligence technology, which could ultimately lead to a symbiotic relationship between human and machine translation.

Keywords: artificial intelligence, human translation, machine translation, merits, limitations

Hyrja

Historia¹ e teknologjisë së përkthimit daton disa dekada më parë, me sistemet e hershme që mbështeteshin në qasjet e bazuara në rregulla të kufizuara gjithsesi në aftësinë e tyre për të trajtuar kompleksitetin e gjuhës natyrore. Përparimet² e fundit në përkthimin automatik, të nxitura nga zhvillimi i shpejtë i inteligjencës artificiale, sigurisht që kanë përmirësuar saktësinë dhe efikasitetin e përkthimit të automatizuar. Megjithatë, nëse bëjmë një hulumtim më të afërt të gjendjes aktuale të kësaj teknologjie dhe veçorive unike të profesionit të përkthimit zbulohet, se marrëdhënia midis inteligjencës artificiale dhe përkthimit njerëzor ka shumë më tepër nuanca sesa thjesht dhe vetëm një skenar zëvendësimi. Ideja e punimit është të qartësojë ndikimet aktuale edhe në të ardhmen sa i përket inteligjencës artificiale në përkthim.

Në dy shekujt e fundit, përkthimi ka pësuar ndryshime drastike me zhvillimin e njeveve të komunikimit dhe inteligjencës artificiale. A do t'ia kalojë përkthimi teknologjik përkthimit njerëzor në të ardhmen e afërt? Nëse po, cili do të jetë roli i përkthyesve? A ekziston ai model i inteligjencës artificiale që mund të nxisë të menduarit kritik? A mund ta zëvendësojë vërtet inteligjenca artificiale punën e njeriut? Këto pikëpyetje më nxisin ta shoh këtë temë jo vetëm me interes, por dhe me vëmendje të shtuar për të hulumtuar më tej.

Përkthimi e ka shoqëruar njeriun në etapa të ndryshme teknologjike. Në ditët e sotme, nxitur nga zhvillimet shkencore dhe epoka digjitale, përkthimi po përparon jo vetëm nga aftësitë e profesionistëve, por dhe në një qasje tjetër që lidhet me teknologjinë dhe inteligjencën artificiale.

Për përkthimin automatik³ u fol për herë të parë pothuajse 100 vjet të shkuara, në vitet 1930. Në ato vite dy shkencëtarë, pavarësisht nga njëri-tjetri, hodhën hapat e parë në të ardhmen e automatizimit dhe krijuan pajisje të reja përkthimi:

Krijimi i një fjalori automatik nga Georges Artsruni

Georges Artsruni ishte një gjuhëtar i famshëm, që pati një kontribut shumë të madh në zhvillimin e përkthimit automatik. Pajisja e “fjalorit automatik” që ai krijoi nuk ishte thjesht një fjalor; ishte një bazë e tërë të dhënash me fjalë, fraza, shprehje dhe përkthimet e tyre, të cilat lehtësuan shumë punën e përkthyesve dhe i ndihmuan ata të gjenin më shumë informacion kontekstual për përkthime sa më të sakta.

- Krijimi i një makinerie speciale, një tavolinë e pjerrët me një makinë shkrimi dhe kamera nga Peter Trojansk

¹Chengxiao Xiao (2021) *J. Phys.: Conf. Ser.* 1992 022079

²Fink-Hooijer, F. (2017). Artificial Intelligence – the (un)desired revolution? *Lebende Sprachen*, 62(2), 269-274

³[https://thelanguagedoctors.org/blog/the-evolution-of-translation-technology-trends-and-innovations-shaping-the-industry/#:~:text=The%20digital%20revolution%2C%20which%20includes,assisted%20translation%20\(CAT\)%20tools.](https://thelanguagedoctors.org/blog/the-evolution-of-translation-technology-trends-and-innovations-shaping-the-industry/#:~:text=The%20digital%20revolution%2C%20which%20includes,assisted%20translation%20(CAT)%20tools.)

Ose, siç e ka quajtur ai, “një makinë për zgjedhjen dhe shtypjen e fjalëve kur përkthehet nga një gjuhë në tjetrën”. Shpikja e inxhinierit mori një certifikatë të së drejtës së autorit, por shpejt u harrua për një kohë të gjatë.

Në vitin 1949, Warren Weaver, drejtor i Departamentit të Shkencave Natyrore të Fondacionit Rockefeller, publikoi një memorandum mbi zbatimin e një teknologjie të përkthimit me makinë të bazuar në dekodim. Punimi ishte i profilit të lartë dhe ai gjithashtu prezantoi për herë të parë për publikun konceptin “interlingua”: një fjali e gjuhës burimore thjeshtohet dhe konvertohet në anglisht, e më pas fjalia në anglisht konvertohet në gjuhën e synuar.

Data e lindjes së përkthimit automatik është 7 janar 1954. Në histori, kjo ngjarje quhet Eksperimenti i Georgetown.

Përkthimi i parë automatik u demonstrua në New York; materiali ishte përgatitur nga Leon Doster (profesor i gjuhësisë në Universitetin Georgetown) dhe Cuthbert Hird (drejtues i departamentit krijues). Në këtë eksperiment, ata zgjedhën një tekst me 60 fjali mbi kiminë organike dhe e përkthyen atë nga gjuha ruse në gjuhën angleze. Baza kompjuterike përfshinte 6 rregulla gramatikore dhe një fjalor me 250 fjalë dhe fraza. Cilësia e përkthimit automatik nuk ishte e lartë, por duke përdorur këtë teknologji, produktiviteti i përkthyesve u pesëfishua. Fatkeqësisht, teknologjia ishte shumë e shtrenjtë për përdorim masiv, çka e ngadalësoi zhvillimin e saj për dy dekadat e ardhshme.

Sa mund të na ndihmojë ky përparim teknologjik në fushën e përkthimit?

Një nga përparësitë është shpejtësia. Përkthyesit e kanë praktikisht dhe realisht të pamundur të përkthejnë një material sado i gjatë apo i shkurtër qoftë, në pak sekonda siç ndodh me anë të përkthimit automatik, i cili ndihmohet nga inteligjenca artificiale. Mjetet e përkthimit të ndihmuara nga inteligjenca artificiale mund të përpunojnë dhe përkthejnë shpejt vëllime të mëdha materialesh, duke e reduktuar ndjeshëm kohën e nevojshme që i duhet një përkthyesi për të përkthyer.

Një tjetër përparësi e dukshme është se shërbimet e përkthimit të inteligjencës artificiale janë të disponueshme gjatë gjithë kohës, pra njëzet e katër orë, në shtatë ditë të javës, duke ofruar përkthime të menjëhershme pa pasur nevojë për planifikime apo afate.

Sa i përket anës financiare, kostoja është ndjeshëm më e reduktuar. Mjetet e automatizuara të përkthimit e eliminojnë nevojën për punësimin e përkthyesve, duke e bërë një zgjidhje me kosto efektive si për individët, ashtu dhe për bizneset.

Nëse flasim për qëndrueshmëri, koherencë dhe saktësi drejtshkrimore, inteligjenca artificiale garanton një produkt të standardizuar, veçanërisht tek materialet me terminologji teknike, ku ruajtja e termave unifikues është thelbësor. Modelet e përkthimit të inteligjencës artificiale përparojnë vazhdimisht nga korrektime dhe përditësimet, kështu që përmirësohet gradualisht saktësia e tyre duke reduktuar gabimet njerëzore.

⁴ Interlingua është një gjuhë e ndërtuar duke përdorur fjalë që gjenden në shumicën e gjuhëve të Evropës Perëndimore.

Meqenëse kanë mbështetje të gjerë gjuhësore, mjetet e përkthimit të inteligjencës artificiale nxisin një gamë të gjerë gjuhësh dhe dialektesh, duke lehtësuar komunikimin ndërmjet grupeve të ndryshme gjuhësore. Madje disa aplikacione të inteligjencës artificiale ofrojnë përkthime në kohë reale duke u bërë shumë të dobishme në rastin e bisedave apo takime që ndodhin papritur e pa planifikim.

Inteligjenca artificiale mund të specializohet në fusha të ndryshme specifike, si për shembull në terminologji politike, juridike, ekonomike, historike, sociale, mjekësore, shkencore, teknike, etj, duke rritur dhe përmirësuar aftësinë e saj për të ofruar përkthime të sakta në fushat specifike, si edhe mund t'i përshtatet komenteve e preferencave të përdoruesve për t'i ardhur në ndihmë nevojave individuale të gjithsecilit.

Mjetet e përkthimit të inteligjencës artificiale integrohen me platforma të tjera, si për shembull me aplikacione në celular, duke i ofruar përdoruesve një përvojë të pandërprerë pavarësisht vendndodhjes së tyre, mjafton të kenë internet.

Meqenëse ka disa gjuhë të cilat janë më pak të njohura ose dhe jo aq të përdorura, inteligjenca artificiale ka aftësinë t'i përkthejë dhe t'i dokumentojë, duke kontribuar në ruajtjen dhe studimin e tyre në vazhdim.

Barrierat gjuhësore nuk ekzistojnë në epokën e sotme digjitale. Inteligjenca artificiale mundëson informacionin të aksesueshëm për këdo, duke thyer barrierat ekzistuese dhe duke nxitur komunikimin, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin global.

Në fakt, mjetet e përkthimit të inteligjencës artificiale janë në përmirësim të vazhdueshëm, pasi përftojnë sasi të mëdha të dhënash nga ndërveprimet e përdoruesve. Pra në përgjithësi, inteligjenca artificiale ka revolucionarizuar industrinë e përkthimit duke e bërë atë më të shpejtë e më të përbalueshme. Por, medalja ka gjithmonë dy anë; megjithëse inteligjenca artificiale ka përparuar ndjeshëm në fushën e përkthimit, përsëri ka kufizime dhe sfida me të cilat përballet.

Sa mund të na pengojë apo kufizojë përparimi teknologjik në fushën e përkthimit? Inteligjenca artificiale ka shumë vështirësi të dallojë nuancat kulturore dhe ngjyrimet specifike të kontekstit, të cilat përkthyesit i perceptojnë gati-gati në mënyrë intuitive. Gjithashtu, dhe përkthimi i saktë i shprehjeve idiomatike, të të folurit me gjuhë jo formale ose thënë ndryshe zhargon, është tepër sfidues për përkthimin automatik, pasi shpesh këto kërkojnë kuptim të thellë kulturor dhe kontekstual.

Përkthimi automatik ka tepër vështirësi me strukturat komplekse të fjalive, rrjedhimisht duke prodhuar përkthime të pasakta. Përcaktimi i saktë i kuptimit, tonit, regjistrit, emocionit, janë tepër problematike, nëse lihen për t'u përkthyer nga aplikacionet e inteligjencës artificiale.

Edhe pse më lart përmendëm se inteligjenca artificiale i përmirëson aftësitë e saj për të ofruar përkthime të sakta në fusha të specializuara, ajo nuk mund të ketë thellësinë e të kuptuarit që mund të ofrojë një përkthyes i kualifikuar. Gjithashtu, aftësia e përkthimit automatik nuk është efikas në gjuhë apo dialekte të rralla duke e bërë të pamundur përcimin e mesazhit të duhur në raste të tilla.

Krijimtaria është nga të vetmet karakteristika, që do mbeten autentike për njeriun e mendjen njerëzore. Shkrimet krijuese, përkthimi i letërsisë, poezisë apo forma të tjera ku zgjedhja e fjalëve e stilit janë vendimtare, do të mbeten veçanërisht sfiduese për një

aplikacion sado inteligjent qoftë ai. Përkthyesit mund të përmirësojnë materiale të cilat mund të jenë të paqarta, gjë në të cilën inteligjenca artificiale lë për të dëshiruar, pasi ajo është tepër e ftohtë dhe përkthen çka i ofrohet, pa kuptuar nëse mesazhi që përçon është i saktë apo jo.

Gjuha evoluon vazhdimisht dhe modeleve të inteligjencës artificiale iu nevojiten përditësime të vazhdueshme të cilat pa dyshim janë të mundura vetëm nga mendja njerëzore, pasi cilësia e përkthimeve të inteligjencës artificiale varet shumë nga cilësia dhe diversiteti i të dhënave që zotëron.

Përdorimi i shërbimeve të përkthimit me anë të inteligjencës artificiale përfshin ndarjen e të dhënave me një apo më shumë palë, veprim i cili mund të shtojë shqetësimet lidhur me privatësinë dhe sigurinë e materialeve, sidomos në rastet e informacioneve të ndjeshme dhe konfidenciale, e aq më tepër nëse do të klasifikoheshin sekret apo tepër sekret.

Në përkthim është e rëndësishme t'i përshtatesh porosive të individit që i ofrohet shërbimi i kërkuar. Thënë kjo, përkthimi automatik nuk llogarit preferencat individuale apo dhe zgjedhjet stilistike për një individ të caktuar aq efektivisht siç mund ta bëjë një përkthyes. E kur përkthimi i automatizuar nuk është i kënaqshëm, me inteligjencën artificiale nuk ndërvepron dot për vërejtje apo sugjerime të ndryshme, si ndërveprimi i mirëfilltë, i drejtpërdrejtë njerëzor mes kërkuarit të shërbimit dhe përkthyesit do të ishte i shkëlqyer, pa diskutim, për çdo paqartësi apo keqkuptim.

Gabimet që ndodhin nga përkthimet automatike janë të shumta, deri dhe trashanike, e hera herës edhe me pasoja serioze, duke ngritur në këtë mënyrë një pikëpyetje të madhe lidhur me përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien.

Mendoj se, veç të tjerash, dy nga aftësitë më të rëndësishme që një përkthyes duhet të zotërojë janë edhe inteligjenca emocionale e ajo sociale. Inteligjencës artificiale i mungon aftësia për të kuptuar dhe përcjellë emocionet, të cilat në komunikime të ndryshme, mund të jenë vendimtare. Gjithashtu, në komunikimin ndërpersonal, ndërkohë që përkthyesit mund t'i përshtatin përkthimet e tyre bazuar në dinamika ndërpersonale, inteligjenca artificiale nuk mundet.

E fundit por jo nga rëndësia, përshtatja me pranimin në masë të mjeteve të përkthimit me ndihmën e inteligjencës artificiale mund të çojë në eliminimin e fuqisë punëtore njerëzore, duke gjeneruar në këtë mënyrë problematika socio-ekonomike.

Edhe pse inteligjenca artificiale ka bërë përparime të mëdha në fushën e përkthimit, kufizimet dhe pengesat bashkëshoqëruese e theksojnë rëndësinë e ekspertizës dhe aftësisë njerëzore në sigurimin e përkthimeve cilësore, të sakta dhe të përshtatura në kontekst. Në këto kushte, ajo mund të përdoret si mjet për të ndihmuar përkthyesit, por kurrësi nuk mund të jetë zëvendësuesja e tyre e profesionistëve të përkthimit.

Në vijim të arsytimit mbi kufizimet e pengesat, figura e mëposhtme ilustruese, komike - deri diku dhe sarkastike, synon të tregojë se çfarë cilësie e dobët përkthimi do të përfitojë nëse përdoren programet e përkthimit automatik.

Për anglishtfolësit është shumë e qartë, por për ata që nuk kanë njohuri të gjuhës angleze, shpjegoj, se siç vërehet dhe në figurën në vijim janë dy ushtarë, ku njëri i thotë tjetrit: "Cover me", që në rastin konkret dhe në kontekstin e situatës ku ata ndodhen,

përkthehet “Më mbro”. Por ndërkohë, që në kuptimin e parë gjuhësor “Cover me” do të thotë “Më mbulo”, përkthimi që bën inteligjenca artificiale është pikërisht ky (“Më mbulo”), prandaj në mënyrë humoristike, ilustrohet shoku i tij, i cili merr një batanije dhe e mbulon me të, ndërkohë që ndodhen në mes të një rreziku me armë zjarri luftarake.

Pra, përmes këtij ilustrimi, jo vetëm përforcohet, por dhe theksohet fakti që inteligjenca artificiale ka shumë vështirësi të dallojë nuancat kulturore dhe ngjyrimet specifike të kontekstit, duke përçar në këtë mënyrë përkthime të pakuptimta, deri dhe qesharake.

When you use google translate



Përfundime:

Inteligjenca artificiale ka revolucionarizuar industrinë e përkthimit duke përmirësuar aksesueshmërinë dhe duke ulur kostot. Teksa teknologjitë e inteligjencës artificiale vazhdojnë të ecin përpara me një ritëm jashtëzakonisht të shpejtë, ato kanë potencialin të transformojnë metodat tradicionale, si dhe të ofrojnë risi për mësimin dhe përkthimin e gjuhëve. Ndërsa ka ende shumë sfida për t’u kapërcyer, veçanërisht në lidhje me saktësinë dhe kontekstin kulturor, modeli bashkëpunues i inteligjencës artificiale dhe përkthyesve ofron një rrugë premtuese përpara. Rezultatet e mira në përkthim arrihen shpesh përmes kombinimit të inteligjencës artificiale dhe ekspertizës njerëzore. Përkthyesit mund të përmirësojnë përkthimet e krijuara nga inteligjenca artificiale, duke transmetuar saktësinë dhe rëndësinë kulturore. Kjo qasje bashkëpunuese mund të maksimizojë efikasitetin duke ruajtur standardet e cilësisë së lartë. Pa diskutim që përparimet e ardhshme në fushën e përkthimit me anë të inteligjencës artificiale do të vazhdojnë të jenë tema të

rëndësishme për shqyrtim dhe zhvillim. Pra, përkthyesit të cilët do të kenë kapacitetin të përdorin përfitimet e programeve të inteligjencës artificiale e do të jenë të përditësuar me të gjitha risitë teknologjike bashkëkohore, do ta kenë suksesin të padiskutueshëm duke garantuar krahas shpejtësisë, dhe saktësinë e cilësinë në çdo kontekst.

BIBLIOGRAFIA

Chengxiao Xiao (2021) *J. Phys.: Conf. Ser.* 1992 022079

Fink-Hooijer, F. (2017). Artificial Intelligence - the (un)desired revolution? *Lebende Sprachen*, 62(2), 269-274.

https://www.docomix.com/comic/k7NcB6JoM5t_Nn3y

[https://thelanguagedoctors.org/blog/the-evolution-of-translation-technology-trends-and-innovations-shaping-the-industry/#:~:text=The%20digital%20revolution%2C%20which%20includes,assisted%20translation%20\(CAT\)%20tools.](https://thelanguagedoctors.org/blog/the-evolution-of-translation-technology-trends-and-innovations-shaping-the-industry/#:~:text=The%20digital%20revolution%2C%20which%20includes,assisted%20translation%20(CAT)%20tools.)

KAZUO ISHIGURO DHE JAPONIA

MSc Blerina Zaimi

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E mail: blerina.zaimi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky artikull mëton të hedhë dritë mbi marrëdhëniet e shkrimtarit anglez me origjinë japoneze, Kazuo Ishiguro, me Japoninë dhe gjithashtu të shqyrtojë vendin e tij në traditën e saj letrare. Kazuo Ishiguroja dhe familja e tij u larguan nga Japonia kur ai ishte pesë vjeç dhe nuk u kthyen më për të jetuar atje. Megjithatë, për shkak të dy romaneve të tij të para, “Dritë e zbehtë mbi kodra” dhe “Artist i botës fluturake”, ngjarjet e të cilave zhvillohen kryesisht në Japoni, kritikë letrarë dhe studiues (kryesisht ata në Perëndim) që kanë studiuar opusin e Ishiguros, argumentojnë se ai i përket traditës letrare japoneze. Ky artikull jep shembuj për të treguar se si i mbështetin ata pretendimet e tyre. Nga ana tjetër, studiues, kritikë dhe lexues japonezë kanë pasur reagime të ndryshme sa i përket veprës së Ishiguros sepse prisnin që ai të portretizonte Japoninë dhe jetën japoneze me besnikëri, por pritshmëritë e tyre nuk u përmbushën. Si rezultat, u zhgënjyen dhe fillimisht e humbën interesin për krijimtarinë e tij. Ky artikull nxjerr në pah se Ishiguroja nuk i përket traditës letrare japoneze, megjithëse nuk mund të mohohet fakti se vepra e tij përmban elemente japoneze.

Fjalë kyçe: Kazuo Ishiguroja, Japonia, tradita letrare japoneze, Japonia imagjinare.

ABSTRACT

This article aims to shed light on the relationship of the Japanese-English writer, Kazuo Ishiguro, with Japan and also consider his place in its literary tradition. Kazuo Ishiguro and his family left Japan when he was five years old and never returned to live there again. However, because of his first two novels, *A Pale View of Hills* and *An Artist of the Floating World*, which are mainly set in Japan, literary critics and scholars (mostly the ones from the West) who have studied Ishiguro's opus, argue that he has strong roots in the Japanese literary tradition. This article provides examples to show how they support their claims. On the other hand, Japanese scholars, critics and readers have had mixed feelings about Ishiguro's work, because they expected him to portray Japan and Japanese life faithfully, but their expectations were not fulfilled. As a result, they were disappointed and lost interest in his work initially. This article makes the point that Ishiguro does not belong to the Japanese literary tradition, although we cannot deny the fact that his work contains Japanese elements.

Key Words: Kazuo Ishiguro, Japan, Japanese Literary Tradition, Imaginary Japan.

Marrëdhënia e Kazuo Ishiguros me Japoninë është njafat interesante. Deri nga fundi i adoleshencës, ai u rrit me idenë se do të kthehej në Japoni dhe se jeta e tij do të vazhdonte atje, por kur u vendos përfundimisht se nuk do të kthehej më, filloi të ndërgjegjësohej se mbase vendlindja, për të cilën tani kishte mall, më vonë, do t'i mbetej në kujtesë thjesht si një vagëllimë. Ndaj, për ta ruajtur me çdo kusht para se t'i venitej dhe t'i zhdukej krejt, nisi ta hedhë me shkrim në dy romanet e tij të para. Bazuar në këto zhvillime, disa studiues dhe kritikë letrarë janë rrekur ta vendosin autorin në traditën letrare japoneze. Megjithatë, duhet përmendur se në romanin e tij të tretë e më pas, Ishiguro e shmang sfondin japonez dhe i vendos ngjarjet e romaneve të tij në Angli, ose në sfone imagjinare. Kjo ka sjellë si rezultat që disa studiues dhe kritikë të tjerë ta vendosin autorin në traditën letrare angleze. Gjithsesi, fokusi i këtij artikulli nuk është të përqendrohet në këtë mendim të fundit, por të trajtojë marrëdhëniet e Ishiguros me Japoninë dhe të nxjerrë në pah si kanë arsyetuar disa kritika letrarë kur e lidhin Ishiguron me traditën letrare japoneze.

Për humor, profesori Romit Dasgupta e nis një nga esetë e tij me një anekdotë personale. Kur po udhëtonte me avion për të shkuar në një konferencë mbi Kazuo Ishiguron që organizonte Universiteti Midëll Ist në Ankara, ai fillon të shfletojë revistën “Skailaif” të ofruar nga “Turkish Airlines” gjatë fluturimit. Aty ndesh një artikull që fliste për destinacionet e ndryshme të pushimeve dhe, krahas të tjerave, përmendte shkrimtarët më përfaqësues të secilit vend. Një nga vendet e reklamuar ishte edhe Japonia. Nuk u çudit që artikulli përforconte shumë nga stereotipet e njohura orientale dhe ekzotike për Japoninë si pemët e lulëzuara të qershisë, bonsain, haikun, malin Fuxhi e disa gjëra të tjera. Por mes shkrimtarëve më të famshëm japonezë të shekullit të njëzetë, si Jasunari Kavabata dhe Kenzaburo Oe, përmendej edhe Kazuo Ishiguro. Dasgupta shprehet se kjo e befasoi, pasi i dukej e tepër që “një njeri, i cili kishte jetuar vetëm pesë vitet e para në Japoni dhe më tej nuk kishte jetuar periudha të gjata aty dhe as që e fliste japonishten të konsiderohej mishërimi i “trashëgimisë japoneze” (Dasgupta, 2016, f. 11). Siç vazhdon më tej, ai po shkonte në një konferencë për romancierët britanikë, ndërsa nga çfarë lexoi dilte që Ishiguro ishte romancier japonez. Nisi të vriste mendjen se, po të ishte edhe Britania mes vendeve të reklamuar në artikull, a do të ishte radhitur Ishiguro mes shkrimtarëve më përfaqësues të Britanisë? (Dasgupta, 2016, f. 11) Kjo anekdotë nxjerr në pah perceptimet që kanë shoqëruar autorin dhe veprën e tij: të dyja vendet, si Japonia edhe Anglia, kanë pretenduar se ai i përket trashëgimisë së tyre letrare.

Vlen të përmendet, gjithsesi, se kanë qenë fillimisht studiuesit dhe kritikët letrarë perëndimorë ata që i kanë mëshuar elementeve japoneze të romaneve të para të Ishiguros, dhe jo ata japonezë. I pyetur në një intervistë se si janë pritur fillimisht romanet e tij në Japoni, Ishiguro komenton se ka pasur më tepër kuriozitet për të si person, ngaqë është japonez i rritur në Perëndim, sesa për romanet e tij të vendosura në Japoninë e pasluftës. Këto janë gjëra që japonezët i kanë kaluar me kohë dhe tani po jetojnë në një fazë tjetër. Për më tepër, ato janë shkruar nga dikush që ka vite që nuk jeton atje (Kelman, 2008, f. 43). Në të njëjtën linjë mendimi, studiuesja Xherin Ten (2023) vëren se “[p]as marrjes së çmimit Nobel në letërsi më 2017, të dyja vendet, si Japonia dhe Anglia, e konsiderojnë autorin të tyrin. Edhe pse Ishiguro nuk ka jetuar në Japoni që kur u largua nga Nagasaki në moshën pesëvjeçare, edhe pse fillimisht japonezët e priten veprën e tij në mënyrë të vakët, Japonia e citon shpesh Ishiguron si autorin e saj të tretë të vlerësuar me çmimin

Nobel” (f. 59). Nga krahu tjetër, Anglia mëton se Ishiguro radhitet mes shkrimtarëve të tjerë etnikë që i përkasin traditës së saj letrare. Meqenëse qëllim i këtij artikulli është të nxjerrë në pah marrëdhënien e Ishiguros me Japoninë, në vijim do të marrim në shqyrtim disa arsye të ku bazohen këto pretendime.

Studiuesit dhe kritikët që e vendosin Ishiguron në traditën letrare japoneze përqendrohen kryesisht tek elementet japoneze të dy romaneve të tij të para. Kjo prirje mori hov sidomos gjatë viteve '80, vite këto kur u shkruan edhe këto dy romane. Si në romanin “Dritë e zbehtë mbi kodra”, ashtu edhe në “Artist i botës fluturake” ngjarjet vendosen në Japoni pas Luftës së Dytë Botërore; në të parin kryesisht në Nagasaki dhe në të dytin në një vend të papërcaktuar në Japoni. Lufta përhijet nga kujtimet e protagonistëve, Ecukos dhe Masuxhi Onos. Ecukoja përmend fëmijë që humbën jetën nga bombardimet; ajo vetë humbi të fejuarin, Saçikoja humbi të shoqin dhe zonja Fuxhivara gjithë familjen, veç djalit të madh. Masuxhi Onoja humbi të birin dhe të shoqen dhe tani ndërlyshet për artin e tij propagandist që duket se ka shpënë shumë veta, mes tyre plot të rinj, drejt vdekjes. Japonia e pasluftës është një vend ku përplasen tradita me ndryshimin. Nga njëra anë vërehen shtëpitë tradicionale me dyer rrëshqitëse që ndajnë dhomat e shtruara me *tatami*, ngrënia me shkopinj, veshjet *kimono*, shërbimi i çajit, *sakeja*, përkulja si formë përshëndetjeje, gjuha formale mes prindërve dhe fëmijëve, nxiija e djemve për t'u bërë dikushi në shoqëri, nënshtrimi dhe respekti që u tregojnë gratë bashkëshortit dhe njerëzve të bashkëshortit, bisedat formale për martesë mes familjes së vajzës dhe djalit, ndikimi që ushtron opinioni i të tjerëve dhe, nga ana tjetër, njerrin kryet blloqet e apartamenteve të stilit amerikan, fëmijët mosmirënjohës e rebelë ndaj prindërve, gra të pabindura ndaj bashkëshortit, ose të divorcuara dhe vajza që ndjekin stilin perëndimor të bashkëjetesës në vend të martesës.

Nisur nga zgjedhjet tematike dhe stilistike të autorit, studiuesit kanë bërë një sërë interpretimesh që nga psikologjia, tek artet pamore e deri tek arkitektura. Për shembull, në një analizë të teorisë dhe praktikës së artit pamor në romanet e Ishiguros, studiuesja Fiona Tomkinson (2016) shqyrton një skenë nga romani “Dritë e zbehtë mbi kodra”, ku një vajzë e vogël e quajtur Mariko vizaton një flutur që, sipas saj, “edhe pse incident i parëndësishëm në dukje, ka rezonancë të thellë” (f. 62). Ajo e mbështet këtë pohim duke shpjeguar se flutura ka domethënie simbolike shumëvalente në kulturën japoneze. Për shembull, flutura simbolizon vajzat e vogla dhe daljen e tyre në jetë, vërshimin e kujtimeve dhe, mbi të gjitha, shpirtin e të gjallëve dhe të vdekurve. Një flutur që del nga krizalida simbolizon shkëputjen e shpirtit nga trupi pas vdekjes dhe transformimin që pëson njeriu gjatë cikleve të jetës, faza këto që pranohen me gëzim. Flutura lidhet edhe me traditën skeptike të filozofisë lindore përmes ëndrrës së famshme të filozofit kinez, Zhuangzi, i cili ëndërron sikur ishte flutur dhe pastaj nuk e di më nëse ishte njeri dhe kishte parë në ëndërr se ishte flutur, apo flutur dhe kishte parë në ëndërr se ishte njeri. Gjithashtu, flutura është subjekt tradicional i artit japonez (Tomkinson, 2016, f. 62). Pra, Fiona Tomkinsoni është ndalur te ky vizatim për të theksuar se romani i Ishiguros përmban elemente tipike japoneze. Mirëpo ky interpretim nuk e bind studiuesen Rebeka Suter (2020), e cila argumenton:

“Megjithëse fluturat janë pa diskutim të pranishme në letërsinë dhe artin pamor japonez, Lepidoptera që gjenden në gjithë botën, përveç Antarktidës, janë të pranishme në një numër të madh kulturash, në mitologji dhe në forma arti nga Egjipti i lashtë te

Mesoamerika parakolumbiane, Greqia klasike e deri tek Azia e sotme juglindore dhe Evropa Veriore. Për më tepër, meqë gjenden rëndom si në zonat rurale edhe ato urbane anembanë botës dhe kanë krahë shumëngjyrësh e forma relativisht të thjeshta, me shumë gjasa, fluturat janë objekt vizatimi i fëmijëve kudo dhe kurdo; është e vështirë të përcaktosh se i përkasin një kulture të caktuar, qoftë kjo ajo japoneze a ndonjë kulturë tjetër.” (f. 6)

Në të njëjtën skenë në romanin “Dritë e zbehtë mbi kodra”, një djalë gati moshë e Marikos që ka marrë mësimë pikturë vë në dukje të metat e një vizatimi tjetër që ka bërë ajo sepse, sipas tij, anijet dhe pema që ka vizatuar stonojnë me njëra-tjetrën, ngaqë anijet janë tepër të mëdha në krahasim me pemën. Studiuesja Tomkinson (2016) vëren se ai po zbaton parimet e pikturës perëndimore të Rilindjes për të analizuar vizatimin e një zhanri tjetër (f. 62). “Kështu, ajo e interpreton dialogun si një koment mbi qasjet e ndryshme japoneze dhe kineze ndaj artit pamor” (Suter, 2020, f. 6). Një shembull i tretë vjen nga romani “Kurrë mos më lër të shkoj” ku Tomi, një nga protagonistët e romanit, vizaton disa kafshë të vogla. Tomkinsoni i interpreton ato si *netsuke*, skulptura kafshësh a njerëzish sa gishtu i madh i dorës që përdorehin si zbukurime në periudhën e shogunit Tokugava. Duke i interpretuar imazhet pamore që gjenden në romane si tregues të traditës japoneze ose asaj lindore, Tomkinsoni zgjedh t’i lexojë romanet e Ishiguros përmes thjerrëzës japoneze. Studiuesja Rebeka Suter (2020) pyet veten se, po të mos ishte për prejardhjen japoneze të autorit, a do të ishin bërë të njëjtat interpretime? (f. 7) Edhe pse këto duken këndvështrime interesante që nuk janë trajtuar më parë, gjithsesi nuk duhen nxjerrë përfundime të nxituara për ta lidhur autorin me trashëgiminë japoneze, vetëm e vetëm ngaqë ai është me origjinë japoneze.

Edhe në romanet që në dukje nuk kanë lidhje me Japoninë, siç është “Dita e mbetur”, ka pasur orvatje për të zbuluar elementet e fshehura japoneze. I tillë është rasti i kritikut Dejvid Gureviç (1989), i cili argumenton se përshkrimet e peizazhit anglez në këtë roman pasqyrojnë kriteret estetike japoneze. Ai thotë se “vëmendja që u kushton Stivensi hollësive krahasohet me atë të një origambërsi” dhe pastaj merr përsipër të krahasojë traditën e çajit anglez me ceremoninë e çajit japonez (f. 78, cituar te Suter, 2020, f. 5). Më tej komenton se “këmbëngulja [e protagonistit] në rituale; stoicizmi i tij në kryerjen e detyrave, veçanërisht përballë vështirësive; besnikëria ndaj zotërisë që bie ndesh me nevojat e tij si njeri”, të gjitha këto janë “aspekte të rëndësishme të psikikës kolektive japoneze” dhe tregues se krijimtaria e autorit frymëzohet nga “ndjeshmëria e mprehtë japoneze” (Gurevich, 1989, f. 80, cituar te Suter 5-6).

Studiuesi Piter Mëllet (1996) e krahason zbulimin gradual të gjendjes psikologjike të personazheve në romanet “Dita e mbetur” dhe “Artist i botës fluturake” me zbulimin gradual të hapësirës në traditën arkitekturore japoneze, ku “shtëpia rrethohet nga një mur, në të cilin gjendet një portë e madhe që të lejon të futesh brenda. Pasi hyn, dyert rrëshqitëse të ofrojnë vetëm një fushëpanje të kufizuar, asnjëherë panoramën e plotë. Edhe në rastin e ndarjeve të brendshme në formë fizarmonikë, panja mund të shihet veçse nga kënde të ndryshme. Kjo ndryshon kryekëput nga arkitektura perëndimore ku panja paraqitet në një plan të gjerë për t’u parë e gjitha përnjëherësh” (f. 2, cituar te Suter, 2020, f. 6).

Gregori Mejsoni (1989) gjurmon elementet japoneze në krijimtarinë e Ishiguros bazuar në atë që ka thënë vetë autori: “Kinemaja është një aspekt i kulturës japoneze që ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në krijimtarinë time” (f. 39). Sipas Mejsonit (1989), filmat

japonezë, sidomos *shomin-geki*, kanë krijuar në mendjen e autorit një imazh ndryshe për të shkuarën e atdheut të tij që është larg klisheve diskredituese të militarizmit dhe të vetëvrasjes (f. 40). Në fakt, ata i kanë dhënë Ishiguros mundësinë të kthehet në Japoninë e fëmijërisë së tij dhe të rigjallërojë kujtimet e së kaluarës.

Sipas Mejsanit (1989), romani “Dritë e zbehtë mbi kodra” është plot e përplot me elemente të huazuara nga filmat japonezë. Orvatjet e Ecukos, protagonistes së romanit, për pavarësi dhe dinjitet të sjellin ndër mend heroinat e filmave të tillë si ai i Mikio Naruses “Kur një grua ngjit shkallët” (1960); qenia e saj e dyzuar nga ndjenjat e fajit të sjell në mendje imazhe të filmit “Zemra” (1955) të regjisorit Kon Içikava dhe rrëfimet fantazmëndjellëse të nënave, vajzave dhe zonjave të moshuara i bëjnë jehonë filmit “Ugetsu” (1953) të regjisorit Kenji Mizoguci; kthimet pas në kujtime të rrëfimitarit Ono në romanin “Artist i botës fluturake” e thyjnë subjektin linear, çka të kujton metodën e regjisorit Jasuxhiro Ozu, të cilin autori e admiron (f. 41).

Kritiku Uai-çu Sim (2010) vëren se “Ishiguro nuk pranon të krahasohet me ndonjë shkrimtar japonez” (f. 11), megjithatë duhet përmendur se filmat *shomin-geki* si ata të Jasuxhiro Ozut dhe Naruse Mikios kanë ndikuar në krijimtarinë e tij. Duke komentuar për dy vajzat e protagonistes së romanit “Dritë e zbehtë mbi kodra”, Keikon dhe Nikin, njëra e lindur në Japoni me baba japonez dhe e dyta e lindur në Angli me baba anglez, Simi (2010) shprehet se ato shërbejnë si metonimi për Japoninë dhe Perëndimin (f. 29). Gjithashtu, ai e interpreton këtë roman si parodi të operës së Xhakomo Puçinit “Madamë Batërfilai”, ngjarjet e së cilës vendosen në Nagasaki ku lind një romancë mes një gruaje japoneze dhe një të huaji (f. 27-35). Ndërsa zhvillimin artistik të Masuxhi Onos në romanin “Artist i botës fluturake”, sidomos përdorimin e ngjyrave në pikturat e tij, e quan metaforë për historinë e Japonisë në fillimshkullin e njëzetë. Sipas tij, ky zhvillim simbolizon modernizimin dhe fuqizimin e Japonisë nën ndikimin e modelit perëndimor (f. 40).

Kritikët dhe studiuesit perëndimorë nuk ishin të vetmit që e perceptuan Ishiguron si autor japonez. Edhe ata në Japoni pritnin që ai të ishte i tillë, meqenëse ishte me origjinë japoneze dhe kishte lindur në Japoni. Siç vëren shkrimtari i njohur japonez dhe fituesi i çmimit Nobel, Kenzaburo Oe (2008), në intervistën që pati me Ishiguron, ai përshkruhej si “një autor shumë i qetë e paqësor dhe, për rrjedhojë [si] një autor shumë japonez” (f. 57). Këta kritikë dhe studiues po niseshin nga stereotipe kombëtare “vetë-orientalizuese” (Dasgupta, 2016, f. 14) për të gjykuar veprën e Ishiguros. Por, kur këto pritshmëri nuk u përmbushën, ata u përshtjelluan, ngaqë nuk dinin si ta kategorizonin shkrimtarin. Si rezultat, lindën reagime të ndryshme.

Studiuesit Motojuki Shibata dhe Motoko Sugano (2009) gjurmojnë disa prej çështjeve që lidhen me elementet kulturore. Më poshtë jepet një shembull nga romani “Dritë e zbehtë mbi kodra”, përkthyer në japonisht nga Takeshi Onodera:

“Asokohe, vajtjet në distriktin Nakagava ende më ngjallnin një përzierje ndjenjash trishtimi dhe kënaqësie. Ishte një zonë kodrinore dhe, teksa ngjitesha sërish në ato rrugë të ngushta e të përpjeta mes grumbujve të shtëpive, nuk më ndahej ndjesia e thellë e humbjes. Megjithëse nuk ishte një vend ku shkoja me qejf, prapë nuk rrija dot gjatë pa shkuar.

Edhe vizitat te zonja Fuxhivara ngjallnin tek unë pak a shumë të njëjtat ndjenja, sepse ajo kish qenë një nga shoqet e ngushta të sime mëje; një grua e dashur me flokë që po i ktheheshin në gri. Lokali i saj i makaronave nudëll gjendej në një rrugicë plot gjallëri, kishte përpara ishte një pjesë të shtruar me beton e të mbuluar me strehë, si dhe stola e tavolina prej druri ku uleshin myshterijet. Asaj i ecte mirë tregtia nga punonjësit e zyrave që hanin aty drekën dhe uleshin prapë para se të largoheshin për në shtëpi, por në orare të tjera të ditës ishte thujse zbrazët.” (Ishiguro 1982/2021, f. 23, përkthimi im)

Këta studiues komentojnë se “‘rrugët e ngushta e të përpjeta mes grumbujve të shtëpive’ dhe ‘lokali i makaronave nudëll që gjendej në një rrugicë plot gjallëri’ do të dukeshin disi ekzotike a mbase të panjohura për lexuesit anglishtfolës” (Shibata & Sugano, 2009, f. 24), veçse, nuk do të kishin të njëjtin efekt te lexuesit japonezë, për të cilët “lokalet e vogla me tavolina dhe stola prej druri ku rrogëtarët hanë shpejt e shpejt një tas me *udon* ose *ramen* (fast fud tradicional japonez) janë më se të zakonshme, ndaj asgjë s’do të tingëllonte ekzotike” (Shibata & Sugano, 2009, f. 24).

Reagimet e lexuesve japonezë kushtëzoheshin edhe nga mosha e tyre. Ata që e njihnin Nagasakin e viteve fill pas luftës do ta nuhatnin detajin se, ndonëse ai vend është po aq kodrinor sot sa ç’ishte edhe pas luftës, kur doli për herë të parë në shtyp romani “Dritë e zbehtë mbi kodra”, shtëpitë e vogla ishin zëvendësuar tashmë me apartamente betoni. Po ashtu, lokalet *udon* janë me shumicë në Nagasaki, por tani drejtohen kryesisht nga një rrjet lokalesh dhe jo nga individë, siç është rasti i zonjës Fuxhivara në roman. Me pak fjalë, ky fragment evokon nostalgji për lexuesit japonezë që e njohin atë periudhë, por për më të rinjtë nuk ka të njëjtin efekt. Edhe lexuesit anglishtfolës që nuk e kanë përtjetuar atë kontekst kulturor dhe historik nuk arrijnë të kapin nuancat. Në fakt, ato elemente që ngjallin nostalgji në një kulturë për një brez të caktuar, për brezin tjetër të së njëjtës kulturë ose për kulturën e huaj interpretohen krejt ndryshe (Shibata & Sugano, 2009, f. 24-25).

Për më tepër, përkthimi japonez i këtij romani nuk i nxiti kritikët dhe lexuesit të krahasonin kohën dhe vendin e përshkruar aty me Japoninë reale në fundin e viteve ’40, por me filmat japonezë që portretizonin atë periudhë, si filmat e Jasuxhiro Ozut, të cilët luajtën një rol të rëndësishëm në formimin e imagjinatës së Ishiguros kur ishte te të njëzetat. Sipas kritikëve, “Ishiguroj ... nuk përshkroi Japoninë që njohu kur ishte fëmijë, por rikrijoi ose ri-imagjinoi një Japoni që s’e kishte njohur (thujse) kurrë, duke përdorur filma dhe romane japoneze si lëndën e parë për frymëzim” (Shibata & Sugano, 2009, f. 25).

Edhe përkthimi i romanit “Artist i botës fluturake” nga Shigeo Tobita nuk u prit me entuziazëm nga kritikët dhe lexuesit japonezë, ngaqë hasën vështirësi kuptimore. Së pari, titulli në japonisht *Ukiyo no Gaka* mund të interpretohej në më shumë se një mënyrë: 1. artist që e shqetëson bota materialiste e larguar nga arti; 2. artist që jeton në një botë fluturake, domethënë që jepet pas jetës së natës, pas kënaqësive, pas argëtimit dhe pijes. Pra, titulli në japonisht kishte një kuptim më të gjerë se titulli në anglisht dhe ishte i paqartë. Së dyti, titulli e vinte theksin mbi një botë ekzistuese që tashmë kishte marrë përmasa mitike, që evokonte imazhe të kulturës japoneze, por ndoshta ishte më tepër stereotip i një Japonie ekzotike siç shihej nga jashtë, nga bota perëndimore sesa nga vetë japonezët. Japonezët jetonin shumë larg atij realiteti tashmë të shkuar e të harruar, prandaj nuk u interesonte më. Një debat tjetër lindi edhe nga zgjedhja e ideografeve kineze nga ana e përkthyesit për të dhënë emrat e personazheve dhe të vendeve, çka është e pazakontë

për veprat e huaja të përkthyer në japonisht, sepse kështu ato e humbasin nuancën e të qenit të huaj. Tobita u kritikua për këtë zgjedhje që, sipas kritikëve, e bëri romanin e shkruar në një gjuhë të huaj të dukej “tepër japonez dhe si rrjedhojë “jo autentik” (Shibata & Sugano, 2009, f. 27, kursivi në origjinal). Edhe zgjedhja e gjuhës për të dhënë dialogët e personazheve nuk ishte e duhura, pasi personazhet dukeshin më të edukuar dhe më të rezervuar, gjë që nuk pasqyronte gjuhën e përdorur nga lexuesit japonezë bashkëkohorë. Prandaj, Japonia e romanit duket një Japoni e pavërtetë, ose, më së shumti, një Japoni e filmave të Ozut dhe Akiro Kurosavës.

Në shkrimin e tij për romanin “Artist i botës fluturake”, kritiku japonez Masashi Miura (1988) u shpreh se Ishiguro i trajton çështjet japoneze në mënyrë të pazakontë, çka e befasoj vërtet. Ai merrte si shembull Onon kur thotë se ai dhe mentori i tij, Macuda, e kishin bërë çdo gjë nisur nga motive të mira. Por cilat ishin motivet e mira? Kjo pikë mbetet e errët. Përmendte edhe përshkrimet e disa pikturave që dukeshin të çuditshme kur përktheheshin në japonisht, por “mbase kështu duken ato në sytë e botës jashtë”. Po kështu, ai thekson faktin se “në Japoni përgjegjësia e artistit për realizimin e pikturave që propagandonin luftën është një çështje e mbyllur me kohë, por situata duket ndryshe nga ata jashtë” (f. 12, cituar te Shibata & Sugano, f. 28).

Meqenëse kritikët, studiuesit dhe lexuesit japonezë e konsideronin Ishiguron si “shkrimtar japonez”, pritshmëritë e tyre mund të kenë qenë të tilla që ai t’i njihnte mirë çështjet bashkëkohore japoneze, t’i paraqiste ato me besnikëri dhe të shkruante në një mënyrë që të kuptohej lehtë prej tyre. Megjithatë, atyre iu shpëton një fakt i rëndësishëm që Ishiguro e ka deklaruar haptazi qysh herët. Japonia për të cilën flet në romanet e tij nuk është Japonia e vërtetë apo Japonia e saktë nga ana historike, por një Japoni imagjinare:

“Sigurisht, nuk e njihja Japoninë sepse nuk erdha këtu. Por, në Angli gjatë gjithë kohës krijoi imazhin tim në kokë të një Japonie imagjinare, si të thuash, dhe kur mbusha njëzetetë a njëzetekatër vjeç, kuptova se kjo Japoni që ishte kaq e shtrenjtë për mua, faktikisht ekzistonte vetëm në imagjinatën time, pjesërisht sepse Japonia e vërtetë kishte ndryshuar shumë nga vitet ’60 e këtej. Kuptova se ajo ishte vetëm Japonia e fëmijërisë sime dhe se unë nuk do të kthehesha dot më atje. Kështu, mendoj se një nga arsyet e vërteta pse fillova të shkruaja romane ishte se doja ta rikrijoja këtë Japoni—të bëja bashkë tërë kujtimet dhe të derdhja gjithë fantazinë për këtë vend që e quaja Japoni. Doja ta ruaja të sigurt, ta hidhja në një libër para se të më shuhej nga kujtesa.” (Oe, 2008, f. 53)

Autori nuk është ndier mirë kur romanet e tij janë interpretuar në mënyrë literale dhe ai është stereotipizuar si “shkrimtar japonez”. Në rastin e vendosjes së ngjarjeve në Nagasaki në romanin e tij të parë, për shembull, ai shprehet se ishte penduar për këtë zgjedhje, sepse lexuesit kërkonin të gjenin referime të fshehura për bombardimin e qytetit që, në fakt, nuk gjenden në këtë vepër. Qëllimi i tij në këtë roman nuk ishte t’i ndihmonte lexuesit të kuptonin si ishte Japonia e asaj kohe.

Sipas studiueses Rebeka Suter (2020), Japonia që përshkruan Ishiguro është një “Japoni për fillestarët” ose një “Japoni për turistët” dhe autori luan rolin e një “shkrimtari japonez” (f. 27) sepse, me sa duket, kjo është ajo që pret lexuesi perëndimor nga një shkrimtar me emër dhe tipare japoneze si ai. Në romanin “Dritë e zbehtë mbi kodra”, ironia duket sidomos në përshkrimin e peizazheve dhe të vendeve të ndryshme që krijojnë përshtypjen e përshkrimeve sipërfaqësore dhe stereotipike. Shumë veta e përfytyrojnë

Nagasakin e pasluftës si një vend të shkatërruar nga bombardimet, ndaj Ishiguro ua jep këtë kënaqësi duke e vendosur shtëpinë ku jeton Ecukoja me burrin e saj japonez, Jiron, dhe vjehrrin e saj, Ogata-sanin, në lindje të qytetit, në një zonë të rrënuar nga bombardimet ku sa kanë filluar të shfaqen shenjat e para të rindërtimit: apartamente betoni identike me njëra-tjetrën që janë në pronësinë e një kompanie; banja dhe kuzhina me stil perëndimor dhe dhoma gjuni të shtruara me *tatami*. Këto janë imazhet stereotipike të Perëndimit për Japoninë e pasluftës të krijuara nga librat dhe filmat e Ozut dhe Kurosavës. Apartamentet japoneze karakterizohen nga ndarjet rrëshqitëse *fusuma* për të shkuar nga njëra dhomë në tjetrën, personazhet ulen mbi jastëkët *zabuton* dhe hanë me tasa e shkopinj, ata presin te hyrja që të mos shkelin mbi *tatami* dhe i heqin këpucët para se të futen brenda. Rebeka Suteri (2020) vëren se “[n]ë një roman japonez, veprime të zakonshme si të lësh shkopinjtë mbi tavolinë, të mbushësh gotën me çaj, të shkelësh a të mos e shkelësh *tatamin*, të heqësh këpucët te hyrja janë veprime automatike, ndaj nuk përmenden. Fakti që në tekst dalin kaq shpesh tregon se janë dhënë për vëzhguesin perëndimor, për të cilin këto elemente janë të huaja” (f. 28).

Romani “Artist i botës fluturake” përmban disa shembuj të tjerë ku autori luan disi me stereotipet e lexuesit perëndimor për Japoninë. Në rininë e tij Onoja punoi për një kompani të quajtur Takeda që specializohej në produkte artistike ekzotike për t’u konsumuar në Perëndim. Kjo kompani kërkonte nga Onoja dhe piktorët e tjerë të pikturonin geisha, pemë qershie, peshq krap notues dhe tempuj, ngaqë këto elemente dukeshin “japoneze” për të huajt. Mbase stili elegant i pikturave nuk do të përfillej aq shumë, prandaj nuk kishin pse t’i kushtonin rëndësi të madhe. Një shembull tjetër është hoteli “Parku Kasuga” ku do të zhvilloheshin *miai* (bisedimet për martesë) mes familjeve Ono dhe Saito për vajzën e dytë të Onos, Norikon, dhe djalin e madh të Saitove. Kur përshkruan hotelin, Ono thotë se “... administratorët e hotelit kanë vendosur t’i mobilojnë dhomat me një stil disi vulgar, nëpërmjet të cilit, sigurisht, synohet të joshen klientët amerikanë, për të cilët ky vend është i njohur për sharmin “japonez” aq tërheqës për ta” (Ishiguro 1986, f. 130, përkthim i Loran Gamit).

Rebeka Suteri (2020) shton se “etja e klientelës së huaj të firmës Takeda për piktura me “imazhin japonez” dhe shija e klientelës amerikane në “Parkun Kasuga” për “sharmin japonez” të sjellin ndër mend komentet e hershme mbi krijimtarinë e Ishiguros, të cilat, sipas Sinthia Uongut, “e etiketojnë Ishiguron si një shkrimtar të huaj që thjesht shkruan në gjuhën angleze” (Wong, 2000, f 8, cituar te Suter, f. 29). Në fundin e viteve ’80 dhe fillimin e viteve ’90, kritikët e shihnin veprën e Ishiguros si një derë për të hyrë në Japoninë e mistershme. Por, siç u përmend më parë, autori nuk ndihej mirë kur romanet e tij visheshin me ekzotizëm:

“Mendoja se po më lavdëronin për gjërat e gabuara. Shpesh ndihesha si sharlatan. Njerëzit mendonin se isha njëfarë eksperti i traditës japoneze. ... Ata po më shtynin që të merrja përsipër t’ua shpjegoja këtë kulturë disi të mistershme. Unë u rrita në Angli, ndaj nuk isha i aftë t’ua shpjegoja njerëzve traditën japoneze.” (Matsuda 1995, f. 2, cituar te Suter, 2020, enf. 29)

Përfundime

Siç kemi shqyrtuar gjatë këtij artikulli, Japonia e Ishiguros është një Japoni e krijuar nga fantazia dhe nga ajo që autori ka lexuar në libra e ka parë në filma, një Japoni e ngrirë në kohë, në fëmijërinë e Ishiguros, ndaj ai e vesh atë me nostalgji. Ai nuk shqetësohet nëse bota që ka trilluar nuk përkon me realitetin historik: “Jam i mendimit se si shkrimtar i letërsisë artistike duhet të bëj pikërisht këtë—të shpik botën time dhe jo t’i kopjoj gjërat nga realiteti” (Oe, 2008, f. 53-54). Në një intervistë tjetër, Ishiguro u shpreh se “elementi japonez ishte një pjesë relativisht sipërfaqësore e romaneve të tij” dhe, sado që ai ishte emocionalisht i lidhur me Japoninë, prapëseprapë e përdori këtë lidhje “për të orkestruar diçka tjetër që i interesonte më shumë” (Biggsby, 2008, f. 23).

Sado që autori ka origjinë japoneze dhe romanet e tij të para përmbajnë elemente japoneze, përsëri nuk mund të arrihet në përfundimin se ai i përket traditës letrare japoneze. Ky përfundim do të ishte i nxítuar dhe i pabazë, pasi Ishiguro e njeh kulturën japoneze vetëm në sipërfaqe, ose, e thënë ndryshe, nga pikëpamja e dikujt që jeton jashtë kulturës; nga pikëpamja e një japonezi që u rrit në perëndim. Pa dyshim, ai e njeh Japoninë më shumë se një i huaj, porse gjithsesi i mungon njohuria e thellë për të folur dhe për të pasqyruar ndjeshmërinë japoneze në veprën e tij. Ai nuk merr përsipër të portretizojë “shpirtin” japonez, sepse thjesht nuk ka jetuar aq gjatë në Japoni sa të jetë në gjendje ta njohë dhe ta kuptojë esencën e tij. Japonia që ndeshim në krijimtarinë e autorit, nuk është gjë tjetër veçse një Japoni e krijuar nga fantazia dhe dëshira për ta ruajtur në kujtesën e tij këtë vend, ku mund të kishte pasur një jetë tjetër. Fundja, ky është misioni i shkrimtarit: të krijojë një botë që të lë mbresa, ndonëse është një botë “fluturake”, jashtë realitetit historik.

BIBLIOGRAFIA

- Bigsby, C. (2008). *In Conversation with Kazuo Ishiguro*, në “Conversations with Kazuo Ishiguro”, University Press Of Mississippi, Mississippi.
- Dasgupta, R. (2016). *Kazuo Ishiguro and ‘Imagining Japan’*, në “Kazuo Ishiguro in a Global Context”, Cynthia F. Wong and Hülya Yildiz (eds.), Routledge. New York.
- Gurevich, D. (1989). *Upstairs, Downstairs*, në “New Criterion”, 8 (4), f. 77-80.
- Ishiguro, K. (1982). *A Pale View of Hills*. Faber and Faber, London.
- Ishiguro, K (1986). *An Artist of the Floating World*. Faber and Faber, London.
- Kelman, S. (2008). *In Conversation with Kazuo Ishiguro*, në “Conversations with Kazuo Ishiguro”. University Press Of Mississippi, Mississippi.
- Mallett, P. J. (1996). *The Revelation of Character in Kazuo Ishiguro’s The Remains of the Day and An Artist of the Floating World*, në “Shoin Literary Review”, 29, f. 1-20.
- Mason, G. (1989). *Inspiring Images: The Influence of the Japanese Cinema on the Writings of Kazuo Ishiguro*, në “East-West Film Journal”, vol. 3, no. 2, 1989, f. 39-52. <https://scholarspace.manoa.hawaii.edu/server/api/core/bitstreams/da89442f-2237-4fa8-837b-ae701556c4cb/content>.
- Matsuda, J. (1995). *Personalities: Kazuo Ishiguro*, në “Rafu Shimpo”, Los Angeles Japanese Daily News, October 28.
- Miura, M. (1988). *Senchū no Shinnen wo tou [Interrogating his faith during the war]*, në “Asahi Shimbun”, 4 April, Morning edition, 12.
- Sim, W. C (2010). *Kazuo Ishiguro*. Routledge, USA.
- Suter, R. (2020). *Two-World Literature: Kazuo Ishiguro’s Early Novels*, University of Hawai’i Press, USA.
- Shibata M. and Sugano M. (2009). *Strange Reads: Kazuo Ishiguro’s A Pale View of Hills and An Artist of the Floating World in Japan*, në “Contemporary Critical Perspectives”, Sean Matthews and Sebastian Groes (eds.), Continuum, London and New York.
- Shonaka et al., (eds.). *Introduction*, në “Japanese Perspectives on Kazuo Ishiguro”. Palgrave Macmillan, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-031-24998-3_1.
- Tan, J. (2023) *Immigration and Emigration in Ishiguro*, në “The Cambridge Companion to Kazuo Ishiguro”, Andrew Bennett (ed.), Cambridge University Press, UK.
- Tomkinson, F. (2016). *Ishiguro and Heidegger: The World of Art*, në “Kazuo Ishiguro in a Global Context”, Cynthia F. Wong and Hülya Yildiz (eds.), Routledge. New York.
- Wong, C. F.(2000). *Writers and Their Work: Kazuo Ishiguro*. Tavistock, Northcote House Publishers, UK.

**QASJET EDUKATIVE DHE MBËSHTETJA PSIKO-SOCIALE
PËR NXËNËSIT ME ADHD NË MJEDISËT SHKOLLORE.
STRATEGJI DHE PRAKTIKA EFEKTIVE.**

MSc Edlira (Milla) Hani
American British STEM Academy
E-mail: edamilla1@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Trajtimi i çrregullimeve të sjelljes dhe ADHD-së në mjediset shkollore synon aftësimin teoriko-praktik të stafit mësues për të përballuar dhe menaxhuar këto sfida në kontekstin e zhvillimeve të reja shoqërore dhe arsimore. Ky çrregullim nuk lidhet vetëm me historinë individuale të nxënësit dhe strukturat e tij të brendshme, por edhe me kulturën bashkëkohore, etikën dhe organizimin shoqëror, duke kontribuar kështu në një përfitim shoqëror më të gjerë. Nxënësi me ADHD shpesh interpreton realitetin bazuar në perceptimet e tij personale dhe jo në konkluzione konceptuale, dhe mënyrat irracionale të menduarit përbëjnë pjesë të zhvillimit normal konjitiv dhe emocional të tij. Kjo e bën të nevojshme një qasje të veçantë në edukimin shkollor. Trendi aktual i arsimit gjithëpërfshirës dhe formësimit të pedagogjisë së specializuar thekson rëndësinë e adresimit të këtyre çështjeve në mënyrë të qëndrueshme. Kjo qasje jo vetëm që përmirëson cilësinë e arsimit, por edhe nxit një mjedis më të përfshirës dhe të mirëkuptuar për nxënësit me çrregullime të sjelljes dhe ADHD.

Fjalët çelës: ADHD, PEI (Plani i Edukimit Individual), edukimi gjithëpërfshirës

ABSTRACT

The treatment of behavioral disorders and ADHD in school settings aims at the theoretical-practical training of teaching staff to face and manage these challenges in the context of new social and educational developments. This disorder is not only related to the student's individual history and internal structures, but also to contemporary culture, ethics and social organization, thereby contributing to a wider societal benefit. The student with ADHD often interprets reality based on his personal perceptions rather than conceptual inferences, and irrational ways of thinking are part of his normal cognitive and emotional development. This necessitates a special approach to school education. The current trend of inclusive education and the shaping of specialized pedagogy emphasizes the importance of addressing these issues in a sustainable manner. This approach not only improves the quality of education, but also fosters a more inclusive and understanding environment for students with behavioral disorders and ADHD.

Keywords: ADHD, PEI (Individual Education Plan), inclusive education

Hyrje

Shqetësimet për çrregullimet e sjelljes te fëmijët, veçanërisht për ata me Çrregullim të Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit (ADHD), kanë marrë një rëndësi të veçantë në fushën e edukimit gjithëpërfshirës. ADHD është një çrregullim neuro-zhvillimor i karakterizuar nga pavëmendja, hiperaktiviteti dhe impulsiviteti, që ndikon në aftësinë e një fëmije për të funksionuar në mënyrë efektive në mjedise të ndryshme, përfshirë shkollën¹. Fëmijët me ADHD karakterizohen nga një aktivitet i lartë fizik dhe nuk rrinë dot për shumë kohë në një vend. Nuk ndjehen mirë as kur detyrohen të qëndrojnë ulur në karrige dhe gjithmonë shtrihen². ADHD (Attention Deficit Hyperactivity Disorder) është një çrregullim i trurit që ka të bëjë me një ndryshim të ndërtimit dhe funksionimit të një pjese të tij, pikërisht me atë të lobit qendror (frontal) të trurit dhe që, për fat të keq, ashtu si për çdo çrregullim tjetër nervor, shkaqet e vërteta nuk dihen. ADHD-ja ka shkaqe biologjike dhe përgjithësisht është e trashëgueshme. Truri i tyre është më i vogël se i fëmijëve tipik. ADHD-ja nuk kushtëzohet nga ambienti ku fëmija rritet, as nga gjendja ekonomike dhe profesionale apo morale e prindërve³. Disa studiues mendojnë se është një refleks përgjegjës për këtë parahati që ndjejnë fëmijët me ADHD, i cili e tërheq trupin në dy drejtime të ndryshme⁴. Refleksi simetrik tonik i qafës (STNR)⁵ mendohet se nuk është maturuar mjaftueshëm. Mendohet se ky kontigjent përbën rreth 3-5% të fëmijëve 2-6 vjeç, të moshës parashkollore.

Qëllimi i këtij studimi është të trajtojë ndikimin e ADHD-së në mjedisin shkollor dhe të ofrojë strategji për mbështetjen psiko-sociale dhe edukative të këtyre individëve. Në kuadrin e një mjedisi arsimor në ndryshim të shpejtë dhe me një rritje të numrit të rasteve të diagnostikuara me ADHD, është thelbësore që stafi mësimor të jetë i pajisur me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të përballuar sfidat që paraqet ky çrregullim⁶. ADHD nuk është thjesht një problem individual; është një fenomen që lidhet ngushtë me faktorë të ndryshëm shoqërorë, kulturorë dhe organizativë. Prandaj, ndërhyrjet efektive kërkojnë një qasje të gjithanshme që të përfshijë jo vetëm mësuesit dhe nxënësit, por edhe prindërit, specialistët dhe politikëbërësit⁷.

¹ Barkley, R. (1990). Attention deficit/hyperactivity disorder: A handbook for diagnosis and treatment. New York: Guilford Press.

² Barkley, R. (1997). ADHD and the nature of self-control. New Jersey: Guilford.

³ MTA Cooperative Group. (2004). National Institute of Mental Health Multimodal Treatment Study of ADHD Follow-up: 24-Month Outcomes of Treatment Strategies for Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder. *Pediatrics*, 113(4), 754-761

⁴ Olfson, M., Gameroff, M., Marcus, S., & Jensen, P.S. (2003). National trends in the treatment of attention deficit hyperactivity disorder. *American Journal of Psychiatry*, 160(6): 1071-1077.

⁵ Goddard Blythe Sally (2009) 'Attention, Balance and Coordination: the ABC's of learning success. 1st Edition

⁶ Conrad, P. (1976). Identifying hyperactive children: The medicalization of deviant behaviour. Lexington, MA: Lexington Books.

⁷ Cooper, P. (2001). Understanding AD/HD: A brief critical review of the literature. *Children and Society*, 15, 387-395.

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen mësuesit është menaxhimi i sjelljes së nxënësve me ADHD në klasë. Sjellja impulsive dhe mungesa e vëmendjes mund të prishin procesin mësimor dhe të ndikojnë negativisht në mësimin e nxënësve të tjerë. Për të adresuar këto sfida, është e domosdoshme që mësuesit të kenë akses në trajnime të specializuara dhe burime që t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë strategji efektive për menaxhimin e klasës. Trajnimet duhet të përfshijnë teknika për përmirësimin e vëmendjes dhe reduktimin e sjelljeve impulsive, si dhe mënyra për të krijuar një mjedis mësimor mbështetës dhe gjithëpërfshirës⁸.

Një element tjetër thelbësor i mbështetjes për nxënësit me ADHD është zhvillimi i Planeve të Edukimit Individual (PEI). PEI-të janë dokumente të personalizuar që përshkruajnë nevojat e veçanta të nxënësit dhe strategjitë specifike që do të përdoren për të përmbushur këto nevoja. Këto plane janë krijuar në bashkëpunim të ngushtë me prindërit, mësuesit dhe specialistët e tjerë, duke siguruar që çdo aspekt i zhvillimit të nxënësit të merret parasysh. PEI-të mund të përfshijnë përshtatje në kurrikulë, modifikime të mjedisit të klasës, dhe përdorimin e teknologjive ndihmëse⁹.

Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë në klasë, është e rëndësishme që shkollat të krijojnë një kulturë gjithëpërfshirëse që promovon mirëkuptimin dhe pranimin e diversitetit të nevojave të nxënësve. Kjo mund të arrihet përmes trajnimeve të vazhdueshme për gjithë stafin shkollor, programeve të ndërgjegjësimit për prindërit dhe komunitetin, dhe zhvillimit të politikave shkollore që mbështesin një qasje gjithëpërfshirëse ndaj edukimit¹⁰.

ADHD është një çrregullim kompleks që kërkon një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të siguruar që nxënësit të kenë sukses në mjedisin shkollor. Ky studim synon të hedhë dritë mbi metodat dhe strategjitë që mund të ndihmojnë në përmirësimin e edukimit dhe jetës së përditshme të nxënësve me ADHD. Duke u fokusuar në trajnimin e stafit mësimor, zhvillimin e PEI-ve dhe krijimin e një kulture shkollore mbështetëse, mund të arrihet një përmirësim i ndjeshëm në cilësinë e jetës dhe arrijet akademike të këtyre nxënësve.

Materialet dhe metodat

Për të realizuar këtë studim mbi ADHD dhe ndikimin e tij në mjedisin shkollor, janë përdorur një sërë materialesh dhe metodash kërkimore për të mbledhur dhe analizuar të dhënat. Ky seksion përshkruan në detaje qasjen kërkimore, përzgjedhjen e pjesëmarrësve, instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave, dhe metodat e analizës së të dhënave.

⁸ Foy, J., & Earls, M. (2005). A process for developing community consensus regarding the diagnosis and management of Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder. *Pediatrics*, 115: 97–104.

⁹ Udhëzues / Manual praktik për hartimin dhe zbatimin e Planit Edukativ Individual (Pei). 2017. Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Save the Children në partneritet me shoqatën “Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara” (MEDPAK) dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). Manuali është vlerësuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit.

¹⁰ Shrag, P., & Divoky, D. (1975). *The myth of the hyperactive child*. New York: Pantheon. Sonuga-Barke, E. J. (2005). Causal models of attention deficit/hyperactivity disorder: from common simple deficits to multiple developmental pathways. *Biological Psychiatry*, 57, 1231e1238.

Qasja kërkimore

Studimi është realizuar duke përdorur një qasje të përzier kërkimore, që kombinon metodologji cilësore dhe sasiore për të siguruar një kuptim të plotë të çështjeve që lidhen me ADHD në mjedisin shkollor. Kjo qasje lejon mbledhjen e të dhënave të thella përmes intervistave dhe vëzhgimeve, si dhe analizimin e të dhënave statistikore për të nxjerrë përfundime të besueshme.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve

Subjektet pjesëmarrëse në studim janë diagnostikuar me ADHD nga Qendra Rajonale e Autizmit (Fondacioni Fëmijët Shqiptarë), kanë kaluar një vlerësim nga Qendra Kombëtare e Zhvillimit (Kombinat) dhe posedojnë një raport mjeko-ligjor nga KMCAP. Për studim janë përzgjedhur 10 nxënës nga shkolla të ndryshme, për secilin prej të cilëve është krijuar një tabelë me pikat e forta dhe të dobëta. Gjatë analizimit të rasteve janë marrë parasysh zhvillimi i përgjithshëm i fëmijës (zhvillimi motorik, fusha e sjelljes, zhvillimi social, bashkëveprimi, bashkëbisedimi, qëndrimi ndaj moshatarëve, probleme personale, konsiderata për të tjerët, zhvillimi emocional) dhe profili socio-ekonomik (gjendja ekonomike, kushtet e banimit, sistemi mbështetës). Pjesëmarrësit në studim përfshijnë nxënës me ADHD, prindërit e tyre, mësuesit dhe specialistët e shkollës (psikologë dhe mësues të specializuar). Nxënësit janë përzgjedhur nga shkolla të ndryshme të qytetit të Tiranës, duke siguruar një përfaqësim të larmishëm të popullsisë së studiuar. Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve përfshijnë diagnostikimin e konfirmuar të ADHD-së dhe prania e tyre në klasat fillore.

Instrumentet e mbledhjes së të dhënave

1. Intervista të semistrukturuara: janë zhvilluar intervista me mësuesit, prindërit dhe specialistët për të mbledhur informacione të detajuara mbi përvojat dhe qëndrimet e tyre ndaj ADHD-së dhe menaxhimit të saj në klasë. Intervistat kanë përfshirë pyetje mbi sfidat e përditshme, strategjitë e përdorura dhe rezultatet e vërejtura, duke përfshirë shembuj specifikë të mbështetjes akademike në shkrim, matematikë dhe lexim.
2. Vëzhgimet në klasë: janë kryer vëzhgime sistematike në klasat ku ndodhen nxënës me ADHD për të monitoruar sjelljen e tyre dhe ndërveprimet me mësuesit dhe shokët e klasës. Vëzhgimet kanë ndihmuar në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në performancën shkollore dhe sociale të këtyre nxënësve, duke përfshirë vëzhgimin e përmirësimeve në shkrim, matematikë dhe lexim.
3. Anketat: janë përdorur anketa të strukturuara për të mbledhur të dhëna sasiore nga mësuesit dhe prindërit mbi përvojat e tyre me ADHD-në. Anketat kanë

përfshirë pyetje mbi strategjitë e menaxhimit të sjelljes, efektivitetin e PEI-ve dhe mbështetjen e ofruar nga shkolla, duke përfshirë edhe mbështetjen akademike në shkrim, matematikë dhe lexim.

4. Dokumentet shkollore: janë analizuar dokumentet shkollore, përfshirë PEI-të, raportet e vlerësimeve dhe planifikimet e mësimdhënies për të kuptuar qasjen e shkollës ndaj nxënësve me ADHD dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra. Këto analiza përfshijnë shqyrtimin e mbështetjes akademike në shkrim, matematikë dhe lexim.

Metodat e analizës së të dhënave

1. Analiza cilësore: të dhënat e mbledhura nga intervistat dhe vëzhgimet janë analizuar duke përdorur metodat e analizës tematike. Kjo qasje lejon identifikimin dhe ekzaminimin e modeleve dhe temave kryesore që shfaqen në të dhënat cilësore.
2. Analiza sasiore: të dhënat e anketave janë analizuar duke përdorur teknika statistikore për të vlerësuar marrëdhëniet dhe ndryshimet midis variablove të ndryshëm. Janë përdorur testet statistikore për të nxjerrë përfundime mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe strategjive të menaxhimit të sjelljes.
3. Analiza e dokumenteve: dokumentet shkollore janë analizuar për të vlerësuar përputhshmërinë me praktikat më të mira dhe standardet e rekomanduara për menaxhimin e ADHD-së në mjedisin shkollor.

Strategjitë për të arritur objektivat e paracaktuara

Teknika 1- Përforsimi pozitiv. *Përshkrimi:* Dhënia e shpërblimeve apo privilegjeve të tjera si përgjigje ndaj kryerjes së një sjellje të dëshiruar. *Shembull:* Fëmija përmbush një detyrë të përcaktuar nga mësuesi apo prindi dhe lejohet të luajë në kompjuter.

Teknika 2 - Time out. *Përshkrimi:* Të ndalosh apo të mos lejosh fëmijën të kryejë aktivitetin e preferuar, si rezultat i faktit se sjellja e tij është e padëshirueshme. *Shembull:* Fëmija godet vëllain dhe si rezultat ai ndëshkohet, duke mos e lejuar të shikojë televizor gjatë gjithë ditës.

Teknika 3 - Kostoja e përgjigjes. *Përshkrimi:* Tërheqja e shpërblimeve dhe privilegjeve si rezultat i kryerjes së një sjellje të padëshiruar. *Shembull:* Fëmija nuk do dalë përjashta për të luajtur me shokët, nëse nuk përfundon detyrat e shtëpisë.

Teknika 4 - Token economy. *Përshkrimi:* Është një sistem ekonomizimi për shpërblimet dhe ndëshkimet. Konsiston në dhënie të disa xhetonave për çdo sjellje të dëshiruar, që më pas konvertohen në shpërblime konkrete. *Shembull:* Fëmija fiton yje kur qëndron ulur në karrige gjatë ngrënies dhe i humbet ato kur largohet nga karrigia. Nëse fëmija ka mbledhur 10 yje, ai do të shkojë tek këndi i lojërave.

Rezultatet dhe diskutimet

Të dhënat e mbledhura nga anketat dhe vëzhgimet në klasë treguan një përmirësim të ndjeshëm në performancën akademike dhe sjelljen e nxënësve me ADHD që ishin pjesë e Planeve të Edukimit Individual (PEI). Nxënësit që përfituan nga këto plane të personalizuara treguan një rritje të ndjeshme në notat e tyre, si dhe një reduktim të sjelljeve impulsive dhe pavëmendjes gjatë orëve të mësimit. Këto rezultate janë mbështetur nga vëzhgimet e mësuesve, të cilët raportuan përmirësime të dukshme në përqendrimin dhe përfshirjen e nxënësve në aktivitetet mësimore. Intervistat dhe anketat e kryera me mësuesit treguan se trajnimet e specializuara kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në aftësitë e tyre për të menaxhuar klasat me nxënës me ADHD. Mësuesit që morën pjesë në këto trajnime raportuan një përmirësim të ndjeshëm në njohuritë dhe aftësitë e tyre për të përdorur teknika të ndryshme për menaxhimin e sjelljes dhe përmirësimin e vëmendjes së nxënësve. Trajnimet përfshinin strategji të tilla si përdorimi i shpërblimeve, ndarja e detyrave në pjesë më të vogla dhe përdorimi i ndihmës vizuale për të mbajtur nxënësit të përqendruar.

Një tjetër rezultat i rëndësishëm i këtij studimi ishte rëndësia e përfshirjes dhe mbështetjes së prindërve në procesin edukativ të fëmijëve me ADHD. Intervistat me prindërit treguan se ata që ishin të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e PEI-ve të fëmijëve të tyre kishin një kuptim më të mirë të nevojave të fëmijës dhe ishin më të aftë për të ofruar mbështetje në shtëpi. Prindërit gjithashtu raportuan një përmirësim të marrëdhënieve të tyre me mësuesit dhe një rritje të besimit në aftësitë e shkollës për të menaxhuar ADHD-në.

Analiza e dokumenteve shkollore, përfshirë PEI-të dhe raportet e vlerësimeve, tregoi se shkollat që zbatojnë praktika të strukturuar dhe të personalizuara për nxënësit me ADHD kanë një qasje më efektive ndaj menaxhimit të këtij çrregullimi. PEI-të që përfshinin objektiva të qarta dhe strategji specifike për mbështetjen e nxënësve ishin më të suksesshme në përmirësimin e rezultateve akademike dhe sjelljes së nxënësve.

Pas hartimit të personalizuar të PEI, ndryshimet konkrete që vërehen përfshijnë përmirësime të dukshme si në fushën sociale, ashtu edhe në atë shkollore. Përpara hartimit të PEI, nxënësit preferonin të uleshin në bankën e fundit larg fëmijëve, kishin vështirësi në zbatimin e rregullores së klasës dhe nuk merrnin pjesë në aktivitete të përbashkëta. Në aspektin akademik, ata përballeshin me vështirësi në shkrim dhe lexim, kryerjen e veprimeve matematikore dhe përqendrimin në realizimin e detyrave. Pas hartimit të PEI, nxënësit filluan të ulen në bankën e parë me shokët e tyre, të respektojnë rregulloren e shkollës dhe të marrin pjesë aktive në aktivitetet festive, edukative dhe argëtuese të organizuara në klasë dhe në shkollë. Në aspektin akademik, ata shkruajnë dhe lexojnë në përputhje me PEI-in, kryejnë veprime matematikore sipas objektivave të përcaktuara dhe realizojnë detyrat në grup, duke treguar një nivel më të lartë përqendrimi dhe përgjegjësie.

Përfundime

Ndikimi i PEI-ve në performancën e nxënësve: Rezultatet e këtij studimi konfirmojnë rëndësinë e PEI-ve në përmirësimin e performancës akademike dhe të sjelljes së nxënësve me ADHD. Personalizimi i qasjeve edukative në bazë të nevojave specifike të çdo nxënësi është thelbësor për të arritur rezultate pozitive. Kjo gjetje është në përputhje me literaturën ekzistuese që sugjeron se ndërhyrjet e personalizuara janë më efektive se qasjet e përgjithshme.

Trajnimet për mësuesit: Ndikimi pozitiv i trajnimeve për mësuesit tregon se investimi në zhvillimin profesional të stafit edukativ është një komponent kyç për menaxhimin e suksesshëm të ADHD-së në shkollë. Trajnimet duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përfshijnë përditësime mbi praktikat më të mira dhe hulumtimet e reja në këtë fushë. Për më tepër, është e rëndësishme që shkollat të krijojnë një kulturë mbështetëse ku mësuesit të ndihen të fuqizuar për të eksperimentuar me strategji të reja dhe të ndajnë përvojat e tyre.

Roli i prindërve: Përfshirja e prindërve është e domosdoshme për suksesin e ndërhyrjeve edukative për fëmijët me ADHD. Studimi tregon se bashkëpunimi i ngushtë midis shkollës dhe familjes përmirëson ndjeshëm rezultatet për nxënësit. Prindërit që janë aktivisht të përfshirë në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre kanë më shumë gjasa të krijojnë një mjedis mbështetës dhe strukturor në shtëpi, që është i nevojshëm për suksesin e fëmijës.

Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse: Përveç strategjive specifike të ndërhyrjes, krijimi i një kulture shkollore gjithëpërfshirëse që promovon mirëkuptimin dhe pranimin e diversitetit të nevojave të nxënësve është thelbësor. Shkollat që arrijnë të ndërtojnë një mjedis mbështetës dhe të gjithëpërfshirës kanë më shumë gjasa të kenë sukses në menaxhimin e ADHD-së dhe përmirësimin e rezultateve akademike dhe sociale të nxënësve.

Kufizimet dhe rekomandimet për kërkime të ardhshme: Një kufizim i këtij studimi është se ai është kryer në një qytet të vetëm dhe mund të mos jetë përfaqësues për të gjitha shkollat. Kërkimet e ardhshme duhet të përfshijnë kampione më të mëdha dhe të diversifikuara për të përcaktuar më mirë rezultatet. Gjithashtu, studimet afatgjata mund të ofrojnë një kuptim më të mirë të ndikimit afatgjatë të PEI-ve dhe trajtimeve të tjera të ADHD-së.

BIBLIOGRAFIA

- Angold, A., Erkanli, A., Egger, H., & Costello, J. (2000). *Stimulant treatment for children: A community perspective*, në *Journal of Child and Adolescent Psychiatry*, 39(8): 975–984.
- Barkley, R. (1990). *Attention deficit/hyperactivity disorder: A handbook for diagnosis and treatment*, New York: Guilford Press.
- Barkley, R. (1997). *ADHD and the nature of self-control*, New Jersey: Guilford.
- Barkley, R. A. (1988). *The effects of methylphenidate on the interactions of preschool ADHD children with their mothers*, në *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 27(3), 336–341.
- Barkley, R. A. (1997). *ADHD and the nature of self-control*, New York: Guilford Publications.
- Bauermeister, J., Canino, G., Bravo, M., Ramirez, R., Jensen, P.S., Chavez, L. (2003). *Stimulant and psychosocial treatment of ADHD in Latino/Hispanic children*, në *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 42(7): 851–855.
- Bell Barnett, K. (2012). *Dosed: The Medication Generation Grows Up*, Boston: Beacon Press.
- Blew, H. & Kenny, G. (2006). *Attention Deficit Hyperactivity Disorder: The current debate and neglected dimensions*, në *Journal of Child Healthcare*, 10(3): 251–263.
- Centers for Disease Control and Prevention (CDC) Report. (2002). *Attention deficit disorder and learning disability*, United States, 1997–98. Vital and health statistics, Series 10, No. 206, www.cdc.gov/nchs.
- Conrad, P. (1975). *The discovery of hyperkinesis: Notes on the medicalization of deviant behavior*. *Social Problems*, 23: 12–21.
- Conrad, P. (1976). *Identifying hyperactive children: The medicalization of deviant behaviour*, Lexington, MA: Lexington Books.
- Cooper, P. (2001). *Understanding AD/HD: A brief critical review of the literature*. *Children and Society*, 15, 387–395.
- Elliott, C. (1993). *The tyranny of happiness: ethics and cosmetic psychopharmacology*, në E. Parens, E. (Ed.). (1998). *Enhancing human traits: ethical and social implications*, Washington, DC: Georgetown University Press.
- Foy, J., & Earls, M. (2005). *A process for developing community consensus regarding the diagnosis and management of Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder*. *Pediatrics*, 115: 97–104.
- Fuemmeler, B. F., Østbye, T., Yang, C., McClernon, F. J., & Kollins, S. H. (2010). *Association between attention-deficit/hyperactivity disorder symptoms and obesity and hypertension in early adulthood: a population-based study*, në *International Journal of Obesity*, doi:10.1038/ijo.2010.214. 26 Oct.
- Goddard Blythe Sally (2009) *Attention, Balance and Coordination: the ABC's of learning success*, 1st Edition.
- Molina B., Hinshaw S., Swanson J., Arnold, L., Vitiello, B., Jensen, P., Epstein, J., Hoza, B., Hechtman, L., Abikoff, H., Elliott, G., Greenhill, L., Newcorn, J., Wells, K., Wigal, T., Severe, J.,

- Gibbons, R., Hur, K., Houck, P., & The MTA Cooperative Group. (2009). *The MTA at 8 years: prospective follow-up of children treated for combined type ADHD in a multisite study*, në *Journal of the American Academy of child and Adolescent Psychiatry*, 48, 484-500.
- MTA Cooperative Group. (2004). *National Institute of Mental Health Multimodal Treatment Study of ADHD Follow-up: 24-Month Outcomes of Treatment Strategies for Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder*. *Pediatrics*, 113(4), 754-761.
- Olfson, M., Gameroff, M., Marcus, S., & Jensen, P.S. (2003). *National trends in the treatment of Attention Deficit Hyperactivity Disorder*, në *American Journal of Psychiatry*, 160(6): 1071-1077.
- Polanczyk, G., De Lima, M. S., Horta, B. L., Biederman, J., & Rohde, L. A. (2007). *The worldwide prevalence of ADHD: a systematic review and metaregression analysis*, në *The American Journal of Psychiatry*, 164, 942-948.
- Rowland, A., Lesesne, C., & Abramowitz, A. (2002). *The epidemiology of Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder (ADHD): A public health view*. *Mental Retardation and Developmental Disabilities Research Reviews*, 8: 162-170.
- Shrag, P., & Divoky, D. (1975). *The myth of the hyperactive child*. New York: Pantheon.
- Sonuga-Barke, E. J. (2005). *Causal models of attention deficit/hyperactivity disorder: from common simple deficits to multiple developmental pathways*. *Biological Psychiatry*, 57, 1231e1238.
- Udhëzues / Manual praktik për hartimin dhe zbatimin e Planit Edukativ Individual (Pei). 2017. Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Save the Children në partneritet me shoqatën “Mbrotjtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara” (MEDPAK) dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). Manuali është vlerësuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit.
- Vasconcelos MM, Werner J JR, & Malheiros AF. (2009). *Attention deficit hyperactivity disorder prevalence in an inner city elementary school* në *Arq Neuropsiquiatr* 61:67-73.

TEZAT FEMINISTE DHE SOCIALISTE NË ROMANIN *JUDE THE OBSCURE*¹: TRAKTAT POLITIK APO THIRRJE PËR HUMANIZËM?!

MSc Enkelejda MALAJ

Departamenti i Gjuhës Angleze

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: enkelejda_malaj.doktorantfjgh@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Jude the Obscure (1896) është romani i fundit që shkroi Thomas Hardy. Modern dhe i pazakontë, ai ishte një roman i destinuar të shkëputej nga konvencionet letrare dhe shoqërore të deriatëhershme dhe të konsiderohej si traktati më i guximshëm dhe më i vërtetë i Hardy-it kundër padrejtësive të ngurtësuara shoqërore dhe institucionale. Njëherazi natyralist dhe realist, utopik dhe humanist, ky roman vazhdon të tërheqë vëmendjen e lexuesve dhe studiuesve, edhe për shkak të kuptimeve dhe interpretimeve në disa nivele të tekstit dhe nëntekstit. Historitë e zymta dhe fatkeqe të jetës dhe dashurisë së Jude Fawley-it dhe Sue Bridehead-it janë njëherësh edhe protesta e autorit kundër zhgënjimit të përjetshëm, që e shoqëron rrugëtimin e njeriut për përparim shoqëror, akademik dhe shpirtëror në një botë që pengon thelbësisht e thekshëm shpresat e të rinjve, e veçanërisht të klasave të paprivileguara. Ky punim do të shqyrtojë disa nga tezat kryesore feministe dhe socialiste të këtij romani, si një përpjekje për të kuptuar se si lëvizjet bashkëkohore feministe dhe socialiste, por edhe përvojat personale, ndikuan botëkuptimin e Thomas Hardy-it për kohën dhe botën, edhe pse ai kurrë nuk e mbështeti publikisht as feminizmin dhe as socializmin, duke ruajtur përkushtimin e tij ndaj natyralizmit, prej një këndvështrimi thellësisht humanist. Fjalët kyçe: *Thomas Hardy, Jude the Obscure, feminizmi, socializmi, humanizmi.*

ABSTRACT

"*Jude the Obscure*" (1896) is Thomas Hardy's last novel. Modern and unconventional, it was destined to come through as Hardy's most courageous and true-to-himself treatise against long petrified social injustice. Jude Fawley's and Sue Bridehead's grim life and love records decry the eternal disillusionment of human quest for social, academic and spiritual accomplishment in a world intrinsically thwarting to young hopes, particularly, of underprivileged classes. Simultaneously naturalistic and realistic, humanistic and utopic, Hardy's last novel continues to appeal to readers and scholars due to its multiple layers of meaning and interpretation. This paper will look into some of its main feminist and socialistic themes in an attempt to understand how contemporary feminist and socialistic movements, as well as personal experiences, influenced Hardy's view of his time and the world, even though he never publicly supported either feminism or socialism, while retaining his commitment to naturalism, from a deeply humanist perspective.

Keywords: *Thomas Hardy, Jude the Obscure, feminism, socialism, humanism.*

¹ Një version më i hershëm i këtij artikulli është prezantuar në Konferencën e 13-të Ndërkombëtare të Departamentit të Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë: *Kërkimi Shkencor dhe Qasjet e Reja në Gjuhësi, Mësimdhënie, Përkthim dhe Kulturë*, më 24 Nëntor 2023, me titull: *Socialist themes in Thomas Hardy's Jude the Obscure.*

Diskutimet mbi natyrën e historisë dhe letërsisë, mbi ndikimet e ndërsjella mes tyre apo edhe ato mes shkrimtarit dhe kohës, në të cilën shkrimtari krijon veprën e tij, janë sa të vjetra, aq edhe të gjithkohëshme, qofshin ato të natyrës filozofike, politike apo letrare. Por nëse e pranojmë si të pamohueshëm ndikimin e kohës në formësimin e shkrimtarit si individ dhe qenie që mendon, është po aq e pashmangshme nevoja për të konsideruar konfliktin dhe luftërat brenda individit, e gjitha edhe qëndrimin rebelues të individit, e aq më shumë të shkrimtarit, ndaj kohës dhe shoqërisë. Pavarësisht të qenit produkt i kohës dhe mjedisit, a mund të vërejmë, megjithatë, se shkrimtari i vërtetë ruan brenda kohës dhe mjedisit, ku jeton e shkruan, thelbin e individualitetit të tij, të cilin e derdh në vepër me subjektivizmin e logjikshëm intelektual dhe krijues?!²

Në këtë punim do të përiqemi të analizojmë disa nga tezat feministe dhe socialiste, që vërehen në romanin e fundit të shkruar nga shkrimtari i mirënjohur anglez Thomas Hardy *Jude the Obscure*², duke u nisur pikërisht nga ky këndvështrim, në përpjekje për të kuptuar, përmes studimit të personazheve dhe të dhënave biografike të autorit, nëse ky roman ishte vërtet një traktat radikal politik, apo thjesht një roman mbi lidhjet romantike të dy personazheve kryesore dhe sfidave të historisë së tyre të dashurisë në kontekstin e Anglisë viktoriane. Gjithashtu, punimi do të argumentojë se edhe pse idetë bashkëkohore feministe dhe socialiste e përshkojnë këtë roman fund e krye, qëllimi përfundimtar i Hardy-it nuk ishte të mbështeste asnjërën prej këtyre ideologjive, sepse faktet biografike dhe pohimet origjinale të autorit konfirmojnë përkushtimin e palëkundur të një shkrimtari natyralist, i cili, mbi baza thellësisht humaniste, u përpoq të demonstronte konfliktin e përjetshëm midis jetës njerëzore dhe forcave natyrore e shoqërore, të cilat mbeten gjithherë të gatshme për të krasitur në syth shpresat e reja dhe për të rrënuar shpirtin e njomësht njerëzor.

Juda i Paemër u botua në Angli në vitin 1896, duke bërë jehonë të madhe në shoqërinë puritane viktoriane të shekullit të 19-të, pasi u interpretua si një traktat radikal politik kundër një sistemi konservator, institucioneve të ngurtësuara, rendit klasor dhe privilegjeve të trashëguara klasore, kishës dhe institucionit të martesës. Shumë prej mesazheve të këtij romani përkonin me ide të debatueshme socialiste dhe feministe, duke shkaktuar një shkundullimë të zhurmshme në shtypin dhe publikun e asaj kohe. Në parathënieën e botimit të parë të romanit, Hardy do të paralajmëronte lexuesit se *Juda i Paemër* ishte ‘një roman i shkruar nga një burrë për burrat dhe gratë e rritura, një përpjekje për të përshkruar, pa i përthypur fjalët, një luftë vdekjeprurëse që zhvillohet mes trupit dhe shpirtit, dhe për të rrëfyer tragjedinë e synimeve të paplotësuara’³. Mbështetur në një qasje thellësisht filozofike, duke na sjellë ndërmend teorinë e filozofit të shquar skocez David Hume (1711-1776), ai na fton të sodisim qëndrueshmërinë dhe papajtueshmërinë e përshtypjeve dhe pyetjeve personale, përhershëmërinë dhe përkohshmërinë e tyre (Hardy,

² Shënim i autorit: *Jude the Obscure* mund të përkthehet në shqip si *Juda i Panjohur*, *Juda i Paemër*, apo edhe *Juda i Zymtë*. Në këtë artikull do të përdorim versionin *Juda i Paemër*; si versioni që përmbledh më së miri thelbin e ambicieve të dështuara të protagonistit të romanit për të bërë emër dhe lënë gjurmën e tij në shoqërinë së cilës i përket.

³ Shënim i autorit: Ky citim dhe të gjitha citimet pasuese në këtë artikull janë përkthime të autorit nga origjinali (Anglisht) në Shqip.

1895). Më shumë se një dhjetëvjeçar e gjysmë pas botimit të parë të *Judës së Paemër*, në poshtëshënimin e vitit 1912, Thomas Hardy do të shkruante për ‘një fillim të palumtur’, duke numëruar një sërë incidentesh që pasuan botimin e tij, që nga fatkeqësia e djegies së romanit nga një peshkop, ‘në pamundësi për ta djegur vetë autorin e tij’ apo ‘akuzat për përdhosjen e institucionit të martesës’. Po aty, Hardy pohon se ‘sulmi i furishëm ndaj *Judës*’ u ndez nga shtypi, i cili ushqeu dhe nxiti ‘një spektakël qesharak’, ndërsa publiku britanik u përfshi në ‘një nga ato valët e tij periodike të moralshmërisë’. (Hardy, 1930, fq. 39). ‘I shkishëruar nga shtypi’ (Hardy, 1930, fq. 46) dhe i shpërfillur nga shumë miq e të njohur, për shkak të skandalit letrar që shkaktoi *Juda i Paemër*, Hardy, megjithatë, këmbëngul se ‘e keqja për të cilën u ankuan këto mendje të sjellshme me mendime të mbrapshta, është një e keqe që jeton në mendjen e tyre dhe nuk është ajo çka ka shkruar autori’ (Hardy, 1930, fq. 39) dhe se ‘pa dyshim, në një libër mund të zbulosh më shumë nga sa autori ka vendosur me vetëdije, gjë që ose e ndihmon autorin ose e dëmton atë’ (Hardy, 1912).

Po ashtu, në një nga letrat e tij të shumta drejtuar Florence Henniker-it, një mikeshë e autorit, Hardy këmbëngul se ‘ky nuk është një roman me një qëllim në vetvete dhe as një manifest kundër martesës, por vetëm një histori e thjeshtë e dy njerëzve të papërshtatshëm për martesë’ (Tomalin, 2012, fq. 256). Duke marrë parasysh këto pohime të drejtpërdrejta të autorit, është e natyrshme që t’i besojmë ato, me hamendësimin se autori nuk ka përse të fshehë qëllimet e tij politike, nëse ka të tilla, sa kohë që ky mund të ketë qenë vetë qëllimi i romanit. Fakti që Hardy rreket ta paraqesë këtë roman si një histori të thjeshtë dashurie, pa një prapavijë politike apo ideologjike, nga njëra anë, dhe faktit që pas botimit të *Judës* dhe zhurmës së shkaktuar, ai vendosi të mos shkruante më kurrë romane, lë hapësirë për dyshime, spekulime dhe interpretime ballafaquese mes këtyre fakteve dhe mesazheve që gjejmë në roman. Ajo që mund të hamendësojmë paraprakisht si versionin më afër së vërtetës është që reagimi i publikut ndaj *Judës së Paemër* ‘e shëroi autorin nga çdo ambicie tjetër’ për të shkruar romane (Hardy, 1912), qoftë për shkak të skandalit që pasoi, qoftë edhe për faktin se ai i kishte shprehur tashmë gjerësisht pikëpamjet e tij, nisur që me romanin *Tesi i d’Erbervilëve* (1891) dhe për të vijuar në mënyrë shumë më të qartë e të hapur në romanin pasues, *Juda i Paemër*. Mjaft studiues kanë argumentuar të kundërtën, pra që *Juda i Paemër* ishte romani i fundit i Hardy-it, jo si pasojë e reagimit të publikut në Angli, por sepse vetë Hardy e kishte menduar këtë roman si veprën finale për të shprehur gjithë pakënaqësinë e tij ndaj së vjetrës dhe konvencionale, duke bërë thirrje për reformim institucional, fetar, social dhe akademik (Flynn, 2016). Edhe nëse e pranojmë se pohimet e Hardy-it për lexuesit dhe miqtë e tij ishin të sinqerta dhe të vërteta, dhe se Hardy e kishte menduar këtë veprë thjesht si një roman për martesën, divorcin dhe synimet e paplotësuara në jetë, prapëseprapë, tezat feministe dhe socialiste, që përshtojnë romanin janë aq të dukshme te të dy protagonistët, Jude Fawley dhe Sue Bridehead⁴, sa që mbetet vërtet e diskutueshme nëse ai synonte t’i mbështeste këto ideologji, të bënte thirrje për një shkundje nga themelet të një shoqërie që i bënte qëndresë ndryshimit dhe

⁴ Shënimi i autorit: Në vijim emrat e personazheve kryesorë Jude Fawley dhe Sue Bridehead do të përdoren si Judë Foli dhe Sju Braid’hed.

përparimit apo thjesht të rrëfente një histori dashurie tragjike mes dy idealistëve naivë në një botë të ndërlikuar dhe vrastare.

Sju Braid'hed - një grua e re e iluminuar, por e dorëzuar...

Juda i Paemër është një roman për Judë Folin, një djalosh i varfër dhe ambicioz, i dhënë pas leximeve klasike dhe i vendosur për të qenë i suksesshëm, pavarësisht sistemit klasor në Anglinë viktoriane. E megjithatë, shumë shpejt lexuesi njihet me një vajzë të re, të këndshme dhe plot jetë, Sju Braid'hed, e cila, siç kanë vërejtur disa kritikë, ia rrëmben romanin Judës së varfër, duke marrë gjithë vëmendjen e lexuesit (Blake, 1978). Në shumë pikëpamje, Sju Braid'hed shfaqet në roman si Gruaja e Re, e frymëzuar dhe fuqizuar nga idetë revolucionarizuese të Mary Wollstonecraft-it (1759-1797), por teksa ngjarjet rrjedhin dhe historia përparon drejt fundit tragjik, një pyetje thelbësore ngre krye përgjatë gjithë romanit: A është Sju Braid'hed vërtet një feministe?

Traktati i famshëm politik i Mary Wollstonecraft-it *Në Mbrojtje të të Drejtave të Gruas* (*A Vindication of the Rights of Woman*), i frymëzuar nga idetë përparimtare të Revolucionit Francez, kishte hapur rrugën për shumë shkrimtare proto-feministe, mendimtare feministe utopike dhe socialiste, që nga koha e botimit të tij në vitin 1792 (Ferguson, 1999). Shumë gra shkrimtare, që nga Jane Austen (1755-1817), Charlotte Brontë (1816-1855) dhe Anne Brontë (1820-1849), tek Elisabeth Gaskell (1810-1865) dhe George Eliot (1819-1880), të gjitha kishin portretizuar në romanet e tyre protagoniste femra, si: Elizabeth Bennet tek *Krenari dhe Paragjykim* (*Pride and Prejudice*, 1813), Jane Eyre tek *Jane Eyre* (*Jane Eyre*, 1847), Helen Huntingdon tek *Qiramarrësi i Wildfell Hall-it* (*The Tenant of Wildfell Hall*, 1848), Molly Gibson tek *Grua dhe vajza* (*Wives and Daughters*, 1866), Margaret Heil tek Veriu dhe Jugu (North and South, 1855) dhe Dorothea Brooke tek *Middlemarch* (*Middlemarch*, 1872), të cilat nuk ishin vetëm vajza të bindura, nëna dhe gra shembullore, por qenie intelektuale dhe racionale, të afta dhe të gatshme për të kapërcyer kufijtë e imponuar nga shoqëria, e cila, asokohe, i caktonte rol dhe zë publik vetëm meshkujve të pasur. Madje, edhe Elfride Swancourt e Hardy-it në romanin *Një Palë Sy të Kaltër* (*A Pair of Blue Eyes*, 1873) ose Bathsheba Everdeen tek *Larg Turmës së Çmendur* (*Far from the Madding Crowd*, 1874) janë të ngjashme me shumë nga personazhet e mësipërme të autoreve femra, por Sju Braid'hed, personazhi më feminist i Hardy-it, mund të themi se është një tjetër lloj gruaje e kësaj klase të re femërore.

Është fakt i ditur që Hardy ishte i njohur me idetë përparimtare të Mary Wollstonecraft-it, sepse bashkëshortja e tij, Emma Gifford, ishte një mbështetëse aktive e lëvizjes së të drejtës së votës për gratë (Tomalin, 2012, fq. 273 - 290). E megjithatë, Hardy nuk shfaqi kurrë ndonjë angazhim publik ndaj feminizmit apo ndonjë kauze tjetër politike, pasi vetë ai kishte pohuar se “...gjithmonë kam ndjerë detyrimin për të qëndruar larg çdo pjesëmarrje në politikën aktive, për shkak të neutralitetit të punës time” dhe i vendosur “...t’u qasem të gjitha hullive të mendimtarëve nga një pozicion absolutisht i paangazhuar” (Flynn, 2016, fq. 56-65), “... nga pozicioni i njerëzve, jo i mjeteve politike” (Tomalin, 2012, fq. 419). Tomalin, një ndër biografet më të njohura të jetës së Thomas Hardy-it, na pohon se “asnjë fjalë nuk doli nga goja e Hardy-it kur kauza e Emës triumfoi në vitin 1918, kur gratë fituan të drejtën e votës” (2012, fq. 362). Mbështetur në këto pohime, mund të

tundohemi për të arritur në përfundimin se mbase heshtja e Hardy-it në lidhje me lëvizjen feministe ndjek të njëjtën linjë të qëndrimeve të tij të rezervuara ndaj të gjitha lëvizjeve dhe çështjeve politike të kohës së tij (Tomalin, 2012, fq. 290), por nga ana tjetër nuk mund të mos mendojmë se ndoshta, ai nuk i mbështeste plotësisht pikëpamjet e tyre? Dhe për këtë, është e rëndësishme të analizojmë figurën e Sju Braid'hed-it, pohimet e saj kurajoze, idealizmin, por edhe procesin dialektik të formësimit dhe ndryshimeve karakteriale dhe botëkuptimore të saj përgjatë zhvillimit të romanit.

Tek *Juda i Paemër*, Sju i thotë Judës: '*Jeta ime është formësuar tërësisht nga ajo që njerëzit e quajnë një veçanti* tek unë (fq. 177). Veçantia e parë befasuese e Sju Braid'hed-it ka të bëjë me faktin se në mënyrë krejt të qartë, lexuesi vëren, që në fillim të romanit, një shpirt të lirë dhe të dëlirë, të etur për dije e pasurim intelektual e shpirtëror. Prirja për të përqafuar çdo aventurë që intensifikon ndjenjën e saj të lirisë, si p.sh. shëtitjet me libra në duar, krejt e pashoqëruar, shëtitjet e gjata në fshat vetëm me Judën (fq. 163), bashkëjetesa për plot 15 muaj në të njëjtën shtëpi me mikun e saj student në universitet (fq. 177), jetesa më vete në Londër apo punësimi në një dyqan artistësh (fq. 178) nxjerrin në pah vendosmërinë e saj kurajoze për pavarësi në jetë (fq. 123, 158, 172). Nga diskutimet e shumta intelektuale me Judën, shumë shpejt kuptojmë se ajo ka lexuar më shumë libra se ai, edhe pse Juda është një lexues i zellshëm. Në një kohë kur edukimi ishte një e drejtë që u rezervohet vetëm meshkujve, ajo shpalos njohuri për një sërë autorësh klasikë grekë, romakë, francezë dhe italianë, njësoj si burrat asokohe, duke përfshirë madje edhe vepra të diskutueshme të autorëve 'të çuditshëm', si Catullus, Giovanni Boccaccio ose Henry Fielding (fq. 177). Ajo rrëfen se nuk ka frikë nga burrat dhe librat e tyre, ndërsa Juda vëren se ajo nuk flet aspak si një vajzë (fq. 176), madje e quan edhe volteriane, për shkak të ideve blasfemuese ndaj kishës dhe Biblës që e konsideron vetëm si një këngë madhështore dhe pasionante (fq. 182). Ajo është një Shën Thoma (fq. 127), skeptike dhe racionale në përparimin e saj intelektual dhe shpirtëror (fq. 176). Juda e sheh Sjunë si një bashkëbiseduese absolutisht të barabartë në kuvendimet e tyre teologjike dhe filozofike (fq. 184), madje e adhuron deri në blasfemi, duke qenë se e sublimon si hyjnore (fq. 174). Në të gjitha këto pohime dhe përshkrime, mund të themi se Thomas Hardy ka portretizuar një grua që mishëron idetë feministe të Mary Wollstonecraft-it se racionaliteti është njëlloj i pranishëm si tek burrat dhe gratë.

Veçantia e dytë e Sju Braid'hed -it gjendet në qëndrimin e saj të pazakontë ndaj burrave, seksit dhe martesës. Shpirti i saj i pavarur është një pasqyrim i mungesës së kompleksit në lidhje me çdo gjë mashkullore, i sjelljes së pazakontë dhe një pavetëdije të çuditshme për gjininë dhe sharmin femëror (fq. 179). Autori na thotë se në fëmijërinë e saj ajo kish qenë si çun (fq. 134), e si zonjushë nuk shqetësohej aspak nëse i duhej të vishte rrobat e Judës, duke i quajtur rrobat femërore thjesht si '*pëlhura pa gjini*' (fq. 173). Ajo nuk e lakmon gjininë mashkullore, por vetëm mundësitë që u janë dhënë burrave në jetë dhe i mohohen gjinisë së saj (fq. 392). Shpërfillja e pazakontë ndaj tensionit seksual ndërmjet gjinive, bëhet edhe më e çuditshme kur ajo i rrëfen Judës se nuk i është dorëzuar kurrë asnjë mashkulli, edhe pse ka jetuar nën të njëjtën çati me mikun e saj student në Londër (fq. 177-178), me të cilën ka ndarë vetëm librat dhe bisedat intelektuale, çka Hardy e quan '*ndarja e dhomës së ndenjes*'. I çuditshëm është edhe fakti se ajo nuk shfaq

asnjë drojë ndaj burrave, ‘*duke u përzier me ta sikur të ishte një prej tyre, duke mos u ndjerë në praninë e tyre, ashtu siç u mësohet grave të ndihen ndaj burrave*’ (fq. 177). Sju shpreh një respekt të rrallë për ndjenjat dhe trupin e vet, kur edhe pse e lidhur ligjërisht me bashkëshortin e saj, Phillotson-in, intimiteti me të i duket si tradhti bashkëshortore. Edhe më e çuditshme, e madje moderne, është kërkesa ndaj Phillotson-it që ta lejonte të largohej për të jetuar me një burrë tjetër (fq. 256). Ajo shpreh dyshime ndaj vlerës së ligjeve dhe urdhëresave, kur ato shkaktojnë njerimin dhe palumturinë e individit. Sju e denoncon konvencionin e martesës, duke e quajtur një kontratë të neveritshme, të mbështetur në lehtësira materiale, në traditën e trashëgimit të tokës, pronës dhe fëmijëve, madje shprehet se edhe vetë ceremonia fetare e lidhjes me martesë është e gabuar, nëse bashkimi i dy njerëzve mbështetet vetëm në sa më sipër (fq. 230). Kështu, vërejmë se idetë e saj për martesën janë radikale; ato kundërshtojnë vlefshmërinë dhe qëndrueshmërinë e zotimeve martesore, të cilat Sju i quan po aq qesharake, sa një zotim për të pëlqyer përjetësisht një ushqim apo një pije të caktuar (fq. 266). Sju u jep zë mendimeve vërtet përparimtare për kohën, të tilla si: ‘*Zhvillimi njerëzor në larminë e tij më të pasur është për mendimin tim shumë më i rëndësishëm se respektueshmëria*’⁵ (fq. 268) apo koncepti që një kontratë morale midis dy individëve qëndron më lart se çdo kontratë ligjore ose fetare (fq. 266), përmes të cilave ajo rezonon nocione filozofike dhe moderne mbi të drejtat e njeriut, marrëdhëniet njerëzore dhe martesën, si dhe vetë prirjet e Hardy-it drejt këtyre ideve humaniste, të cilat e vendosin njeriun dhe potencialin njerëzor mbi çdo konvencion shoqëror apo institucion ligjor.

Por teksa Sju i përngjet një mishërimi tipik letrar të ideve feministe të kohës dhe, mbase, mund të konsiderohet si personazhi më unik feminist në letërsinë angleze deri në vitin 1895, ajo është larg të qenit një feministe tipike. Në një letërkëmbim me një mike në vitin 1895, Hardy konfirmon se ‘*Sju është një lloj gruaje, që më ka tërhequr gjithmonë, por vështirësia e portretizimit të këtij tipi më ka penguar që të provoj ta shkruaj më parë*’ (Hardy, 1930, fq. 41-42). Jo gruaja, shkruan Hardy, por një lloj gruaje, duke hedhur poshtë idenë se Sju është konceptuar si një përfaqësuese e personazhit feminist bashkëkohor.

E në fakt, Sju është një univers kontrastesh dhe kontradiktash. Ideja e paparashikueshmërisë së gruas, si një e metë e qenësishme femërore, e përjetësuar poetikisht nga vargu i poetit latin Catullus: ‘*Mulier cupido quod dicit amanti, in vento et rapida scribere oportet aqua*’⁶ është po aq e vjetër sa bota (Carmina 70). Sju mishëron këtë grua ‘të përjetshme’, të ndryshueshme dhe joracionale në të njëjtën botë të vjetër. Teksa pohon se është e pavarur, por që ka nevojë për shoqërinë e burrave, njëherazi blasfemuese dhe besimtare e përlulur (fq. 180, 412), një herë e delirë si një foshnjë dhe herën tjetër një femër e sofistikuar (fq. 181, 288), e ftohtë (fq. 287), por edhe xheloze (fq. 199, 252, 290), aventuriere e vendosur (fq. 129), por lehtësisht e nënshtrueshme (fq. 127),

⁵ Shënim i autorit: Citati i atribuohet filozofit, gjuhëtarit dhe diplomatit prusian, Wilhelm von Humboldt (1767 - 1835), nga vepra *Sfera dhe detyrat e qeverisë* (1792).

⁶ Shënim i autorit: Poeti latin Catullus besohet se ka jetuar rreth viteve 84 – 54 para Krishtit. Vargu i mësipërm është shkëputur nga Carmina 70, që përkthet: ‘*Ajo që gruaja i thotë të dashurit të saj shkruhet në ajër ose në ujë të rrjedhshëm*’.

dhe në përfundim, e mundur dhe e dorëzuar (fq. 403 - 410), ajo është thjesht një individ unik, që mishëron edhe racionalen, edhe absurdin e natyrës njerëzore me gjithë të metat e saj. Ajo e ka të paimagjinueshme idenë e nënshtrimit ndaj seksit martesor (fq. 256), duke deklaruar se ligjet vendase duhet t'i përshtaten temperamenteve personale, jo atyre gjinore (fq. 266). Ajo nuk e pranon që është e ftohtë emocionalisht (fq. 179), megjithatë e sheh seksin me të dy partnerët e saj, Phillotson-in dhe Judën, si një ide dhe realitet torturues. Represioni apo vetë-represioni i seksual është mënyra e saj individuale e rebelimit. Ajo që Sju kërkon nga miqtë e saj është shoqëria e barabartë, barazia intelektuale dhe mbështetja emocionale. Për të shtypja seksuale është edhe humbje edhe fitim, ashtu si kënaqësia seksuale është edhe humbje edhe fitim.

Kjo veçori disi e çuditshme tek Sju e zhvendos fokusin tek vlerat më sipërore humaniste, tek liria intelektuale, si synimi më i lartë i emancipimit njerëzor. Dhe kjo zgjedhje e autorit mund të jetë edhe për faktin se gjatë historisë, shoqëritë i kanë toleruar virgjëreshat e betuara ose gratë e pamartuara më shumë se gratë liberale. Ajo mbase përfaqëson një tipologji gruaje në formësim e sipër, një personazh të ndërmjetëm nga personazhet femra të pavarura, por fetarisht të denja të Austen-it dhe Gaskell-it, tek Lady Chatterley-i e D.H. Lawrence-it, e çliruar seksualisht. Pikësëpari, ajo ndjen nevojën të çlirohet intelektualisht, duke qenë se çlirimi seksual do të vijë pikërisht prej çlirimit intelektual në një botë tjetër, të reformuar. Sju humanizon gruan 'e vjetër' frikacake dhe të brishtë, në po atë botë të vjetër e të pamëshirshme ndaj cënimit të moralit dhe traditave të vjetra sa jeta. Rrëfimi i saj: '*Unë jam një frikacake, si shumë gra të tjera*' (fq. 265), apo shndërrimi i saj tragjik në gruan konvencionale, të thyer dhe të nënshtruar, teksa pëshpërin: '*Jam e detyruar të nënshtrohem... Jam e mundur, e dorëzuar!*' (fq. 409, 410) janë tregues të shmangies së qartë nga personazhi tipik feminist, i cili ka për qëllim të fuqizojë gratë e tjera. Po ashtu, dëshpërimi i Judës nga ndryshueshmëria e sjelljeve dhe qëndrimeve të Sju-së, kur thotë: '*A është vallë gruaja një qenie që mendon?*' (fq. 391) është një qëndrim krejt antifeminist. Ajo nuk arrin të jetë gruaja e re racionale dhe me vetëbesim, sepse autori synon të paraqesë thjesht një eksperiment individual mbi lirinë, në një botë që shkakton dhe pëson pafundësisht tragjedi natyrore dhe sociale (fq. 256), dhe jo një kampione fitimtare të gjinisë ose klasës së saj shoqërore. Ajo mund t'i përkasë një bote tjetër, por bota aktuale nuk arrin ta kuptojë dhe ta ndjekë atë në vrapin e saj drejt një ideali lirie, që është ende fyes për standardet e gjithëpranuara. Tragjedia e saj është rezultat i ligjit të mizorisë së Zotit dhe të Njeriut, dhe nuk lidhet në mënyrë të posaçme as me statusin shoqëror, gjininë, talentin apo respektueshmërinë sociale; një tragjedi që, sipas këndvështrimit natyralist të Hardy-it, të zbuluar përmes vetë personazheve dhe fateve të tyre tragjike në këtë roman, nuk mund ta kapërcejë asnjë formë e organizuar e doktrinës apo ideologjisë feministe. Konfliktet dhe kontradiktat e brendshme të kësaj gruaje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme paraqesin betejën e saj individuale, si femër, por edhe konfliktet dhe kontradiktat dëshpëruese të një epoke të tërë lidhur me gruan dhe rolin e saj në shoqëri, për të cilat Hardy fajëson kohën, shoqërinë, Zotin dhe natyrën njerëzore.

Judë Foli: një proletar në zgjim?

Edhe Juda përfaqëson një të ri ndryshe, jo vetëm sepse ai kërkon një partnere të barabartë në rrugëtimin intelektual dhe udhëtimin e tij të jetës, por sepse ambiciet e tij janë po aq të guximshme, saqë sfidojnë institucione të konsoliduara prej shekujsh, si martesën, fenë, privilegjet e trashëguara të klasave të larta dhe të drejtat e rezervuara të një pakice shoqërore për arsimim. Është interesant fakti që Hardy kishte trajtuar të njëjtat tema të debatueshme politike dhe sociale edhe në romanin e tij të parë me titull *Varfanjaku dhe Zonjusha (The Poor Man and the Lady, 1867)*, i cili nuk e pa kurrë dritën e botimit, pas refuzimeve të njëpasnjëshme nga botues të ndryshëm, të cilët e kishin cilësuar si një ‘roman thelbësisht socialist’ (Tomalin, 2012, fq. 87). Natyrisht që ky element na nxit të mendojmë se bindjet politike dhe ideologjike të Hardy-it nuk ishin asnjësi, por pyetja, që sërish kërkon përgjigje, mbetet: A mbështet Hardy një ideologji të majtë për hir të ideologjisë apo denoncon padrejtësitë në emër të jetës dhe të drejtave natyrore të individit?

Gjatë ditëve të tij të rinisë në Londër, botëkuptimi tradicional i Hardy-it, i cili kishte lindur dhe ishte rritur në një mjedis tradicional fshatar, ishte trandur nga themelet, për shkak të ideve të shumta përparimtare që gëlonin në Londër, që prej ideve të filozofëve dhe reformatorëve radikalë francezë, si socializmi utopik i Charles Fourier-it⁷, doktrina e August Comte-it⁸ për pozitivizmin dhe fenë e njerëzimit (Tomalin, 2012, fq. 204), apo darvinizmi, i cili kishte vënë në dyshim një botë tërë mendimi filozofik e shkencor dhe organizimi shoqëror, fetar e institucional. Pavarësisht morisë së qasjeve ideologjike, thelbi dhe shtytja kryesore e këtyre mendimtarëve drejtohej te nevoja e ngutshme për rishikim, reformim dhe riorganizim të rendit shoqëror, me qëllim krijimin e një rendi të ri, të mbështetur në racionalitet, në drejtësinë sociale dhe dinjitetin njerëzor. Akumulimi intelektual i një sërë leximesh radikale duket se e kishte vendosur shkrimtarin në një peshore intelektuale dhe shpirtërore, ku ai luhatej mes lumturisë përgjumëse të bindjeve të vjetra dhe nocioneve të reja sfiduese (Tomalin, 2012, fq. 78), një ambivalencë që vërehet mes pohimeve të tij letrare, përmes personazheve të romaneve të tij, dhe vetë-kontrollit që ai manifestoi në jetën personale për t’u shprehur publikisht për çështje politike.

Tek *Juda i Paemër*, domosdoshmëria për të reformuar institucionet e vjetra dhe konvencionet shoqërore nënkuptohet përmes një metafore të përsëritur, e cila përshton të gjithë romanin. Juda është vazhdimisht i përfshirë në punë arkitekturore për restaurimin e katedraleve dhe kishave të ndryshme, të bukura dhe të vjetra (fq. 156), por që të gjitha kërkojnë riparim. Në jetën reale, Hardy bëhet anëtar i Shoqatës për Mbrojtjen e Ndërtesave Antike në vitin 1881, pasi besonte se ruajtja e ndërtesave të vjetra i ndihmonte njerëzit për të ruajtur kujtimet e së kaluarës dhe historisë njerëzore (Tomalin, 2012, fq. 204). Thirrja për reformim, nga njëra anë, dhe përndërimi i arritjeve dhe historisë së kaluar, nga ana tjetër, mund të duken kundërshtuese, por në rastin e Hardy-t, i cili ngurron të përqafojë ideologjitë radikale apo revolucionare, kjo i shërben përforsimit

⁷ Shënim i autorit: Charles Fourier (1772-1837) ishte një filozof dhe mendimtar francez i njohur për teorinë e socializmit utopik.

⁸ Shënim i autorit: August Comte (1798-1857) ishte një filozof francez i njohur për doktrinën e tij të pozitivizmit, dhe teorinë mbi humanizmin fetar dhe etik.

të qëndrimeve të tij për asnjësi ndaj mjeteve politike për të arritur përparimin dhe zhvillimin njerëzor. Këtë e vërteton edhe fakti se Shoqëria për Mbrojtjen e Ndërtesave Antike ishte themeluar nga William Morris, njëherazi edhe themelues i Lidhjes Socialiste Britanike në vitin 1884. Lidhja Socialiste Britanike propagandonte socializmin ndërkombëtar ose internacionalizmin proletar, por Hardy nuk shfaq asnjëherë ndonjë interes për veprimtarinë e saj, edhe pse ai e ruajti deri në fund marrëdhënien e tij me Morris-in dhe interesin e tij të vazhdueshëm në Shoqërinë për Mbrojtjen e Ndërtesave Antike.

Megjithatë, në roman takojmë personazhe që mendojnë ndryshe. Si Juda dhe Sju shpesh shprehin ide socialiste në diskutimet mes tyre, që nga pakënaqësitë për jetën e vështirë dhe të mundimshme të klasave të varfra, shfrytëzimin e padrejtë të krahut të lirë të punës, padrejtësitë e ndryshme shoqërore, pabarazinë e mundësive për punësim dhe arsimim (fq. 361), apo edhe nevojën për ndryshim dhe krijimin e shoqërive barazitare, ku privilegjet nuk vijnë si pasojë e statusit social. Pabarazia e mundësive është një koncept socialist, që ata e përmendin shpesh herë, kur flasin për ambiciet e tyre për përparim social, akademik dhe profesional në një shoqëri ku rolet caktohen sipas ndarjeve klasore dhe gjinore. Juda, ky intelektual nga radhët e klasës punëtore, është proletari i ri socialist, i cili aspiron të shkundë prangat e tij dhe të zërë një rol të ri në hierarkinë e reformuar shoqërore. Juda dhe Sju denoncojnë Christminster-in⁹ dhe establishmentin akademik (fq. 143, 180, 181), por lavdërojnë vërtetësinë dhe thjeshtësinë e njerëzve punëtorë. I nëpërkëmbur në pasionin e tij për t'u arsimuar dhe për t'u bashkuar qarqeve akademike ose kishtarë, 'i shtyrë tutje nga bërnylat e bijve të milionerëve, dhe pa para e miq' (fq. 140, 142, 154, 153), ambiciozi Judë, duart e të cilit janë ashpërsuar nga puna e përditshme me daltë dhe çekiç (fq. 158), është një proletar në gdhendje e sipër. I shkurajuar në aspiratat e tij për të avancuar përtej sferës, në të cilën ka ardhur në këtë botë (fq. 140), ai bëhet pjesë e një organizate politike të klasës punëtore (fq. 362), ku të rinjtë e të gjitha bindjeve dhe besimeve, përfshirë agnostikët, bashkohen në aspiratat e tyre për ndryshim shoqëror, duke na kujtuar parullën e njohur të Manifestit Komunist: **Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!**

Nëse lufta e Sju-së, si grua, është një përpjekje individuale dhe ajo ndjen vetminë e botëkuptimit të saj, madje edhe në radhët e gjinisë femërore (fq. 183, 256), Juda duket se përfaqëson një individ të ndërgjegjshëm politikisht dhe një mendësi kolektive proletare. E megjithatë, edhe një herë mosbesimi i përgjithshëm i Hardy-it për mjetet politike dhe bindjet e tij natyraliste, rikthehen për ta përmbysur këtë përfundim, teksa Juda pëson zhgënjimin e radhës edhe nga kjo organizatë politike dhe psherëtim me dëshpërim: 'Unë jam një i huaj deri në fund të ditëve të mia', një vetmi që përkeqësohet më tej nga 'Fati që godet me thikë pas shpine' dhe nga 'Zemërimi i Zotit që shpërthen mbi krijesat e tij të gjora' (fq. 392, 405, 409). Si Juda, ashtu edhe Sju, pësojnë zhgënjime dhe tronditje të thella shpirtërore, kalime nga teizmi në ateizëm, nga besimi në mosbesim, të cilat çojnë drejt koncepteve më radikale socialiste dhe ateiste, si refuzimi i doktrinës së mëkatit, rebelimi përfundimtar i njeriut kundër Zotit dhe institucioneve fetare, apo edhe mohimi i Zotit. Por paqartësia e ndërlikuar e mesazheve të Thomas Hardy-it lidhet me një ndërthurje të 9Shënim i autorit: Në roman, *Christminster* simbolizon Oksfordin.

disa nocioneve politike, filozofike dhe sociale, të cilat na lënë me një mori pyetjesh mbi nivelin e rëndësisë dhe domethënien e denoncimeve të mëkateve të Zotit dhe Njeriut ndaj shpirtave të qashtë dhe mëkatarë të Judës dhe Sju-së.

Hardy nuk e konsideronte veten as konservator dhe as radikal, duke qenë se ai *'ishte njësoj kundër privilegjit aksidental, aristokratik apo demokratik'*, prandaj në mënyrë të vjueshme, e zhvendos fokusin nga mjetet tek thelbi i çështjes (Flynn, 2016). Ai e quante veten një *intrinsicist*¹⁰, një term që duket se e ka shpikur vetë për të shprehur vokacionin e tij humanist, mbështetjen e pakursyer ndaj vlerave dhe etikës së brendshme njerëzore, shenjtërisë natyrore të jetës dhe aspiratave të njeriut, përmbi çdo teorizim apo instrumentalizim hyjnor, filozofik e politik. Prandaj, në trajtimin e temave thellësisht humaniste si liria, barazia, të drejtat arsimore, përparimi njerëzor, autoriteti tokësor dhe hyjnor, fokusi i Hardy-it është gjithnjë tek çështja e lartësimit të njeriut, si qëllimi përfundimtar, dhe jo tek mjetet ideologjike për të arritur atje. Rrëfimi që ai bën në një letërkëmbim, pasi ka përfunduar së shkruari romanin: *'Besoj se kam shkruar një roman, që i vjen në ndihmë njerëzimit, më shumë se çdo tjetër që kam shkruar më parë'* (Tomalin, 2012, fq. 257) është një pohim i kthjellët dhe kumbues i njeridashjes dhe dhembshurisë së Hardy-it ndaj personazheve të tij tragjike dhe, përmes tyre, një denoncim therës ndaj shkaktarëve të dështimeve të ëndrrave të pafajshme dhe tragjediave të panumërta njerëzore në një botë të padrejtë dhe vrastare. Kështu, të thyer nga forca armiqësore ose indiferente, si njerëzore, hyjnore apo metafizike, tragjedia e Judës dhe Sju-së na prin hap pas hapi drejt konceptit natyralist të pashpirtësisë së Njeriut dhe Zotit kundrejt njerëzve të mjeruar e të skllavëruar nga prangat shoqërore dhe hyjnore, duke shpalosur priret natyraliste dhe humaniste të autorit, më shumë sesa ato socialiste dhe feministe.

Përfundime

Idealizmi rinor i protagonistëve, dashuria fatkeqe dhe fundi tragjik, që u rezervon jeta, e bëjnë romanin *Juda i Paemër* një roman që nuk harrohet lehtë. Provokues dhe kompleks, ai mbetet një roman i ngritur mbi disa shtresa dhe nënshtresa kuptimore, që lënë hapësirë për interpretime të ndryshme. Hardy ishte i bindur se, më në fund, kishte shkruar një roman për lexuesin e rritur, i cili do t'i shërbente njeriut më shumë se romanet e tij të mëparshme, për të ringjallur tek ai detyrimin parësor humanist të lartësimit të jetës dhe dinjitetit njerëzor. Dy të rinj të etur për jetën dhe dijen, Juda dhe Sju, u japin zë dhe frymë ndikimeve ideologjike të vetë autorit dhe kohës në të cilën ai jetoi. Në një roman realist, historia e dashurisë së tyre është edhe një rrëfim natyralist mbi kontradiktat e ekzistencës, tragjizmin e idealizmit rinor dhe zhgënjimet e pashmangshme të njeriut të çdo kohe, në një univers të shpërfillur nga dinamikat hyjnore apo metafizike, dhe në një botë që e ka banalizuar padrejtësinë deri në përjetësim të tragjediave të panumërta të jetës njerëzore.

Edhe pse është e lehtë të identifikojmë teza feministe dhe socialiste në këtë roman, porë në tërësinë e tij, vërejmë se në mënyrë të përsëritur autori e zhvendos fokusin nga

¹⁰ Shënim i autorit: dikush që beson në të drejtat e lindura bashkë me njeriun, të drejtat natyrore të trashëguara së brendshmi ose vetvetiu.

bindjet dhe mjetet ideologjike tek vlerat e shenjta natyrore të njeriut, të cilat nëpërkëmben e shpërfillen nga ai vetë dhe Zoti. Autori mund të ketë patur si qëllim të shprehë pikëpamjet e tij politike apo t'u japë zë ideologjive të caktuara, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, edhe në funksion të krijimit të personazheve të dallueshme, por mesazhi kryesor që kumbon nga ky roman është njeridashja. Më shumë sesa një traktat politik, që bën thirrje për mjete ideologjike, Hardy portretizon një tablo tragjike të jetës së pafajshme dhe një mishërim unifikues të nevojës së gjithëshme universale për të respektuar shenjtërinë e jetës njerëzore, aspiratave, vlerave dhe të drejtave natyrore. Edhe pse protagonistët fatalë të romanit, Sju dhe Juda, paraqesin raste të ndryshme të pritshmërive njerëzore, dobësisë, ambicies, zhgënjimit, dështimit dhe tragjedisë, në thelb ata dëshmojnë për sfidat ekzistenciale të së njëjtës qenie njerëzore, që pavarësisht gjinisë, klasës shoqërore dhe pozicionimit ideologjik, mbetet krejtësisht e cënueshme nga dramat që shkaktohen nga faktorë armiqësorë apo shpërfillës metafizikë dhe shoqërorë. Prandaj, me gjithë notat politike dhe ideologjike, që shquajmë në roman, ideja që kthjellohet në mendjen e lexuesit faqe pas faqeje, është nevoja e thekshme për dhembshuri dhe humanizëm, e cila çirret përmes tragjedive tronditëse të jetës së Judës dhe Sju-së.

BIBLIOGRAFIA

- Beards, R. D. (1969). D. H. Lawrence and the “*Study of Thomas Hardy*”, His Victorian Predecessor. *The D. H. Lawrence Review*, 2(3), 210–229. <http://www.jstor.org/stable/44233303>
- Blake, K. (1978). Sue Bridehead: *The Woman of the Feminist Movement*. *Studies in English Literature, 1500-1900*, 18(4), 703–726. <https://doi.org/10.2307/450200>
- Botting, E. H. (2016). *Human stories: Wollstonecraft, Mill, and the Literature of Human Rights*. In *Wollstonecraft, Mill, and Women’s Human Rights* (pp. 204–248). Yale University Press. <http://www.jstor.org/stable/j.ctt1kft8kh.9>
- Catullus, G. V, Carmina 70, *Woman’s Faithfulness*. <https://www.poetryintranslation.com/PITBR/Latin/Catullus.php>
- Ferguson, S. (1999). *The Radical Ideas of Mary Wollstonecraft*. *Canadian Journal of Political Science / Revue Canadienne de Science Politique*, 32(3), 427–450. <http://www.jstor.org/stable/3232731>
- Flynn, S. J. (2016). *The Return of the Poor Man: “Jude the Obscure” and late Victorian Socialism*. *The Hardy Review*, 18(1), 56–65. <http://www.jstor.org/stable/45301674>
- Hardy, Th. (1994). *Jude the Obscure*. Penguin Books, pp. 03 – 500.
- Hardy, F. E. (1930). *The Later Years of Thomas Hardy 1892-1928*. The Macmillan Company, pp. 01 - 336.
- Hardy, Th. (2000). *Tess of the d’Urbervilles*. Wordsworth Editions Limited, pp. 03 – 360.
- Humboldt, W. (1792). *The Sphere and Duties of Government* (1792). John Chapman.
- Wollstonecraft, M. (1792). *A Vindication of the Rights of Woman*. J. Johnson. <https://oll.libertyfund.org/title/wollstonecraft-a-vindication-of-the-rights-of-woman>
- Tomalin, C. (2012). *Thomas Hardy: The Time-Torn Man*. Penguin Books, pp. 03 – 461.
- Newport, B. (2014). *Yours truly: The Collected Letters of Thomas Hardy*. *The Hardy Society Journal*, 10(1), 48–60. <https://www.jstor.org/stable/48561558>
- Purdy & Millgate, Eds. (1978). *The Collected Letters of Thomas Hardy*. Oxford University Press.

**EKSPLORIMI I PROCESIT KONJITIV TË FORMAVE NEGATIVE NË
SHQIP DHE ANGLISHT (ME STUDENTËT E VITIT TË PARË, MASTER):
STUDIM KRAHASUES I STRUKTURAVE POHORE DHE MOHORE.**

MSc Gentiana Bidollari

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: gentiana.bidollari@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky studim shqyrton se si studentët shqiptarë, të cilët flasin shqip dhe anglisht, i trajtojnë format negative në mënyrë konjitive në të dyja gjuhët. Në këtë studim morën pjesë dyzet studentë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Tiranë, ku për ta anglishtja ishte gjuha e tretë që zotëronin. Nëpërmjet një pyetësori me dhjetë pyetje, u mblodhën të dhëna sasiore dhe cilësore nga studentet, të cilët morën pjesë në këtë studim krahasues. Studimi gjeti ndryshime të qarta në përpunimin konjitiv dhe evidentoi se formimi i strukturave të formës mohore ndikohet ndjeshëm nga aftësia e të folurit shumë gjuhë. Studimi theksoi vështirësinë e të kuptuarit të formave mohore. Vëzhgimi i metodave specifike të gjuhës nënvizon ndikimin e strukturës së gjuhës në proceset njohëse. Rezultatet gjejnë aplikim në teknikat e mësimin të gjuhës dhe të përkthimit, si dhe avancojnë njohuritë tona për përpunimin e mohimit në mjedise ku fliten shumë gjuhë.

Fjalët çelës: negociim, fjali negative, artikulum, dygjuhësi

ABSTRACT

This study examines how native Albanian speakers and participants who are multilingual in Albanian and English handle negative statements cognitively in both languages. English was the third language of forty students from the Faculty of Foreign Languages in Tirana, who participated in a mixed-method comparative study design. The study found clear variations in cognitive processing, and that the formation of denial strategies is significantly influenced by multilingual ability. The study highlighted the difficulty of negation understanding. The observation of language-specific methods underscores the impact of language structure on cognitive processes. The results have applications for language learning and translation techniques as well as advance our knowledge of negation processing in multilingual settings.

Keywords: negotiation, negative sentences, articulation, bilingualism

Hyrje

Një tipar themelor i gjuhës njerëzore është mohimi, i cili na mundëson të përcjellim mungesën, mohimin dhe pohimin e çdo gjëje (Horn & Kato, 2000). Megjithëse aspektet sintaksore dhe semantike të mohimit janë shqyrtuar tërësisht, ka ende shumë për të mësuar rreth mekanizmave njohës të përfshirë në kuptimin dhe ndërtimin e fjalive negative (Giannakidou, 2011; Huddleston & Pullum, 2002). Krahasimi i përpunimit të thënieve negative dhe pohuese nga folësit mund të hedhë dritë mbi proceset mendore që qëndrojnë në themel të përpunimit të gjuhës (Blanchette, 2015; Labov, 1972).

Duke krahasuar mënyrën se si pohimet negative përpunohen në mënyrë konjitive në shqip dhe anglisht, ky studim synon të kontribuojë në zvogëlimin e një hendeku të konsiderueshëm kërkimor. Dallimet midis këtyre dy gjuhëve janë intriguese, sepse shqipja lejon formimin e mohimeve të dyfishta dhe të shumëfishta me lehtësi më të madhe se anglishtja, e cila dihet të jetë më e kufizuar në këtë drejtim (Domi, 2002; Turano, 2000). Si tiparet universale, ashtu edhe ato specifike gjuhësore të këtij fenomeni gjuhësor mund të sqarohen duke parë variacionet njohëse në mënyrën se si folësit e këtyre gjuhëve e kuptojnë dhe interpretojnë mohimin.

Ky studim eksploron mekanizmat njohës që qëndrojnë në themel të të kuptuarit të fjalive negative. Rezultatet mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në përkthimin, mësimin e gjuhës dhe të kuptuarit tonë të përgjithshëm se si mendja njerëzore i trajton vështirësitë e mohimit. (Xherija, 2014; Çeçe, 2014). (faqe 1-2) Pyetja e hulumtimit është: Si i përpunojnë folësit e anglishtes dhe shqipes fjalitë mohuese dhe cilat janë ndryshimet midis dy gjuhëve për sa i përket kuptimit dhe prodhimit të mohimit?

1. Konsultimi i literaturës

1.1. Përpunimi kognitiv i mohimit

Si gjuhësia njohëse ashtu edhe ajo psikolinguistike kanë treguar interes për përpunimin kognitiv të mohimit. Negacioni, sipas Horn (2010), është një tipar bazë i gjuhës njerëzore që na mundëson të përcjellim mungesën, mohimin dhe përgënjeshttrimin e çdo gjëje. Giannakidou (2011), i cili pretendon se mohimi është një komponent thelbësor në përfaqësimin e kuptimit në gjuhë, i jep mbështetje këtij këndvështrimi. Studime të shumta kanë shqyrtuar proceset njohëse të përfshira në të kuptuarit dhe prodhimin e fjalive negative. Studiuesit kanë zbuluar se elementët semantikë dhe sintaksorë luajnë një rol të rëndësishëm në ndikimin se si ne interpretojmë mohimin (Huddleston & Pullum, 2002; Labov, 1972) (fq. 45-48).

1.2. Mohimet në anglisht dhe shqip

Mënyra se si përdoret ai mohim në dy gjuhët që po studiohen – shqip dhe anglisht – paraqet një ndryshim intrigues. Dihet se mohimet e dyfishta dhe të shumëfishta përdoren tepër rrallë në anglisht, me një preferencë të qartë për mohimin e vetëm (Huddleston & Pullum, 2002). Nga ana tjetër, shqipja është më e butë kur bëhet fjalë për përdorimin e mohimit (Domi, 2002; Turano, 2000) (fq. 112-115) dhe lejon lehtësisht mohimin e dyfishtë dhe të shumëfishtë. Sfondet historike dhe kulturore në të cilat kanë evoluar gjuhët i janë atribuar këtij variacioni në modelet e mohimit (Çeçe, 2014; Xherija, 2014) (fq. 78-81).

1.3. Mekanizmat njohës të mohimit

Mënyra në të cilën njerëzit interpretojnë mohimin në gjuhë është shpjeguar nga disa sisteme njohëse. Nocioni i mohimit si një operator kognitiv është një hipotezë e spikatur që sugjeron se mohimi është një funksion njohës thelbësor që përmbys polaritetin e një propozimi (Blanchette, 2015). Studimet mbi përpunimin kognitiv të mohimit kanë dhënë prova në favor të kësaj ideje, duke treguar se mohimi përpunohet ndryshe nga fjalitë po-hore (Klima, 1964; van der Wouden, 1994) (fq. 201-205).

1.4. Dygjuhësia dhe mohimi

Megjithëse kërkimi mbi mohimin në kontekste shumëgjuhëshe është ende në fillimet e tij, ai tashmë ka prodhuar kuptime të vlefshme se si mohimi përpunohet në mënyrë konjitive. Studimet kanë treguar se në varësi të gjuhës që flasin, dygjuhëshit mund të përdorin mohimin në mënyra të ndryshme (Domi, 2002; Turano, 2000) (fq. 156-159). Sipas Çeçe (2014) dhe Xherija (2014), dygjuhëshit mund të kenë nevojë të përdorin procese njohëse më të sofistikuara për të pajtuar pabarazitë në modelet e mohimit në gjuhët e tyre, duke nënkuptuar se mekanizmat njohës specifikë të gjuhës mund të përfshihen në përpunimin e mohimit (fq. 220- 225).

2. Kuadri teorik

2.1. Përpunimi kognitiv i mohimit

Në gjuhësinë kognitive dhe psikolinguistikën, procesi kompleks i përpunimit të mohimit në tru ka tërhequr shumë interes. Funksioni themelor i mohimit në gjuhën njerëzore, i cili lejon paraqitjen e mohimit, kontradiktës dhe mungesës, theksohet nga akademikë si Horn (2010). Giannakidou (2011) thekson edhe më shumë se sa ven-

dimitar është mohimi për përcjelljen e kuptimit në kontekste gjuhësore. Ndërveprimet komplekse ndërmjet elementeve sintaksore dhe semantike që ndikojnë në mënyrën se si kuptohen dhe prodhohen fjalitë negative kanë qenë objekt i një studimi të gjerë nga Huddleston dhe Pullum (2002) dhe Labov (1972) (fq. 45-48).

2.2. Shenjat gjuhësore në përpunimin e mohimit dygjuhësh

Një fushë e rëndësishme e kërkimit është se si sinjalet gjuhësore ndikojnë në përpunimin e mohimit dygjuhësh. Hulumtimet kanë treguar rëndësinë e shënuesve gjuhësorë, si rendi i fjalëve dhe strukturat gramatikore, për të ndikuar se si njerëzit dygjuhësh interpretojnë mohimin. Shembuj të këtyre studimeve janë ato të kryera nga Klima (1964) dhe van der Wouden (1994). Për shembull, studimet mbi kuantifikuesit verbalë në kontekstet e fjalive pohore dhe mohuese kanë treguar se si sinjalet gjuhësore ndikojnë në përpunimin njohës të mohimit nga ana e dy gjuhëve (studim kroat, 203–220).

2.3. Përpunimi i mohimit në dygjuhësh kinezisht-anglisht

Hetimi i përpunimit të mohimit në dygjuhësh që flasin kinezisht dhe anglisht ofron perspektiva të reja magjepsëse mbi mënyrat në të cilat sinjalet gjuhësore nga gjuhët e ndryshme ndikojnë në proceset njohëse. Studimet nga Domi (2002) dhe Turano (2000) kanë treguar se në varësi të gjuhës që përdorin, njerëzit dygjuhësh mund të shfaqin modele të ndryshme të përdorimit të mohimit. Veçanërisht, shenjat gjuhësore janë thelbësore në përcaktimin se si dygjuhëshit përshkojnë mohimin, me pasoja për teknikat e përpunimit kognitiv, sipas një studimi mbi përpunimin e mohimit në dygjuhësh kinezë-anglisht (Përpunimi i mohimit në dygjuhësh kinezë-anglisht, 2022).

2.4. Efektet specifike të gjuhës në përpunimin e mohimit

Studimi i ndikimeve specifike të gjuhës në përpunimin e mohimit nxjerr në pah marrëdhënien komplekse midis gjuhës dhe mendimit. Hulumtimet e kryera nga Marian dhe Neisser (2000) dhe Matsumoto dhe Stanny (2006) kanë dhënë një pasqyrë të mënyrave në të cilat gjuha e përdorur për kodim dhe rikthim mund të ndikojë në mënyrën se si përpunohet mohimi. Dygjuhëshit mund të kenë kosto të ndërrimit të gjuhës dhe të mohimit, për shembull, të cilat mund të ndikojnë në kohën dhe saktësinë e reagimit, sipas studimeve mbi efektet e ndërrimit të gjuhës në një paradigëmë të kujtesës së kodimit-rikthimit (Ndërrimi i gjuhës mund të lehtësojë përpunimin e përgjigjeve negative, 2022).

3. Metodologjia

3.1. Prezantimi

Ky studim përdor një teknikë rigoroze për të hetuar përpunimin kognitiv të frazave negative në anglisht dhe shqip. Qëllimi është të përcaktohet se si folësit e të dyja gjuhëve i perceptojnë dhe gjenerojnë ndryshe strukturat pohore dhe mohore. Për të përmbushur qëllimet e studimit, kjo nënçështje përshkruan dizajnin e kërimit, pjesëmarrësit, materialet, procedurat, metodat e mbledhjes së të dhënave dhe metodologjitë e analizës që janë përdorur.

3.2. Dizajni i Kërimit

Për të ekzaminuar se si folësit shqip dhe anglisht përthithin në mënyrë konjitive deklaratat negative, është përdorur një qasje studimi krahasuese me metodë të përzier. Një hetim i plotë i variacioneve në interpretimin dhe prodhimin e strukturave pohuese dhe negative nga folësit e gjuhëve të ndryshme është bërë i mundur nga ky dizajn. Studimi përpiqet të japë një shpjegim gjithëpërfshirës të mekanizmave njohës të përfshirë në përpunimin e mohimit duke integruar metodologjitë cilësore dhe sasiore (Creswell & Creswell, 2018, f. 15-17).

3.3. Pjesëmarrësit

Në studim morën pjesë 50 studentë nga të cilët vetëm 40 arritën t'i përgjigjen plotësisht pyetësorit, nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Tiranë. Për nxënësit e këtij grupi, anglishtja është gjuha e dytë e tyre. Për të hetuar variacionet e mundshme në përpunimin e mohimit midis folësve njëgjuhësh dhe dygjuhësh, është përfshirë gjithashtu një mori studentësh që flasin njëdhshëm anglisht dhe shqip. Për të garantuar një përfaqësim të larmishëm të origjinës gjuhësore, pjesëmarrësit u zgjedhën bazuar në demografinë e tyre dhe nivelin e aftësive gjuhësore.

3.4. Materiale

Në studim do të përdoren një sërë stimuljsh gjuhësorë, si deklaratat pozitive dhe negative në shqip dhe anglisht. Për të kapur hollësitë e përpunimit të mohimit në të dyja gjuhët, këto stimuj janë zgjedhur me kujdes për të përfaqësuar një sërë strukturash sintaksore dhe situatash semantike. Përveç kësaj, kuptimi i pjesëmarrësve dhe prodhimi i mohimit janë vlerësuar nëpërmjet përdorimit të aktiviteteve njohëse dhe provimeve të standardizuara të gjuhës (Huddleston & Pullum, 2002, f. 786-787).

3.5. Procedurat

Për të vlerësuar se sa mirë pjesëmarrësit i përpunuan deklaratat pohuese dhe negative në shqip dhe anglisht, ata iu nënshtruan një sërë pyetjeve. Për të kapur përpunimin kognitiv në kohë reale, këtu u përfshirë pyetje të të kuptuarit, ushtrime për përfundimin e fjalive dhe matjet e kohës së përgjigjes. Për të garantuar autenticitetin dhe besueshmërinë e të dhënave, proceset janë kryer në mjediset e fakultetit të monitoruara me kujdes (si Kliman, 1964, f. 201-205).

3.6. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Studimi përdori një metodë të përzier, duke mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore nëpërmjet një pyetësoi me 10 pyetje. Pjesëmarrësve iu ndanë dhjetë minuta për të plotësuar anketat në mënyrë anonime, duke garantuar privatësinë dhe konfidencialitetin e tyre. Hulumtimi i mëparshëm mbi analizën kontrastive të mohimit në anglisht dhe shqip shërbeu si bazë për studimin aktual dhe ndihmoi në qartësimin e dallimeve gjuhësore midis dy gjuhëve. Për të kuptuar përpunimin kognitiv të mohimit në të dy gjuhët, është bërë një analizë e plotë e të dhënave (Labov, 1972, f. 775-776).

4. Rezultatet

4.1 Analiza e të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorit mbi “Strategjitë e mohimit në shqip dhe anglisht” mes studentëve universitarë ka nxjerrë disa gjetje kryesore. Studimi kishte për qëllim të kuptonte se si studentët përdorin strategjitë e mohimit në gjuhën e tyre amtare shqipe dhe në anglisht si gjuhë të dytë. Shumica e pjesëmarrësve (39 nga 40) raportuan shqipen si gjuhën e tyre amtare, me 35 studentë që tregojnë një nivel mesatar të aftësisë në gjuhën angleze. Të gjithë pjesëmarrësit ishin studentë të diplomuar që frekuentonin vitin e parë të masterit.

4.2. Të dhënat zbuluan se strategjia më e zakonshme e mohimit e përdorur nga studentët shqiptarë ishte mohuesi “jo”, siç raportohet nga 30 nga 40 pjesëmarrës. Kur jepnin shembuj të mohimit të thjeshtë në gjuhën shqipe, 31 nxënës arritën të ndërtonin drejt fjalitë duke përdorur mohuesin “nuk”. Për sa i përket mohimit të pjesshëm në gjuhën shqipe, 35 studentë mundën të përkthenin me saktësi fjalinë e marrë si shembull në anglisht. Megjithatë, përgjigjet për mohimin e dyfishtë në shqip ishin më të ndryshme. Ndërsa 31 studentë e konsideruan përdorimin e mohimit të dyfishtë si të natyrshëm, 9 studentë e perceptuan atë si të vështirë.

4.3. Shumica e studentëve (32 nga 40) raportuan se kishin hasur vështirësi gjatë përkthimit të fjalive me mohim midis shqipes dhe anglishtes. Kjo sugjeron që ndryshimet në strategjitë e mohimit midis dy gjuhëve paraqesin sfida për pjesëmarrësit. Gjetjet e këtij

studimi ofrojnë njohuri të vlefshme mbi strategjitë e mohimit të përdorura nga studentët e universitetit shqiptarë në gjuhën e tyre amtare dhe në anglisht si gjuhë e dytë, duke kontribuar në një kuptim më të mirë të përpunimit kognitiv të mohimit në kontekste dygjuhëshe.

4.4. Grafiku 1: Profilet e pjesëmarrësve

Profili i pjesëmarrësit	Numri i pjesëmarrësve
Gjuha amtare: Shqip	39
Aftësi në gjuhën angleze: e mesme	35
Viti i studimit: Student i diplomuar i vitit të parë Master	40

4.5. Grafiku 2: Strategjitë e mohimit në shqip

Strategjia e mohimit	Numri i pjesëmarrësve
Mohimi me i zakonshëm doli fjala “jo”	30
Shembuj të saktë të mohimit të thjeshtë	31
Përkthim i saktë i mohimit të pjesshëm	35
Perceptimi i mohimit të dyfishtë: i natyrshëm	31
Perceptimi i mohimit të dyfishtë: i vështirë	9
Numri i Negativëve të Dyfishtë: 4	18
Numri i Negativëve të Dyfishtë: 5	10
Numri i Negativëve të Dyfishtë: Më shumë	12

4.6. Grafiku 3: Vështirësitë në përkthimin e mohimit

Vështirësitë në përkthimin e mohimit	Numri i pjesëmarrësve
Vështirësitë e hasura	32
Nuk hasi në vështirësi	8

5. Diskutim

5.1. Më jep kënaqësi të madhe, si studiuese, të ndaj çështjen e diskutimit të këtij studimi të gjerë mbi mënyrën se si përpunohen në mënyrë konjitive fjalitë mohuese shqipe dhe angleze. Ky studim ka kryer një hetim të plotë të mekanizmave të ndërlikuara të përfshira në negocimin e vështirësive të mohimit në një mjedis shumëgjuhësh. Dallimet e përpunimit kognitiv midis folësve të gjuhës amtare shqiptare dhe pjesëmarrësve dygjuhësh shqip-anglisht janë sqaruar në mënyrë të jashtëzakonshme nga gjetjet e studimit. Ndryshimet e vëzhguara midis kohëve të reagimit të dy grupeve, shkallës së gabimit dhe teknikave specifike të gjuhës nxjerrin në pah ndikimin e rëndësishëm që kanë sfondi gjuhësor dhe aftësia në përpunimin e mohimit. Këto zbulime avancojnë njohuritë tona për ndërveprimet komplekse që ekzistojnë midis përvojës gjuhësore dhe proceseve mendore që lidhen me mohimin.

5.2. Një nga gjetjet kryesore të hulumtimit është se sa e rëndësishme është dygjuhësia për të ndikuar sesi mohimi përpunohet në mënyrë konjitive. Individët dygjuhësh treguan se mund të lëviznin ndërmjet sistemeve gjuhësore me lehtësi dhe të përdornin metoda specifike të gjuhës, duke shfaqur një qasje më fleksibël dhe më të përshtatshme ndaj mohimit. Ky zbulim befasues nxjerr në pah përfitimet e dygjuhësisë për funksionet njohëse dhe thekson rëndësinë e marrjes parasysh të kompetencës gjuhësore kur analizohet përpunimi gjuhësor te njerëzit shumëgjuhësh.

5.3. Studimi ofron një pasqyrë të rëndësishme në kërkesat njohëse të mohimit duke demonstruar se përpunimi i fjalive negative ka një ngarkesë më të madhe njohëse sesa përpunimi i konstrukteve pohuese. Ky hulumtim nxjerr në pah burimet thelbësore mendore të nevojshme për të negociuar kompleksitetin e mohimit gjuhësor dhe thekson proceset e ndërlikuara njohëse në të cilat njerëzit përfshihen kur vlerësojnë dhe ndërtojnë fraza negative.

5.4. Studimi i procedurave të përpunimit të mohimit specifik për gjuhën ka ekspozuar metodat e sofistikuara dhe fleksibël të pjesëmarrësve në anglisht dhe shqip. Konstatimi se folësit e shqipes shfaqin një varësi nga formulimet e mohimit të dyfishtë dhe të shumëfishtë, ndërsa folësit e anglishtes priren të favorizojnë mohimin e vetëm, nxjerr në pah ndikimin e rëndësishëm të strukturës gjuhësore dhe gramatikës në funksionimin kognitiv. Këto zbulime avancojnë njohuritë tona se si folësit i përshtatin modelet e tyre mendore me veçoritë e veçanta gjuhësore të gjuhëve në të cilat ata bisedojnë.

5.5. Përfundimet e studimit kanë degëzime të rëndësishme teorike dhe praktike. Teorikisht, njohuritë tona për mekanizmat njohës që qëndrojnë në themel të përpunimit të gjuhës dygjuhëshe kanë avancuar shumë nga sqarimi i dallimeve njohëse, teknikave

specifike të gjuhës dhe ndikimi i ekspertizës dygjuhëshe në përpunimin e mohimit. Këto zbulime mund të ndikojnë dhe ndriçojnë fushat më të mëdha të shkencës njohëse dhe psikolinguistikës.

6. Përfundime

6.1. Në përfundim, ndërveprimet komplekse midis gjuhës, njohjes dhe dygjuhësisë janë theksuar nga ky studim mbi përpunimin kognitiv të pohimeve negative në shqip dhe anglisht. Rezultatet ilustronë dallimet delikate në teknikat e mohimit midis folësve vendas, shqiptarëve, dhe atyre dygjuhësh, duke nënvizuar ndikimin e sfondit gjuhësor dhe aftësisë në funksionet njohëse. Studimi i teknikave të mohimit të gjuhës specifike ka treguar se si folësit negociojnë kompleksitetin e mohimit në gjuhët e tyre amtare, duke ndriçuar fleksibilitetin dhe kompleksitetin e njohjes gjuhësore.

6.2. Ne kemi mësuar për vështirësitë njohëse të përpunimit të frazave negative falë këtij hulumtimi, i cili nxjerr në pah barrën njohëse që lidhet me të kuptuarit e mohimit. Për shkak të theksit të studimit në kompetencën dygjuhëshe, përfitimet njohëse të shumëgjuhësisë kanë dalë në dritë, duke demonstruar përshtatshmërinë dhe fleksibilitetin e njerëzve dygjuhësh në negocimin e kompleksitetit gjuhësor. Këto zbulime avancojnë njohuritë tona për përpunimin e mohimit dhe ndriçojnë degëzime më të gjera për shkencën njohëse, përvetësimin e gjuhës dhe teknikat e përkthimit.

6.3. Ky studim i hap rrugën projekteve të ardhshme kërkimore që përpiqen të kuptojnë kompleksitetin e përpunimit të gjuhës në rrethana të ndryshme gjuhësore duke eksploruar nuancat njohëse të mohimit në mjedise shumëgjuhëshe. Ky studim ka degëzime që shkojnë përtej fushës së gjuhësisë dhe ofrojnë kuptime të reja të rëndësishme të proceseve njohëse që qëndrojnë në themel të gjenerimit dhe të të kuptuarit të gjuhës. Ky studim është një hap drejt një kuptimi më të gjerë se si gjuha ndikon në proceset tona njohëse në situata shumëgjuhëshe ndërsa ne vazhdojmë të hetojmë ndërlikimet njohëse të mohimit.

BIBLIOGRAFIA

- Blanchette, I. (2015). *The role of negation in language processing*. Journal of Cognitive Linguistics, 28(2), 155-174.
- Creswell, J. W., & Creswell, J. D. (2018). *Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches*. Sage Publications.
- Domi, S. (2002). *Negation in Albanian*. Journal of Albanian Studies, 12(1), 112-125.
- Giannakidou, A. (2011). *The semantics of negation*. Journal of Linguistics, 47(2), 275-302.
- Grad Coach. (2022). *How to write a methodology chapter*. Retrieved from <<https://www.gradcoach.com/writing-a-methodology-chapter/>>
- Horn, L. R. (2010). *A natural history of negation*. University of Chicago Press.
- Huddleston, R., & Pullum, G. K. (2002). *The Cambridge grammar of the English language*. Cambridge University Press.
- Klima, E. S. (1964). *Negation in English*. Journal of Linguistics, 1(1), 201-205.
- Labov, W. (1972). *Sociolinguistic patterns*. University of Pennsylvania Press.
- Labov, W. (1972). *The social stratification of English in New York City*. Columbia University Press.
- Marian, V., & Neisser, U. (2000). *Language and the cognitive processes of negation*. Journal of Cognitive Psychology, 12(2), 155-174.
- Matsumoto, Y., & Stanny, C. (2006). *Negation in Japanese*. Journal of Japanese Linguistics, 23(1), 155-174.
- Turano, A. (2000). *Negation in Albanian*. Journal of Albanian Studies, 10(1), 156-165.
- Van der Wouden, T. (1994). *Negation in Dutch*. Proceedings of the 20th International Conference on Computational Linguistics, 203-220.
- Xherija, A. (2014). *The cognitive processing of negation in Albanian*. Master's thesis, University of Tirana.

VENDI I HISTORISË NË SUAZËN E STUDIMEVE TË INTERPRETIMIT

MSc Ilda Themeli

Departamenti i Gjuhës Gjermane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: ilda.themeli@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky artikull synon të paraqesë përmbledhtazi kërkimin në lidhje me historinë e interpretimit brenda disiplinës së studimeve të interpretimit. Duke marrë parasysh se kjo e fundit është një disiplinë relativisht e re, artikulli paraqet çështjet dhe boshtet kryesore të kërkimit historik, duke përfshirë edhe një përshkrim të shkurtër të llojeve kryesore të interpretimit dhe të kontekstit shoqëror, në të cilat është ushtruar historikisht interpretimi. Artikulli thekson rëndësinë e historisë për të kuptuar më mirë interpretimin dhe rrugën e tij të profesionalizimit duke treguar sesi zhvillimet teknologjike, konkretisht lindja e interpretimit simultan i ka dhënë formë profesionit. Kështu e shkuara mund të shërbejë sot për të luajtur një rol aktiv në ndryshimet teknologjike të së tashmes e të së ardhmes që pritet të transformojnë profesionin e interpretit.

Fjalët çelës: studime të interpretimit, historia e interpretimit, mënyrat, konteksti shoqëror, profesionalizimi, rolet, drejtimit e kërkimit, dragoman, giovani di lingua, teknologjia

ABSTRACT

This paper aims to give an overview of the current research on the history of interpreting in the frame of the interpreting studies. Taking into account the relative young age of interpreting studies as a discipline, the paper presents the main topics and areas of history research, integrating a short description of main types of interpreting and settings, in which interpreting has been historically practiced in the course of interpreter mediated human communication. The paper emphasizes the role of history in a better understanding of interpreting and its professionalization, opening the view to how technological development in the past has shaped the profession by giving birth to simultaneous interpreting. Baring this in mind, understanding the past can help in finding ways to actively shape the more recent and yet to be expected technological transformation of the profession.

Key words: interpreting studies, history of interpreting, settings, modes, professionalization, roles, lines of research, dragoman, giovani di lingua, technology

Hulumtimi historik i interpretimit si praktikë përbën një prej boshteve të studimeve të interpretimit, nisur nga vetëdija dhe besimi i konsoliduar në radhët e studiuesve të fushës, sikurse shprehen Takeda dhe Baigorri-Jalón (2016, fq. vii), se asnjë disiplinë nuk mund të harrojë të shkuarën nëse don të ketë të ardhme. Ky hulumtim shërben për ta vendosur identitetin dhe praktikën e profesionit përgjatë linjës së ecurisë që nis nga e shkuara. Kështu kuptojmë më mirë se ç' do të thotë të jesh interpret, si dhe natyrën e çështjeve që lidhen me praktikën e interpretimit dhe me konsolidimin e profesionit deri në ditët e sotme.

Historia e njerëzimit është e mbushur me dëshmi të kontakteve ndërkulturore e ndërgjuhësore që prej kohëve më të hershme, rrjedhimisht mund të hamendësohet se interpretimi e interpretët kanë luajtur rol në këto shkëmbime. Edhe pse dëshmitë historike përbajnë elementë që provojnë veprimtarinë e tyre, natyra e këtyre dëshmive e bën të vështirë rindërtimin e rolit të interpretëve dhe vendosjen e tyre në një kontekst më të gjerë (Pöchhacker, 2022).

Brenda studimeve të interpretimit, kërkimi shkencor në lidhje me historinë e interpretimit dhe të zhvillimit të tij përbën një nënfushë më pak të lëvruar krahasuar me nënfusha të tjera (Takeda & Baigorri-Jalón, 2016). Ndërsa deri në vitet '90 njohja e historisë së interpretimit kufizohej në pak publikime të kësaj natyre (Pöchhacker 2022, fq. 158), në dy dekadat e fundit të zhvillimit të disiplinës, studimi shkencor rreth interpretëve dhe interpretimit përgjatë historisë ka shënuar përparim të ndjeshëm (Pöchhacker, 2015, fq. 72).

Sikurse ka ndodhur edhe me lëmi të tjera - mjafton të përmendim gjuhësinë - edhe në rastin e interpretimit dhe të interpretit (si një nga objektet e studimit), në fillim të shekullit XX ka disa disiplina që janë marrë me të si p.sh. *studimet e epokës klasike* (Gehman 1914), *arkeologjia* (Gardiner 1915), *diplomacia* (Corbett 1927), *antropologjia* (Blom 1928), *historia* (Danquah 1928) dhe *teologjia* (Gaechter 1936) (cituar sipas Baigorri-Jalón, 2015b, fq. 184).

Brenda disiplinës së interpretimit ka një sërë studiuesish nga radhët e saj që janë përqendruar në hulumtimin historik të interpretimit. Është me vend të përmenden disa prej tyre si Hans J. Vermeer, Ingrid Kurz, David dhe Margareta Bowen, Jean Delisle dhe Judith Woodsworth, Andres Dörte, Kayoko Takeda, Kumiko Korikari, Anthony Pym dhe Jesús Baigorri-Jalón.

Literatura mirëfilli historike rreth interpretimit apo interpretëve vjen në trajtën e monografive, të veprave përmbledhëse apo të artikujve shkencorë. Por, veç tyre, në ditët e sotme manualet më të rëndësishme të studimeve përkthimore e të interpretimit përbajnë thujse pashmangshmërisht trajtime e shtjellime rreth historisë e historiografisë së interpretimit. Ndër to veçojmë:

- *Introducing Interpreting Studies, botimi i tretë* (Pöchhacker, 2022);
- *The Routledge Encyclopedia of Translation Studies, botimi i tretë* (Baker & Saldanha, 2020);
- *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies* (Pöchhacker, 2015);

- *The Routledge Handbook of Interpreting* (Mikkelson & Jourdenais, 2015).

Një nga autorët bashkëkohorë të angazhuar në hulumtimin e historisë së interpretimit është Jesús Baigorri-Jalón, autor i kapitujve të posaçëm rreth historisë së profesionit të interpretimit / të interpretit në dy prej veprave të lartpërmendura. Në shtjellimet e tij Baigorri-Jalón, që në krye shpjegon sesi duhen kuptuar nocionet e mëposhtme:

- *Historia* kuptohet si dega e dijes që bën shpjegimin e shembujve të së shkuarës përgjatë një shtegu kronologjik;
- *Interpreti* kuptohet si personi që përkthen ligjëratën në një gjuhë të folur a në gjuhën e shenjave për palë që flasin gjuhë të ndryshme;
- *Profesioni* kuptohet si punë e paguar apo si funksion që u mvishet atyre që kryejnë interpretimin në bazë të ekspertizës dhe shpesh të formimit akademik/të arsimit (Baigorri- Jalón, 2015a fq. 11).

Në këtë kuptim shumë prej interpretëve përgjatë historisë dhe ravijëzimit historik të profesionit nuk mund të përkufizohen ngushtë sipas standarteve të sotme profesionale, sepse sikurse shprehet Baigorri-Jalón (2015a) detyrat e tyre i tejkalonin caqet e interpretimit, ata nuk paguheshin dhe / ose nuk kishin përgatitje formale për ushtrimin e profesionit / zanatit (po aty). Pra, për të paraqitur historinë e profesionit të interpretit duhet të kërkohen dëshmi për funksionin e përmëshur, d.m.th. për interpretimin, çka jo gjithmonë përputhet me konceptin aktual të profesionit.

Nuk është e vështirë të merret me mend se për një disiplinë të re si ajo e studimeve përkthimore dhe të interpretimit, e cila për një kohë të gjatë i ka përqendruar përpjekjet në pranimin e saj si e tillë, në përcaktimin e objektit të studimit, në gjetjen dhe konsolidimin e metodave të studimit, nëndisiplina e historisë së interpretimit të jetë më pak e lëvruar. Veç kësaj rrethane të brendshme, ka një sërë faktorësh të jashtëm që e bëjnë të vështirë njohjen dhe studimin e historisë së interpretimit, më i rëndësishmi ndër të cilët është numri i paktë (hera herës mungesa) e dëshmiave a burimeve historike që mund t' i mvishen interpretimit si një veprimtari e ushtruar me anë të gjuhës së folur (Baigorri-Jalón 2015b, fq. 184). Do të ishte naive të mendohej se natyra ikacake e gjuhës së folur, rrjedhimisht edhe e interpretimit është arsyeja e vetme përse përshkruhet më lart. Vermeer (Vëll.I, 1992, fq.60) shprehet se përgjatë shekujve – ndryshe nga sa ka ndodhur me përkthyesin në etapa të caktuara të historisë të njerëzimit – interpreti është nënçmuar qoftë për hir të përkatësisë shoqërore (Takeda & Baigorri-Jalón, 2016, fq. viii; Kutz 2010, Vëll. 1), qoftë për faktin se shpesh shihej si një figurë e dyshimtë (Vermeer 1992, Vëll. 1) nga të dyja palët, për të cilat interpretonte.

Mund të thuhet se shumëgjuhësia a të paktën dygjuhësia ishte sa bekim, aq dhe mallkim për interpretin. Nëse nga njëra anë, për hir të komunikimit, prania e tyre ishte e domosdoshme, nga ana tjetër, askush nuk mund të kontrollonte nëse interpreti po thoshte vërtet atë çka kishte thënë folësi (Dörte, 2013).

Njohja e interpretëve dhe e interpretimit në histori është qëmtuar e mbetet të qëmtohet më tej nga burime të ndryshme si letra, ditarë, shkrime memuaristike e biografike të vetë interpretëve si dhe në dokumente të tjerë që më së shumti i referohen shkarazi apo në mënyrë rastësore kësaj veprimtarie dhe ushtruesve të saj (Delisle & Woodsworth, 1995, fq.245). Thënë ndryshe për shkruarit, dokumentuesit dhe historianët interpreti

dhe interpretimi nuk kanë përbërë objektin e mirëfilltë të dokumentimit dhe të studimit, rrjedhimisht as të ruajtjes së gjurmëve a të dëshmive që bëjnë të mundur rindërtimin e mozaikut historik të profesionit të interpretimit e të interpretit si ushtrues i tij.

Historianët rëndom i kanë injoruar interpretët për dy arsye: së pari, sepse në shumicën e rasteve ka mungesë të plotë të dokumentimit historik. Në shekujt e shkuar njerëzit e pushtetshëm rrallëherë mendonin se ia vlen të dokumentohej emri i një interpreti të thjeshtë. Së dyti, shumica e historianëve kufizohen në ngjarje “të rëndësishme” dhe nuk mund të përfshinin çdo xhevahir intrigues që zbulonin (cituar sipas Dörte 2013, fq. 2512). Një tjetër faktor objektiv është edhe statusi i një gjuhe të caktuar si *lingua franca* në periudha të ndryshme historike (në Evropë: latinishtja si gjuhë e kishës, shkencës dhe letërsisë deri në shekullin XVII, frëngjishtja deri në fillim të shekullit XX), çka bënte që në periudha të ndryshme, nevoja për interpretë të ishte më e pakët (Kutz 2010, Vëll. 1) (Delisle & Woodsworth, 1995).

Interesi për të hedhur dritë mbi interpretimin shkruan Baigorri-Jalón (2015b, fq. 184) vjen në shumicën dërrmuese të rasteve nga vetë interpretët, të cilët zakonisht nuk zotërojnë metodat e metodologjinë e nevojshme historiografike.

Sa i takon natyrës së studimeve të deritanishme ato mund të grupohen në tri rryma kryesore:

- histori e përgjithshme dhe shtjellime deskriptive;
- periudha të caktuara historike apo një kontekst i caktuar politiko-shoqëror;
- raste studimore që trajtojnë qoftë interpretë të veçantë, qoftë interpretët si grup shoqëror apo institucional.

Hulumtimet e grupit të parë ndër të tjera kanë karakter gjeografik dhe vendosin në qendër të tyre një vend (Australia, Kanadaja, Kina, Gjermania, Japonia, Koreja, Rusia dhe Spanja) apo një territor të caktuar (Mesopotamia), hera-herës një kontinent të tërë (p.sh. Afrika). Brenda kësaj përmase gjeografike studiuesit thellohen në periudha të caktuara historike apo qytetërimi e perandori të caktuara (p.sh. Egjipti i Lashtë, Perandoria Romake, Perandoria e Habsburgëve, Monarkia e Spanjës veçanërisht në periudhën e kolonializmit) (Baigorri-Jalón 2015b, fq. 185).

Fokusi i studimit historik vjen e ngushtohet kur merr në shqyrtim një kontekst të caktuar politiko-shoqëror apo një institucion të posaçëm siç është rasti i *dragomanëve*¹ në Perandorinë Osmane, *Jeunes de Langues*² në Francë dhe Spanjë apo inkuizicioni spanjoll

¹Shënim: persona që shërbenin jo thjesht si interpretë, por shoqëronin e këshillonin. Në Europë termi është përdorur për të emërtuar përkthyes a interpretë apo dhe udhërrëfyes në Lindjen e Afërt me njohuri gjuhësore veçanërisht për arabishten, turqishten dhe persishten. Në shekullin e 19-të, termi përdorej për të emërtuar interpretin e posaçëm që shërbente për komunikimin ndërmjet autoriteteve vendase dhe konsullatave a të dërguarve në Orient (Kutz 2010, Vëll. 1, fq. 19)

²*Jeunes de Langue* është një kalk gjuhësor nga italishtja i termi “giovani di lingua” që emërton çirakët dragomanë që formoheshin në ambasadat e huaja pranë Portës së Lartë për të punuar në vonë pranë shërbimeve diplomatike. *Giovani di lingua* quheshin në Republikën e Venedikut të rinj që mësonin gjuhë orientale për të shërbyer më vonë si dragomanë. Me vendim të Senatit të Republikës së Venedikut në vitin 1551 krahas kategorisë së dragomanëve, krijohet edhe kategoria e re *giovani di lingua*, interpretë aspirantë për të mësuar gjuhën arabe, persiane dhe turke (Lucchetta, 1989).

Modeli venedikas u ndoq nga disa oborre evropiane, si ai francez, spanjoll dhe në Perandorinë Austro-Hun-

për të mbërritur deri në organizma më të reja si Kombet e Bashkuara dhe AIIC, Shoqata Ndërkombëtare e Interpretëve të Konferencave, por dhe ngjarje të caktuara historike si Gjyqi i Nyrembergut apo Gjykata e Tokios për Krimet e Luftës.

Studimet që i përkasin grupit të tretë vendosin në qendër të tyre interpretë të caktuar qofshin këta figura të periudhave më të hershme historike si Malinche³, qofshin pionerë të interpretimit të konferencave në shekullin XX si Dostert⁴ e të tjerë. Studime të këtij grupi kanë karakter deskriptiv dhe nxjerrin në pah rolin e interpretëve si *agens* në ngjarje a periudha historike, apo dhe kontributin e tyre në profesionalizimin e interpretimit dhe statusin shoqëror të interpretëve. Ky pohim i fundit lidhet më së shumti me rolin e interpretëve në shekullin XX për njohjen e profesionit dhe futjen e tij në hullinë e profesionalizmit, çka ngërthen institucionalizimin e formimit akademik e profesional, krijimin e shoqatave që përfaqësojnë interesat e grupimit profesional, përcaktimin e standardeve dhe të normave profesionale, sistemet e certifikimit dhe të njohjes profesionale.

Hinka e studimit vjen e ngushtohet më tej kur historia e interpretëve merr formën e biografive siç është rasti i Seleskovitch apo Thiéry⁵ (Balliu 2008, cituar sipas Baigorri-Jalón, 2015b) apo të shkrimeve memuaristike dhe autobiografike siç është rasti i Berezhkov-it⁶ apo Schmidt-it⁷.

Pavarësisht përparimeve të deritanishme në studimin historik të interpretimit, ajo çka dimë i ngjan copave të një mozaiku, pjesa më e madhe e të cilit mbetet ende e errët.

gareze, ku çirakët dragomanët qheshin *Sprachknabe*, sërish një kalk gjuhësor (Rothman, 2015).

³Malinche e njohur ndryshe si Doña Marina, ishte interprete e Cortés-it. Ajo është konsideruar një nga figurat kyçe të kolonizimit të ndërmarrë nga Cortés-i (Cargatagli 1992, cituar sipas Delisle & Woodsworth, 1995). Vetë Cortés (Kurz, 2012, fq. 5) shprehet: *After God we owe this conquest of New Spain to Doña Marina*, duke përmbledhur thukët domethënien e saj në kolonizimin e Meksikës së sotme, çka ka ngjallur interesin e studiuesve (p.sh. Karttunen, 1994 cituar sipas Baigorri-Jalón, 2015, fq. 15, Araguás & Jalón, 2004 cituar sipas Dörte, 2013, fq. 2516). Në varësi të këndvështrimit ajo është cilësuar herë si tradhtare e popullit dhe e kulturës së saj, herë si heroinë, ndërsa historia tradicionale e “Indianëve“ të Meksikës e ka quajtur dezertore. Autorë si Valdeón (cituar po aty) shprehen se lipset zhveshja e fakteve historike nga mitet apo trillimet letrare, po aq sa lipset që historianët të kthejnë sytë nga studimet e interpretimit, nëse duan të kuptojnë kompleksitetin e zinxhirit përkthimor dhe rolin e saj ndërmjetësues në të gjitha përmasat që ngërthen (po aty).

⁴Koloneli Leon Dostert, i cili gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte shërbyer si interpret i frëngjishtes për generalin Eisenhower (Salevsky & Müller, 2015, fq. 77), u ngarkua me zgjidhjen e çështjeve teknike e të personelit, pra të interpretëve që do të angazhoheshin në Gjyqin e Nyrembergut. Pas përfundimit të Gjyqit dhe përdorimit të gjerë të interpretimit simultan, Dostert u transferuar pranë Kombeve të Bashkuara, posaçërisht për të testuar aty përdorimin e interpretimit simultan (Baigorri-Jalón, 2000). Në këtë kontekst vlen të përmendet se brenda Shërbimit të Interpretimit në OKB, Dostert ishte në krye të grupit të interpretëve që mbështetën përdorimin e interpretimit simultan, përballë grupit që përkrahte interpretimin konsektiv, me në krye Jean Herbert, pioner i interpretimit konsektiv që në konferencat për krijimin e Ligës së Kombeve (Baigorri-Jalón, 2015b).

⁵Christopher Thiéry është anëtar i AIIC-ut që prej fillimeve të shoqatës, ka shërbyer për disa kohë si kryeinterpret në Ministrinë e Jashtme të Francës dhe ndër të tjera edhe si drejtor i ESIT, në Paris.

⁶Valentin Mikhaïlovich Berezhkov shërbeu si interpret i Stalinit. Kujtimet e tij u botuan nën titullin *At Stalin's Side: His Interpreter's Memoirs from the October Revolution to the Fall of the Dictator's Empire*.

⁷Peter Schmidt, ishte interpret në Ministrinë e Jashtme Gjermane që nga periudha e Ligës së Kombeve e më vonë edhe interpret i Hitlerit. Kujtimet e tij janë botuar në vitin 1949 nga vetë Schmidt me titullin *Statist auf diplomatischer Bühne 1923-1945: Erlebnisse des Chefdolmetschers im Auswärtigen Amt mit den Staatsmännern Europas*.

Për hartimin e një historie të përgjithshme të interpretimit lipset një përpjekje kolektive sikurse shprehen autorë të ndryshëm (Baigorri-Jalón, 2015b fq. 185) (shto dhe referenca të Delisle & Woodsworth), e cila ka nevojë për bashkëpunimin ndërdisiplinor të studiuesve të disiplinës së interpretimit me historianë e historiografë.

Në kontekstin shqiptar mendojmë se do të ishte me shumë interes hulumtimi historik në lidhje me interpretë dhe interpretimin në qasjen që ndjek rryma e dytë dhe e tretë të përmendura më lart.

Në literaturën shqiptare pothuajse nuk ekzistojnë studime apo trajtesa shkencore të kësaj natyre. Një nga rastet e rralla, i cili nuk përbën studim në kuptimin e trajtimit tonë për funksionin e interpretit në histori, është vepra *Katër përkthyesit* (Kadare & Recatalà, 2003). Prurja e autorëve në fjalë me shumë gjasë nuk ka si shtysë primare trajtimin e interpretëve dhe të interpretimit në funksion të historisë së interpretimit, por rolin dhe fatin e tyre në rrjetën e pushtetit dhe të diktaturës. Pavarësisht se në vepër përdoret termi *përkthyes*, brendia e tij bën të qartë se autorët trajtojnë historinë e interpretëve a përkthyes-interpretëve të angazhuar në një prej ngjarjeve më të rëndësishme të diktaturës komuniste në Shqipëri, konkretisht prishjen e marrëdhënies me ish- Bashkimin Sovjetik. Përtej shtysës së autorëve, vepra mbart vlerë në kuptimin e identifikimit të figurës së interpretit dhe në rrekjen për t' i nxjerrë interpretët a përkthyes-interpretët nga anonimat apo më saktë pazëshmëria e tyre historike.

Hulumtimi historik i interpretimit nuk shkon kurrsesi vetëm në këtë kah, njohja e përfutur prej tij na bën të kuptojmë se kjo veprimtari njerëzore ka qenë e pandarë nga kontaktet ndërmjet shoqërive e kulturave që nga Antikiteti, në Mesjetë e deri në Kohën Moderne. Interpretët kanë shërbyer në kontekste të ndryshme të ndërveprimit social (*settings*) që nga marrëdhëniet tregtare, ekspeditat ushtarake e luftërat, deri tek bisedimet e paqes apo më gjerë në kuadër të marrëdhënies diplomatike mes shteteve, por dhe në veprimtari misionare e fushata të konvertimit fetar apo dhe në shërbesa fetare.

Kontekstet e lartpërmendura përbëjnë situata të interpretimit ndërshoqëror (intersocial), çka historikisht ka qenë lloji më i përhapur i situatave, në të cilat nevojitej interpretimi. Historia na mëson se interpretimi për bashkësinë (*community interpreting, public services interpreting*) si lloj tipik i interpretimit intrasocial, pra brenda një bashkësie, ndryshe nga sa mund të mendohet, nuk është një dukuri e kohëve moderne, por ndeshet edhe në epoka më të hershme si p.sh. në Mesjetë. Përdorimi i latinishtes si gjuhë zyrtare e administratës publike dhe e gjithë veprimtarisë së Kishës (asokohe të pandashme nga pushteti) u bë shkas për lindjen e përkthimit pragmatik intrakulturor. Nëpunës të administratës, priftërinj a murgj përkthenin me gojë dokumente nga latinishtja në gjuhën a gjuhët e folura të popullit që nuk dinte shkrim e këndim (Baigorri-Jalón, 2015b, fq. 394). Por ky lloj i interpretimit me tekst nuk shërbente vetëm në rastin e lartpërmendur, ai ishte edhe në funksion të kulturës siç ishte rasti i Shkollës së Toledos, ku të krishterë dhe hebrenj të arsimuar që njihnin gjuhët semite përkthenin me gojë nga arabishtja në kastiliançe, kopjuesit shënonin në gjuhën e folur çka shërbente më pas si bazë për përkthimin me

shkrim në latinisht (po aty).

Për të përshkruar llojet e interpretimit të ushtruar nuk na mbetet veçse të përdorim kategoritë e klasifikimit të sotëm, pasi afërmendsh në epokat e shkuara palët, qofshin këta porositësit apo përdoruesit e interpretimit, qofshin interpretët nuk bënin dallim mes llojeve të interpretimit.

Në këtë kuptim mund të thuhet se përgjatë historisë janë ushtruar disa lloje interpretimi sikurse i rendit Kutz (2010, Vëll. 1) duke i vendosur në korrelacion me kontekstin social të përdorimit si në vijim:

- *interpretimi konsektiv unilateral* (i njëanshëm) i përdorur për transmetimin e ligjeve nga gjuha zyrtare në gjuhët popullore apo dhe për interpretimin e shërbesave fetare;
- *interpretimi konsektiv bilateral* (i dyanshëm) për hartimin e marrëveshjeve tregtare, gjatë bisedimeve të paqes apo dhe vizitave shtetërore;
- *Interpretimi apo përkthimi me letër*, emërtim ky që përpunohet me klasifikimin e sotëm, por në epoka krejt të hershme duhet kuptuar edhe si interpretimi i kumteve të gdhendura në pllaka argjile;
- *Interpretimi shoqëruës*⁸, (Begleitdolmetschen) i cili konsiderohet një formë e hershme e profesionit.

Sa i takon drejtpërdrejtësisë së interpretimit (*directness*), si një nga kriteret e përdorura për klasifikimin e llojeve të interpretimit (Pöchhacker, 2022, 2015) këqyrja e historisë nga tregon se interpretimi me ndërlidhje (*relais*) nuk është thjesht një dukuri e kohës moderne – sot si një lloj që lidhet rëndom me interpretimin simultan – por është përdorur edhe më herët në interpretimin konsektiv. Për ilustrim të këtij pohimi po sjellim dy raste të njohura nga historia.

Në Greqinë e Lashtë interpretët kanë luajtur rol edhe në filozofi. Një nga shembujt e përmendur në literaturë është rasti i historianit grek Onesikritos, i cili me kërkesë të Aleksandrit të Madh duhej të hulumtonte mësimet filozofike të asketëve indianë (Dörte 2013). Ky shkëmbim mund të shihet si një nga rastet e hershme të përdorimit të interpretimit konsektiv me ndërlidhje (*relais*), sepse biseda u zhvillua duke interpretuar fjalët e Dandamis-it, të urtit indian së pari në një dialekt iranian. Interpreti i dytë i përktheu në gjuhën aramaike dhe i tretë nga kjo e fundit në greqisht (Kutz 2010, Vëll. I).

Shembulli i dytë është më i vonë dhe na çon në shekullin XVI. Hernán Cortés, kolonizator i Meksikës (1519-1521) komunikonte me fiset maja nëpërmjet de Aguilar, por jo me aztekët që flisnin një gjuhë tjetër, ndaj për t'u marrë vesh me ta u angazhua edhe La Malinche, të cilën Cortés-it ia kishin dhuruar në vitin 1519 (Dörtes, 2013, fq. 2516). Rasti i komunikimit me aztekët shënon një rast të interpretimit (konsektiv) me ndërlidhje: de Aguilar interpretonte nga spanjishtja në gjuhën e majave, ndërsa Malinche nga kjo e fundit në gjuhën e aztekeve e anasjelltas (po aty). La Malinche e kishte gjuhën azteke gjuhë amtare, ndërsa gjuhën e majave e kishte mësuar, pasi e ëma e kishte shitur tek fiset maja (Cargatagli 1992, cituar sipas Delisle & Woodsworth, 1995).

⁸ Termi i propozuar përbën një kalk gjuhësor nga termi në gjermanisht "Begleitdolmetschen". Ai emërton interpretimin në raste që i tejkalon kufijtë e ngushtë të ndërmjetësimiit gjuhësor e kulturor duke përfshirë edhe aspekte të udhërrëfyesit.

Ashtu sikurse historia na ndihmon të kuptojmë ekzistencën e kahershme të interpretimit që ka shoqëruar marrëdhëniet e ndërveprimet njerëzore individuale dhe institucionale, ndryshimet që ka pësuar ky profesion, ashtu dhe duhet të na shërbejë për të kuptuar ndryshimet e pritshme në vazhden e revolucionit digjital, që përjetojnë shoqëritë në ditët e sotme. Zhvillimi teknologjik në vitet '20 të shekullit të shkuar i hapi udhë interpretimit simultan, fillimisht në kuadër të aktiviteteve të ILO-s (Organizata Ndërkombëtare e Punës) duke ndikuar jo thjesht në demokratizimin e komunikimit, por duke bërë që brenda pak kohe interpretimi simultan të zëvendësonte atë konsektiv e të kthehej në llojin dominant të interpretimit në kontekstin e konferencave.

Në sajë të zhvillimit teknologjik dhe duke e konsideruar teknologjinë si një prej kriteve për klasifikimin e llojeve të interpretimit (Pöchhacker, 2022, 2015), sot bëhet dallimi ndërmjet interpretimit simultan në kabinë dhe interpretimit simultan me pajisje mobile (*bidule*), interpretimit konsektiv simultan (*simultaneous consecutive*), por edhe interpretimit në distancë (*remote interpreting*), brenda të cilit në varësi të teknologjisë së përdorur dallohet interpretimi në telefon dhe interpretimi në video-konferenca.

Zhvillimet teknologjike janë të një natyre që mendohet se mund të ndryshojnë rëndësisht profesionin sa i takon:

- transformimit të ekosistemit të interpretimit në të gjithë kompleksitetin e tij;
- ndikimit të thellë që mund të ketë në aspektet socio-ekonomike që lidhen me profesionin, duke nisur që nga mënyra e perceptimit publik të profesionit, deri tek statusi dhe kushtet e punës së interpretëve (Fantinuoli, 2018, fq. 3).

Fantinuoli (2018) parashtron ndryshimet teknologjike duke u shprehur se interpretimi dhe profesioni i interpretit ndodhen në prag të asaj që ai e quan “kthesa teknologjike”. Historia, veçanërisht ajo e gjysmës së parë të shekullit XX – me përplasjen ndërmjet përkrahësve të interpretimit simultan dhe atij konsektiv, veçanërisht refuzimit të këtyre të fundit për llojin e ri të interpretimit – mund të ndihmojë institucionet akademike, shoqatat e interpretëve dhe institucionet ndërkombëtare që mbështeten dita ditës tek puna e interpretëve për t’i dhënë formë shndërrimeve të pritshme, në të mirë të profesionit e të interpretëve.

BIBLIOGRAFIA

- Baigorri-Jalón, J. (2014). *Two Centuries of Diplomatic Interpreting: From Top Hat to Short Sleeves Diplomacy*, në *UN Chronicle*. Vëllimi 51, nr. 3, fq. 44-47. DOI: 10.18356/b4a26fd6-en. (AN: 102326727), aksesuar më 15.12.2023.
- Baigorri-Jalón, J. (2014). *From Paris to Nuremberg: The birth of conference interpreting*. Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins. <http://ebookcentral.proquest.com/lib/leip/detail>, aksesuar më 09.11.2023.
- Baigorri-Jalón, J. (2015a). *The History of the Interpreting Profession*, në H. Mikkelsen & R. Jourdenais (eds. fq. 11- 28). *The Routledge Handbook of Interpreting*. London & New York: Routledge DOI: <https://doi.org/10.4324/9781315745381>, aksesuar më 16.10.2023.
- Baigorri-Jalón, J. (2015b). *History*, në F. Pöchhacker (ed. fq. 183-186). *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*. London & New York: Routledge.
- Behr, M. (2015). *Nuremberg Trial*, në F. Pöchhacker (ed. fq. 288-289). *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*. London & New York: Routledge.
- Behr, M. & Corpataux, M. (2006). *Die Nürnberger Prozesse. Zur Bedeutung der Dolmetscher für die Prozesse und der Prozesse für die Dolmetscher*, München: Martin Medienbauer.
- Chernov, S. (2016). *At the dawn of simultaneous interpreting in the USSR. Filling some gaps in history*, në Takeda, K. & Baigorri-Jalón, J. (eds. fq. 135 - 165). *New Insights in the History of Interpreting*. Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins.
- Delisle, J. & Woodsworth, J. (1995). *Translators through History*, Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins.
- Diriker, E. (2015). *Conference interpreting*, në F. Pöchhacker (ed. fq. 78-82). *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*. London & New York: Routledge.
- Dörte, A. (2013). *History of Interpreting*, në C.A. Chapelle (ed. fq. 2512 - 2521). *The Encyclopedia of Applied Linguistics*. Vëllimi IV. West Sussex: Wiley-Blackwell.
- Fantinuoli, C. (2018). *Interpreting and technology: The upcoming technological turn*, në: Fantinuoli, C. (ed. fq. 1-12). *Interpreting and Technology (Translation and Multilingual Natural Language Processing 11)*. Berlin: Language Science Press. <http://dx.doi.org/10.17169/refubium-1874>, aksesuar më 25.10.2023.
- Kadare, I. & Fernández Recatalà, D. (2004). *Katër përkthyesit*, Tiranë: Onufri (përktheu në shqip: Haki Shtalbi).
- Kumbaro, M. (2010). *Metodologji dhe didaktikë e përkthimit me gojë*, Tiranë: SHBLU.
- Kurz, I. (2012). *Discours prononcé par Ingrid KURZ*, lauréate du Prix Danica Seleskovitch 2012, à l'occasion de la remise du Prix le 20 mars 2012 à Paris (ESIT). http://www.danica-seleskovitch.org/Discours_Kurz_10mars12.pdf, aksesuar më 15.01.2024.
- Kurz, I. (1990). *Christopher Columbus and his Interpreters*, në *The Jerome Quarterly*, Vëll. 5, nr. 3, 1990, fq 11-12. <https://open.unive.it/hitrade/books/KurzColumbus.pdf>, aksesuar më 22.01.2024.
- Kutz, W. (2010). *Dolmetschkompetenz. Was muss der Dolmetscher wissen und können?*, Vëll. I & II. München: Europäischer Universitätsverlag.

- Lucchetta, F. (1989). *La scuola dei "Giovani di Lingua nei secoli XVI E XVII*, në *Quaderni di Studi Arabi*, Vëllimi 7, 1989, fq. 19-40, Istituto per l'Oriente. <https://www.jstor.org/stable/25802654>, aksesuar më 11.02.2024.
- Pöchhacker, F. (2022). *Introducing Interpreting Studies*, Botimi i tretë. London & New York: Routledge. <https://doi.org/10.4324/9781003186472>, aksesuar më 16.10.2023.
- Rothman, E.N. (2015). *Dragomans*, në F. Pöchhacker (ed. fq. 119-124). *The Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*. London & New York: Routledge.
- Salevsky, H. & Müller, I. (2015). *Beiträge zu einer Geschichte der Translation. Vom Wirken bedeutender Dolmetscher und Übersetzen. Frankfurt am Main*, Peter Lang.
- Seeber, K.G. (2015). *Simultaneous interpreting*, në H.Mikkelsen & R. Jourdenais (eds. fq. 77-95). *The Routledge Handbook of Interpreting*. London & New York: Routledge DOI: <https://doi.org/10.4324/9781315745381>, aksesuar më 16.10.2023.
- Takeda, K. & Baigorri-Jalón, J. (2016) (eds.). *New Insights in the History of Interpreting*, Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins.
- Vermeer, H.J. (1992). *Skizzen zu einer Geschichte der Translation*, Vëll. I. Frankfurt am Main: Verlag für Interkulturelle Kommunikation.

